Viti XXV. Nr. 7

ISSN 0353/7110

ALTERNATIVA

Revistë për kulturë dhe shkencë

LUBLANË 2018

TGS 403668

ALTERNATIVA

Časopis za znanost in kulturo

Revistë
për shkencë dhe kulturë

ISSN 0353-7110

LUBLANË, 2018

Viti XXV. Nr. 7

Narodna in univerzitetna knjižnica
LJUBLJANA
92018 4250

Këshilli botues

dr. Martin Berishaj
dr. Anton Bebler
dr. Shaban Sinani
dr. Afrim Krasniqi
dr. Pëllumb Qazimi
dr. Ledi Shamku – Shkreli
dr. Ivo Andrijanić
dr. Romeo Gurakuqi
dr. Irena Šumi
dr. Braco Rotar

Kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës: Prof. dr. Martin Berishaj

Adresa: KDA MIGJENI, Celovška 177, 1000 Ljubljana, Slovenija
Email: martin@berishaj.com

Redaksia:

Tahir Maliqaj, Kryeatar i SHKSH "Migjeni"
Mr. Mentor Tahiri
Mr. Albert Ramaj
Valentin Batalaku

Alternativa izhaja s finančno pomočjo Javnega Sklada Republike Slovenije za kulturne dejavnosti

IZDANO V 2.000 PRIMERKIH

PËRMBAJTJA

Obuditev albanoloških raziskav v Kopru.....3
E drejta në ratifikim të marrëveshjes mbi kufirin nënkupton edhe të drejtën në refuzim të sajë.....6
The Russian-Ukrainian conflict over Crimea.....24
The historic background of the conflict.....26
The legal status of Crimea from 1917 to 2014.....29
Crimea's secession from Ukraine.....32
Crimea's annexation by the Russian Federation.....37
Conflicts in mainland Ukraine.....42
The Ukrainian crisis and the international community.....47
Conclusion.....54
Kontributi i At Gjergj Fishtës në arsimin shqiptar.....57
Kryengritja e Malësisë së Madhe e vitit 1911.....69
Vështrim i përgjithshëm mbi Kryengritjen e vitit 1910 në vilajetin e Kosovës dhe shtrirja e saj në vilajetin e Shkodrës.....71
Shpërthimi i Kryengritjes në Malësinë e Madhe dhe veprimet luftarake.....74
Memorandumi i Greçës dhe Marrëveshja e Podgoricës.....79
Qëndrimi i Fuqive të Mëdha dhe shteteve ballkanike kundrejt Kryengritjes.....81
Aneksimi i kishave katolike të kryedioqezës së Shkodrës nga ana e Malit të Zi (1878-1913).....88
Lëkundjet politike dhe kishtare.....88
Lidhja Shqiptare e Prizrenit në shtypin slloven.....96
Shtypi slloven i kohës për Lidhjen e Prizrenit.....98
Copëza letërkëmbimi të De Gaulle me Mbretin Zog deri në vitin 1961.....105
Kontributi i prof. dr. Rajko Nachtigal-it në fushën e albanologjisë.....115
Elbasanishtja si themel i duhur për gjuhën e njënjëshme letrare shqipe.....115
Gjergj Kastrioti Skenderbeu, brezi konvertues dhe matematika.....134
Gjergj Kastrioti-Skënderbeu mbrojtës i qytetërimit evropian.....137
çfarë ishte ambienti shpirtëroro-kulturor e politik i Shqipërisë në kohën e Skënderbeut?.....138

Recension.....145
Poezi.....156
Ti m'ke mësu.....157
Heroit tem.....158
Servantesi iku prej Ulqinit.....159
Liria dhe makina e kohës.....160
Poezi pa emën.....161

OBUDITEV ALBANOLOŠKIH RAZISKAV V KOPRU

Peter ŠTOKA

Danes sem zelo začuden in zaprepaden nad mislijo, da tako bogata zgodovina, ki so jo živeli, gradili in pisali številni posamezniki iz pomembnih albanskih družin in rodbin v Kopru in posledično na področju njegovega *dominija* v Istri, je pozabljena, preslišana ali še huje, prezrta. Zato me še toliko bolj presenečajo in žalostijo obenem današnji zgodovinarji, od katerih ne bi pričakoval skoraj stoletje trajajočega molka o tematiki, ki se ji sleherni resni raziskovalec ne more izogniti. V beneškem času in tudi kasneje v avstrijskem in italijanskem času so sicer redki, a verodostojni raznovrstni učenjaki zapisali marsikateri drobec velike albanske zgodbe. Naj jih omenim v časovnem vrstnem redu (kronološko), ker si to zaslužijo: Nicolò Manzuoli (1611), Prospero Petronio (1680,81), Giuseppe Bonzio (1738), Tomaso Luciani (1873), Domenico Venturini (1905), Gregorio de Totto (1939), Francesco Semi in Aldo Cherini v eksilu povojnega časa. Verjetno tudi sam ne bi nikoli odkril tega poglavja našega mesta, če se kot skrbnik antičnih knjižnih fondov, ne bi poklicno soočal s starimi knjigami in listinami (dokumenti), ki molče a neizbrisno poročajo o njej. Pa vendar se je izkazalo, da je mesto samo, s svojimi trgi in ulicami, s palačami, cerkvicami in samostani, s kamnitimi ploščami in kipi, s poslikavami in likovnimi deli, največje skladišče informacij, poleg naključnih ljudi seveda. In ravno tako izkušnjo sem doživel sam. Ob obeležju 300 letnice palače Bruti sem se prvič srečal z zgodbo o prisotnosti albanskih družin, in to celo plemiških, v Kopru. Do tedaj sem poznal številne Albance v Kopru, toda nihče izmed njih ni izšel ali pripadal tej zgodbi. Številni izmed njih mi je pripovedovalo najrazličnejše zgodbe o albanskih sledeh v Istri. Toda tako kot predpotopnim poročilom o Ilirih, sem tudi te bajke prepuščal njihovi domišljiji in užitku pripovedovanja, sam pa jim nisem nikoli posvečal večje pozornosti, kaj šele da bi jih razumel in doumel. V nasprotju s temi

bajeslovnimi opisi in legendami, pa so se Brutiji izrisovali kot osebe iz mesa in krvi. Ni se zgolj nekaj govorilo o njih, ampak vse povedano si se lahko dotaknil, videl, slišal in občutil. Ob pogledu na njihov spomenik v koprski katedrali in ob njihovem grobnem napisu v krstilnici ob stolnici, me je preplavil občutek sramu in ponižanja. Sprva sem krivil samega sebe, saj sem neštetokrat bil pri maši in neštetokrat sem videl tisti razkošen baročni spomenik, nikoli pa se nisem pozanimal o njem. Sedaj krivim cerkvene dostojanstvenike ter moje domače učitelje in univerzitetne profesorje, da mi niso znali ničesar povedati, kaj šele obrazložiti. In ravno ta brezbrižnost cerkvenega in šolskega sistema me sili in priganja k odkrivanju in razkrivanju te zgodbe, da si nikomur ne bo treba več sramovati ne se počutiti ponižanega zaradi nevednosti in nepoučenosti. Pa vendar te zgodbe ne bi bilo brez dragega gospoda Heseta, ki me priganja in sili k delu sleherni dan. V njem sem spoznal človeka, ki ga vodijo iskreni vzgibi in nepotešena a goreča želja po zapolnitvi te vrzeli, praznine in krivice. Tako sva skupaj prepotovala in raziskala številne kraje v celi Istri in vedno znova se odkrije nekaj novega, obenem pa se vedno srečujemo z gostoljubnimi in srčnimi Albanci. Ta zgodba je napisana s krvjo in mesom, zato je njeno branje zanimivo in lahkotno. Kot urednik se bom v Hesetovem in mojem imenu zahvalil vsem velikim in malim ljudem, ki so s svojim trudom in pozornostjo prispevali k tiskanju vseh štirih številk v zbirki Iliria. Sedaj, ko smo končno dobili ustrezen okvir za to veliko sliko, lahko skupaj naznaniva novico o skorajšnjem tiskanju knjige z naslovom Monumenta Albanica Justinopolitana. Naslov ne bi mogel biti boljši, ker vsebuje tri velike in težke besede: zapisana beseda lahko izgine ali je nerazumljena, toda *monument* ostaja in nagovarja vsakega, poleg tega so tukajšnje albanske družine zares pustila monumentalna dela materialnih razsežnosti: cerkve, spomenike, palače, ledinska imena, knjige, celo oblačila. S štirimi številkami revije Iliria smo odprli albanološke raziskave v Kopru. Vse publikacije so v albanščini, zaradi večinskega in manjšinskega prebivalstva so tudi opremljene s slovenskim in italijanskim prevodom. Justinopolis je bizantinsko ime za mesto Koper. Tudi v beneškem času so častitljivi in omikani ljudje tako

rekli Kopru, pa čeprav so živeli v beneški Capodistrii. Justinopolis je tudi mesto Justina iz rodu Justinijana, cesarja Vzhoda, Justiniani, njegovi potomci pa so kot begunci ustanovili to mesto. In ti so bili Albanci. Toda v tem mestu niso živeli zgolj potomci cesarske družine Pravičnih, kot so jim rekli doma Albanci, semkaj so se zatekli tudi potomci njim sovražne cesarske družine Komnenov, sami Dukagjiniji, ki so tako kot v rodnem kraju oskrbovali grad – kaštel in branili mejo. Tudi številni njihovi potomci in nasledniki, kot tudi na novo prispele družine, so dale posameznike, ki so se vpisali kot krepostni in častitljivi ljudje ter so zasedali visoka mesta v upravnem, cerkvenem, gospodarskem, vojaškem, šolskem, zdravstvenem in umetniškem področju. Vsa našteta imena smo tudi skušali navesti in jih boste našli v tej publikaciji. Letošnje leto kulturne dediščine posvečeno narodnemu heroju Skenderbegu pa smo zabeležili z objavo družinskega drevesa plemiške družine grofov Brutijev, v katerih se pretaka njegova kri, zato smo v spomin njegove nečakinje Orie Kastrioti poimenovali to publikacijo s pomenljivim imenom: Kri Skenderbegova v Kopru.

E DREJTA NË RATIFIKIM TË MARRËVESHJES MBI KUFIRIN NËNKUPTON EDHE TË DREJTËN NË REFUZIM TË SAJË

"Unë luftoj veç për liri
për erz tëm e për Shqypni"

Mar Lula, Lahuta e Malcisë

dr. Martin BERISHAJ

Lidhja e Marrëveshjes për kufirin në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi dhe pse isha kundër[1]

Republika e Kosovës dhe Mali i Zi në vazhdë të negociatave me shumë defekte diplomatike që janë bërë nga viti 2012 deri ne vitin 2015, kanë nënshkruar Marrëveshjen për kufi shtetërorë në mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, me 26 gusht 2015.

Marrëveshja në neni 2. përcakton se, në rast të mospërputhjes në mes përshkrimit gjuhësorë dhe përshkrimit të kufirit dhe kufirit të shënuar në hartën topografike në shkallë I : 25.000 (shtojca I e Marrëveshjes), do të mbizotërojë kufiri i shënuar në hartë topografike. Nga dokumentacioni i Komisionit paraprak nuk shihet qartë se në çfarë baze ishin të vizatuara pesë harta topografike në shkallë I : 25.000, e që, për hir të vërtetës, i kanë verifikuar te dy komisionet për kufijtë në mes dy shteteve. Në materialin e Qeverisë së Malit të Zi , që mbanë shenjen "INTERN" e që është në faqen zyrtare të sajë, e që përfshinë Marrëveshjen e parafuar (**se pas parafimit gjegjësisht autentifikimit të tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare, teksti i**

[1] Qëndrimi refuzues i Prof.dr. Martin Berishajt (ndaj procesit të miratimit të marrëveshjes kufitare në mes Kosoves dhe Malit te Zi ne Parlamentin e Kosovës, me ç'rast Kosova i humbi 82 km2) si anëtar i Komisionit Shtetërorë për Shenjimin e Kufirit Shtetërorë të Kosovës opinioni juridik dhe politologjik i mundësisë së mosratifikimit të Marrëveshjes për kufirin në mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi . Eksplikimi i tij para Qeverisë së Kosovës me 3.12. 2017 ne Prishtinë.

<u>sajë nuk guxon të ndërrohet më!),</u> në Shtojcën I të Marrëveshjes **janë të shtuara gjashtë harta topografike në shkallë I : 260.000**, e që prezanton <u>I0 fishin e devijimit nga shkalla e kërkuar e nenit 2</u>. të Marrëveshjes.



<u>Komisioni "Meha" dhe Hashim Thaçi nenshkruan versionin 1:260.000 në vend 1:25.000 !!!</u>[2]

Topografska karta <u>razmjera **I:260. 000** u digitalnom</u> obliku, sa ucrtanom graničnom linijom i koordinatama prelomnih graničnih tačaka Granična linija između Crne Gore i Republike Kosovo, prikazana je na Topografskoj karti razmjera I:260 000, na šest listova: I Bogićevica, 2 Čakor, 3 Vrelo Ibra, 4 Rožaje, 5 Rugovska klisura, 6 Kaličane.[3]

Kurse siç u cek më lartë në Marrëveshjen e nënshkruar janë shtuar **<u>vetëm pesë harta topografike në shkallë siç kërkon neni 2 i kësaj Marrëveshje.</u>**

Marrëveshja u nënshkrua në emër të Republikës së Kosovës nga ish Nënkryetari i parë i Qeverisë dhe Ministri i Punëve të Jashtme Hashim

[2] I mbetet historisë ta vlerësoj si do të trajtoj faljen e 82 km2 territor Malit te Zi!

[3] IZVJEŠTAJ o vođenju pregovora na pripremama za zaključivanje Sporazuma o državnoj granici između Crne Gore i Republike Kosovo, Podgorica, april 2015. godine.

Thaçi dhe Ministri i Punëve të Brendshme Skënder Hyseni, kurse nga ana e Malit të Zi, Nënkryetari i Qeverisë dhe Ministri i Punëve të Jashtme dhe integrimeve evropiane Igor Luksić dhe Ministri i Punëve të Brendshme Raško Konjević. Dëshmitarë gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes ishin prezent Kryetari i Qeverisë së Republikës së Kosovës Isa Mustafa, Kryetari i Malit të Zi Filip Vujanović dhe Ministri i Punëve të Jashtme të Republikës së Austrisë Sebastian Kurz. ish Nënkryetari i parë i Qeverisë dhe Ministri i Punëve të Jashtme Hashim Thaçi menjëherë pas nënshkrimit deklarojë se "Marrëveshja është në përputhje me Kushtetutë [të ish Jugosllavisë] nga viti 1974 , dokumentin e Presidentit Ahtisaari dhe Kushtetutë të Republikës së Kosovës «.[4]

Dua të tërhiqi vëmendjen se për shtete, deklaratat e udhëheqësve shtetërorë, kryetarëve të qeverive dhe ministrave të Punëve të Jashtme, janë ligjërisht të detyrueshme sipas të drejtës ndërkombëtare së përgjithshme zakonore. Kështu, deklarata e më sipërme, e ish Nënkryetarit të parë të Qeverisë dhe Ministri i Punëve të Jashtme Hashim Thaçi, e shpallur në web faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme, shihet si veprim i njëanshëm me efekte të detyrueshme juridike. Kjo do të thotë që pohimi i mospërputhjes së marrëveshjes së arritur në kufi me Kushtetutën e vitit 1974 [të ish-Jugosllavisë], dokumentet e Presidentit Ahtisaari dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjithashtu mund të vështirësohet me këtë.

Kushtetuta e ish RSFJ nga viti 1974 në nenin 5 përcakton:

"Territori i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë është unik dhe përbën territorin e republikave socialiste.

Territori i republikës nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e republikave, kurse territorin e Krahinës Autonome - pa pëlqimin e Krahinës Autonome.

Kufiri i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e të gjitha republikave dhe krahinave autonome.

Kufiri midis republikave mund të ndryshohet vetëm në bazë të marrëveshjes së tyre, e sa i përket kufirit të krahinës autonome - dhe në bazë të pëlqimit të saj."

[4] Shih shpalljen në faqën zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës me dt. 26. gusht 2015 në: http://www.mfa-ks.net/?page=2,217,2763 (18.10.2017).

Propozimi i tërësishëm për zgjidhjen e statusit të Kosovës (*Comprehensive Proposal For the Kosovo Status Settlement*), të cilin më 2 shkurt 2007, u propozua nga i dërguari i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Presidenti Martti Ahtisaari dhe më 25 mars 2007, u ndërmjetësua nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Ban Ki-moon, me mbështetjen e tij të plotë për Presidentin e Këshillit të Sigurimit të OKB-, në Aneksin VIII, me titull KOSOVO SECURITY SECTOR në kryerreshtin e dytë të nenit 3 (Kufijtë) përcakton:
»3.2 The territory of Kosovo shall be defined by the frontiers of the Socialist Autonomous Province of Kosovo within the Socialist Federal Republic of Yugoslavia as these frontiers stood on 31 December 1988, except as amended by the border demarcation agreement between the Federal Republic of Yugoslavia and the former Yugoslav Republic of Macedonia on 23 February 2001.«

Nga mundë të konstatojmë se propozimi i Ahtisaarit ka pasuar përdorimin e parimit të drejtës ndërkombëtare *uti possidetis* në konstatim të kufijve administrativ në mes ish Krahinës Autonome të Kosovës në suaza të RSFJ në datën kritike (critical date) 31. dhjetor 1988 për përcaktimin e të gjithë kufijve ndërkombëtarë të Kosovës , përpos kufirit me Maqedoni, për të cilin ishte arrijë marrëveshja për kufi në vitin 2001.
Kushtetuta e Republikës së Kosovës nga viti 2008 në dispozitat e përgjithshme në Kapitullin e parë në kryerreshtin e tretë të nenit I (Përkufizimi i shtetit) thotë se:
Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti.
Në nenin 2. (Sovraniteti) thuhet Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.
Në këtë kontekst vlenë të nënvizojmë edhe faktin se i ashq. Komisioni i Badinterit (*Conference on Yugoslavia Arbitration Commission*) në vitet

1991 dhe 1993 ka miratuar 15 opinione për çështjet e zhbërjes të ish Jugosllavisë. Sa u përket kufijve të ish republikave të RSFJ, komisioni i Badinterit në opinionin e tretë (3) ka konfirmuar status quon-në territoriale dhe ka konstatuar se, parimi i të drejtës ndërkombëtare *uti possidetis* i përdorshëm për përcaktimin e kufijve në mes shteteve trashëgimtare të ish RSFJ duke u përqendruar në faktin se, kufijtë e ish republikave behën kufij shtetërorë të siguruara me të drejtën ndërkombëtare, vetë në rast se do të merreshin vesh ndryshe.[5]

Nisur nga kjo që u tha më lartë, mundë të konkludojmë se pikënisja themelore për përcaktimin përfundimtarë të kufijve të Republikës së Kosovës me Malin e Zi, qoftë si :

I.) konstatim i rrjedhës së kufirit administrativ brenda suazave të ish RSFJ, kur ishte Kosova si Krahine Autonome, me ç'rast do të ishte data kritike (critical date), i cili është marrë si gjendje reale e që është relevant për delimitim, 1974 (Kushtetuta e RSFJ-së) apo 31 dhjetor 1988, siç del nga propozimi i Ahtisarit ;

ose

2.) konstatim i rrjedhës së kufirit në ditën e shpalljes e pavarësisë së Kosovës , pra me 17. Shkurt 2008 (critical date), duke marrë para sysh ndryshimet territoriale të mundshme deri në atë datë kritike .

Nisur nga konstatimi i dytë, pra ai i shpalljes së pavarësisë Kufijtë e një shteti (në rastin konkret të RSFJ) lidhur me përkufizimin e shteteve të formuara si trashëgimtare në mes veti, me shpalljen e pavarësisë së tyre, kanë pranuar efektin *uti possidetis* [6], në ditën e shpalljes së pavarësisë, të gjitha aktet nuk janë të bollshme e as mjaft precize të jenë si kusht për

---

[5] Badinter Commission, Opinion No. 3, p. 1499.

[6] Parimi i të drejtës ndërkombëtare, me ç'rast përkufizimet në mes njësive administrative pranohen si kufij shtetërorë pas shpalljes së pavarësisë. Ky parim është paraqitur në shekullin 19., në procesin e pavarësimit të kolonive latine amerikane. Aplikimin e këtij parimi e ka konfirmuar edhe Komisioni i Badinterit lidhur me shpërbërjen e RSFJ., e që në raportin e vetë të datës 3-11 janar të vitit 1992 ka theksuar se kufijtë e ish republikave federale akceptohen si kufij shtetërorë të cilat nuk mund të ndërrohen me forcë, por vetëm me marrëveshje. Si rrjedhojë, aty ku nuk pranohet ky parim,

demarkacionin e tyre përfundimtarë. Sipas ligjit ndërkombëtar, momenti i fitimit të pavarësisë cilësohet si "moment kritik" për qëllimet e zbatimit të rregullës (normës) *uti possidetis juris.* Ka edhe momente të tjera, megjithatë, të cilat cilësohen si "momente kritike" sipas së drejtës ndërkombëtare dhe që, zakonisht, i referohen momentit të lidhjes së një marrëveshje ndërkombëtare për delimitim, apo momentit të nxjerrjes së një verdikti gjyqësor apo arbitror me të cilin caktohet kufiri i ri shtetëror i një shteti të ri, përkundër apo krahas respektimit të rregullës *uti possidetis juris.*[7] Këtu duhet natyrisht, të kemi para sysh faktin se Serbia formalisht nuk e ka pranuar Kosovën, prandaj tash për tash nuk është e mundur as marrëveshja për delimitacion. Për secilën ish-republikë të pavarësuar nga shpërbërja e ish-federatave komuniste dihet saktësisht momenti kohor i fitimit të pavarësisë. Ky moment ka rëndësi dhe cilësohet "moment kritik" për faktin se një moment i tillë ka rëndësi për caqet dhe për mënyrën e trashëgimit të shteteve në të gjitha marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit pararendës. Si marrëdhënie në të cilat trashëgohet shteti pararendës janë: trashëgimi i shtetit pararendës në marrëdhëniet kontraktuese rreth kufijve dhe shtetësisë, borxhit të jashtëm, pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, aseteve, arkivave dhe gjërave të ngjashme me këto. Kur flitet për trashëgimin e shtetit pararendës në çështjen e kufijve, si parim/rregull e cila ndiqet është *uti possidetis juris.* Ky parim/rregull shërben si përcaktues i caqeve të vlefshmërisë së titullit

[7] Si "moment kritik", i njohur ndryshe edhe si "efekti kohor i *uti possidetis juris*", në të shumtën e rasteve merret momenti i ndërmarrjes së aktit të shpalljes së pavarësisë. Përveç këtij momenti, ekzistojnë edhe momente të tjera të ndërmarrjes së akteve të caktuara që kanë të njëjtin efekt, siç janë momenti i nxjerrjes dhe hyrjes në fuqi të vendimit gjyqësor ose arbitror, me të cilin caktohen kufijtë, momenti i lidhjes dhe paqes me të cilën caktohen kufijtë dhe zgjidhen kontestimet territoriale, momenti i nxjerrjes së një deklarate apo ndonjë vendimi tjetër që cakton mënyrat e delimitimit dhe shënjimit të kufijve mes shteteve të dhëna, dhe kështu me radhë. Cf. Georges Abi-Saab, "Le principe de l'uti possidetis : son role et ses limites dans la contentieux territorial international", në Marcelo G. Kohen (ed.), *Promoting Justice, Human Rights and Conflict Resolution Through International Law: Liber Amicorum Lucius Caflisch* (Martinus Nijhoff: The Hague, 2007) fq. 663-671.

juridik mbi bazën e të cilit më pastaj ravijëzohen vijat gjeometrike e lakimet gjeodezike në terren. Pa sqarimin se cili është caku i vënies në jetë të titullit juridik nuk mund të ketë ravijëzim në terren të vijave gjeometrike e lakimeve gjeodezike.

Titull juridik, ndërkombëtarisht i vlefshëm, paraqet çdo realizim i së drejtës për vetëvendosje të një populli apo të një territori, p.sh., rasti i Saharës Perëndimore, i cili nuk kontestohet nga *jus cogens* të së drejtës ndërkombëtare. Për Kosovën, ky titull derivohet nga realizimi i "shkëputjes shëruese" *(remedial secession)* të cilën Kosova e ka ekzekutuar më 17 shkurt 2008 kur ka shpallur njëanshëm aktin e pavarësimit nga Republika e Serbisë.[8] Si rregull në vend të parimit *uti possidetis*, do të mundë të përdoret parimi "juridiksion i përkohshëm"[9] e që, do të lehtësonte rrugën për zgjidhjen e tij[10]. Në kushte dhe rrethana normale, shtetet e reja tentojnë të përfundojnë të gjitha çështjet e lartpërmendura menjëherë pas njohjes ndërkombëtare të tyre dhe pranimit në OKB.

Negociatat ndërshtetërore lidhur me përkufizime dhe marrëveshjet e arritura mbi kufij bartin në veti veçanti të llojit të vet. Në vazhdë të kësaj, shtetet përcaktojnë kufijtë e tyre të ndërsjellët në kohë të pacaktuar dhe si të tilla ata kufij është shumë vështirë, gati është e pamundur të ndërrohen . Problemet dhe konfliktet territorial janë burim latent i konflikteve në të ardhmen me pasoja për të gjithë. Prandaj, marrëveshjet finale mbi kufij apo gjykimet

---

[8] Enver Hasani, Tema të zgjedhura nga e drejta dhe marrëdhëniet ndërkombëtare (Jalifat & Univ. Prishtinës: Hjuston, 2016) [në shtyp]. Cf. Jure Vidmar, "International Legal Responses to Kosovo's Declaration of Independence", *Vanderbilt Journal of Transnational Law* vol. 42, no. 3 (2009) fq. 814-818. Krahaso në veçanti literaturën që ky autor e përdor në fusnotat e tij, si dhe praktikën gjyqësore për rastin e ishujve Oland të Finlandës dhe të Kuebekut në Kanada.

[9] Po që se do të ekzistonte kategori e tillë në të drejtën ndërkombëtare, nuk do të ishin të përfshira me parimin *pact sunt servanda* (lat. marrëveshja duhet të respektohet) e konfirmuar me konventën e Vjenës në vitin 1969 si vijon: çdo marrëveshje që është ne fuqi i obligon palët që të realizojnë me vullnet të mirë".

[10] Parimi në fjalë i tërësisë fizike dhe natyrore hap shtegun e tij, bazuar në vendimin e gjykatës mbi arbitrazh të vitit 1977 mbi kanalin Beagle në mes Argjentinës dhe Kilit ; International Legal Materials 1988, No. 3.p. 673, paragrafi 108; poashtu vendimi i gjykatës së arbitrazhit nga viti 1988 në mes Eritresë dhe Jemenit (faza e parë) (RIAA) vol. XXVII, pp 314-315.

arbitrare mbi përkufizime janë bazë për bashkëpunimin e ardhshëm të shteteve në interes të gjithëve dhe paqes ndër tyre.
Mirëpo, arritja e këtyre lloj marrëveshjeve hap shteg për kompromise dhe gatishmëri brenda suazave të drejtës ndërkombëtare. Nëse një palë nga tjetra kërkon lëshime nëpërmes saj që garanton rregullat e të drejtës ndërkombëtare si dhe praktikat ndërkombëtare , ajo duhet të jenë e gatshme në këto lëshime në barrë të drejtave të veta, e në interes të palës tjetër.
Në krejt këto nuk ndihmojnë as deklaratat se nuk do të lejojmë " as një pëllëmbë toke" të territorit nacional. Marrëveshjet racionale mbi kufij mund të parandalojnë politikanët e si rrjedhojë edhe gazetaret nën ndikimin e tyre. Në moment që në publik rrjedhë informacioni lidhur me to si mundësi kompromisi, ato marrëveshje sulmohen nga të gjitha anët dhe trajtohen si tradhti nacionale. Pala tjetër si rregull shpesh ka perceptime të veta për të gjitha vlerat e që i interpreton në interes të vet. Prandaj, këto marrëveshje lihen në pafundësi me të gjitha pasojat që ato bartin me vete., përpos në rast kur pranojnë që këto marrëveshje të jenë çështje e gjykatës së arbitrazhit të pavarur. E në këtë pikë, është gati e pamundur të gjendet zgjidhja përfundimtare mbi kufij, pa intervenim nga jashtë. E ky fakt nuk u shkon për shtat respektimit të barazisë sovrane të shteteve të reja.
Në disa nga konventat mbi kodikifikimin e të drejtës ndërkombëtare vend të posaçëm kanë marrëveshjet mbi kufijtë, në relacion me marrëveshje tjera ndërkombëtare. Këtu duhet të ndalemi në nenet 11. dhe 12. të Konventës së Vjenës mbi sukcesion sa u përket marrëveshjeve ndërkombëtare nga viti 1978, konfirmojnë të drejtën pozitive në të drejtën ndërkombëtare, se sukcesioni i shteteve si i tillë nuk ndikon në kufi të krijuar me marrëveshje, në obligimet dhe të drejtat e dala nga marrëveshja e që kanë të bëjnë me regjimin kufitar, si bazë për regjime territoriale. Parimi i paprekshmërisë i kufijve ekzistues së shteteve, si njëri nga themelet e paqes ndërkombëtare dhe sigurisë në botë, është konfirmuar me nenin 62 (2)., te Konventat e Vjenës lidhur me të drejtën e marrëveshjeve nga viti 1969. Ky rregull përjashton thirrjen e një pale për ndërrim thelbësor të rrethanave si shkak i ndërprerjes apo suspendimit të marrëveshjes "nëse kufiri formësohet me marrëveshje".
Rregulli themeltar i të drejtës ndërkombëtare që rezulton nga neni 2(4) të Kartës se Kombeve te Bashkuara, e që edhe sot është normë imperativ (*ius*

cogens), parandalon çdo kërcënim me forcë apo përdorimin e forcës kundër pavarësisë territoriale dhe politike të çdo shteti.
Lidhur me marrëdhënien ndaj marrëveshjes me të cilën konfirmohet kufiri dhe vet kufirit të konfirmuar me marrëveshje, pa dyshim, rëndësi të posaçme ka vendimi i gjykatës ndërkombëtare nga viti 1994 mbi konfliktin territorial (Libi – Çad). Këtu bëhej fjalë për marrëveshjen fillimisht të arritur në vitin 1955 në afat njëzetvjeçar në mes Libisë dhe Francës. Çadi, pastaj, u pavarësua nga Franca në vitin 1960, kur ajo marrëveshje ishte ende në fuqi. Mirëpo, atë kufi edhe pas skadimit të afatit në vitin 1975 nuk e ka mohuar Çadi, por Libia.
Gjykata ka vendosur se, edhe pse marrëveshja ishte e afatizuar në kohë të caktuar, me të është konstatuar kufiri i përhershëm dhe se ai kufi kishte fatin e vet, pavarësisht nga marrëveshja e vitit 1955"... Marrëveshja një herë e arritur, kufiri mbetet, pasi çdo princip tjetër do të privohej nga efekti i parimit themelor mbi stabilitetin e kufirit. Natyrisht, kësi lloj rezultati mund të arrihet me gatishmërinë e ndërsjellët, por, kur një kufi ishte çështje e marrëveshjes, ekzistenca e tij varet nga ekzistimi i marrëveshjes me të cilin ai kufi është definuar[11].
Janë të rralla marrëveshjet që arrihen përjetësisht, si të tilla edhe nëse kanë ndodhur, nuk mund të mbesin në fuqi përjetësisht[12]. Mirëpo, qëndron fakti se marrëveshjet mbi kufijtë të cilat nuk kanë karakter të përkohshëm lidhen për afat të pacaktuar.
Shumica e marrëveshjeve, që palët i kanë ratifikuar sipas procedurës, janë në fuqi, dhe përmbajnë rregulla të llojllojta mbi anulimin apo tërheqjen nga ato. Për arsye se parashikohet anulimi i njëanshëm (në praktikë rrallë ndodhë), edhe ato janë të përfshira në nenin 25. Të Konventës së Vjenës. Nisur nga

---

[11] *Cf, I.C.J. Reports 1955, p. 37, para. 73*

[12] Para Luftës së Dytë Botërore dhe në fillim ët saj Mbretëria Serbo Kroate Sllovene ka lidhur "pakte për miqësi të përjetshme" me 24.01.1937 me Bullgarinë dhe me Hungarinë (12.12. 1940). Hungaria, në më pak se në pesë muaj e ka shkelur atë Pakt, dhe së bashku me Gjermaninë dhe Italinë bëri agresion në Jugosllavi, Kryeministri i saj Pal Teleki për shkelje të këtij Pakti, si akt moral, bëri vetëvrasje. Efekte tjera lidhur me këtë Pakt të miqësisë së përhershme nuk ka pasur.

kjo, marrëveshjet të cilat ekskluzivisht janë të arritura si të përkohshme, prodhojnë efekte juridike sikurse marrëveshjet tjera për derisa pala në mënyrë të njëanshme i anulon. Këto marrëveshjesh si rregull arrihen, për t'i ikur ratifikimit në parlamentet e palëve (shteteve), apo të shtyjë përfundimisht çështjen në interes të përbashkët në marrëveshje të veçanta për kohë më të mira.

Në të drejtën ndërkombëtare vlen rregulli se të gjitha marrëveshjet, pavarësisht nga emërtimi apo mënyra e arritjes së tyre, i obligojnë palët për derisa ato janë në fuqi. Kjo del nga definimi i "marrëveshjes" nga neni 2-I(a) i Konventës së Vjenës, nga parimi *pacta sunt servanda* të konfirmuar në nenin 28. Neni 30 i Konventës së Vjenës mbi parimin e kontratave të njëpasnjëshme mbi të njëjtën çështje, përparësi të vetme i jep Kartës së Kombeve të Bashkuara - neni 103. Duke i ngarkuar obligimet nga ajo, kanë përparësi në raport me obligimet nga cilido marrëveshje ndërkombëtare.

Në mes mënyrave të ndryshme të shprehjes së pëlqimit të një shteti të jenë i lidhur me marrëveshje në pajtim me nenet 11 deri 17 të Konventës së Vjenës, përpos nenit 14, parasheh ratifikimin, pëlqimin apo miratimin. Kurse marrëveshjet e pa ratifikuara (*les accord en forme simplifiee*)[13] ndaj Konventës së Vjenës i obligojnë palët në mënyrë të njëjtë si ato që janë të ratifikuara.

Do të ndalem pak, për të shpjeguar se çfarë efektesh juridike ka anulimi i njëanshëm i marrëveshjes lidhur me kufirin, kur plotësohen të gjitha kushtet që janë të parapara në tekstin e saj, apo kur janë pajtuar të gjitha palët që atë marrëveshje do ta pranojnë. Kur bëhet fjalë për marrëveshjet dypalëshe, neni 70(1) i Konventës së Vjenës parasheh, se anulimi i njëanshëm i liron të dy palët nga vazhdimi i realizimit të kësaj marrëveshjeje, ndërsa obligimet dhe të drejtat e palëve të dala nga realizimi i marrëveshjes para ndërprerjes së sajë nuk janë në dëm të asnjë të drejte.

Ndërkaq, kur bëhet fjalë për marrëveshjet mbi kufijtë, imponohet pyetja, se pala që e ka anuluar marrëveshjen, a e ka fitua të drejtën që në mënyrë të njëanshme ta rregullojë kufirin, regjimin kufitar dhe regjim tjetër territorial,

[13] Nga gjuha frënge, Marrëveshjet e thjeshtuara në formë

që ka të bëjë me atë çështje. A ka të drejtë në këtë situatë pala kundërshtare në anulim të njëanshëm?

Për të aplikuar parimin e të drejtës ndërkombëtare *uti possidetis* në të dy rastet duhet të argumentohet titulli juridik, pra baza juridike për zbatimin dhe shtrirjen e sovranitetit dhe juridiksionit të shtetit të Kosovës. Këtu pa dyshim duhen argumentuar bazat juridike në formë dokumentacioni, që tregojnë kufijtë e komunave të Republikës së Kosovës si Krahinë Autonome në ish Jugosllavi dhe hartat kadastrale (edhe pse duhet cekur qartë se parimi komunave kadastrale të cilat nuk kanë titull juridik, edhe pse janë precize, ne përkufizimin e fundit qe rezultojë me arbitrazh në mes te Republikës së Sllovenisë dhe Republikës së Kroacisë, në më shumë se 90% të rasteve të përkufizimit në tokë nuk ka treguar efekte pozitive. Nga kjo, çështja e parimit të komunave kadastrale, sa i përket Republikës së Kosovës, duke u nisur edhe nga fakti i kolonizimit në mes dy Luftërave Botërore[14] si dhe nga fakti se Kosova nuk ka kadastra origjinale! Si pasojë e vjedhjes së tyre nga Serbia, tregon qartë se nuk duhet të mbështetemi në to, edhe nga fakti se toka e cila ishte pronë shoqërore në ish Jugosllavi – kur bëhet fjalë për kreshta dhe kurrize malore, rrjedhe e ujit dhe burime ujore, si dhe bjeshkë -, duhet të merret parimi gjeografik i reliefit apo ajo që në të drejtën ndërkombëtare është e njohur si kufi natyral) mbase komunat kadastrale, edhe ne vende me traditë të rregullimit hapësinorë, kanë rezultuar si të pasakta në vendosjen e kufirit. Pikërisht, për të rrezuar idenë bazike të komunave kadastrale, duhet të shtrojmë përdorimin e parimit të *effectivités* (*uti possidetis de facto*) të konstatimit të shtrirjes efektive dhe zbatimit të pushtetit.

Siç ishin marrë vesh edhe më parë në disa raste tjera[15] shtetet për caktim të kufirit shtetërorë kanë marrë për bazë, ashtu edhe në caktim të kufirit

---

[14] Për më tepër shih : dr. Milan Obradović, »Agrarna reforma i kolonizacijan Kosova 1918-1941« Prishtine, 1981

[15] psh. në zgjidhjen e kufirit në mes Sllovenisë dhe Kroacisë ekspertet për përkufizim në takimin e parë me 26. maj 1992 janë dakorduar se"the definition of cadastral boundaries"

shtetërorë në marrëveshjen e nënshkruar në mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi , parimin e hartave kadastrale dhe komunave kadastrale.
Kufijtë e komunave kadastrore në të drejtën ndërkombëtare kanë karakterin e hartave gjeografike[16]. Vlera juridike e hartave mbetet e përkufizuar. Ato kanë vetëm një vlerë; atë të karakterit ndihmës, që e përjashton mundësinë që t'i jepet rëndësi më e madhe se sa *persumtio* (lat. parashikimi) *ius tantum* apo parashikime të rrëzueshme me efekt që mund të thyejnë argumentin si të tillë[17]. E tëra që Këshilli Gjyqësor është shprehur për harta gjeografike duket si *mutatis mutandis* e aplikueshme edhe për komunat kadastrore, të cilat mund të merren vetëm si kriter subsidiar lidhur me caktimin e kufijve në tokë. Ato janë precize, por jo më shumë se aq! Në shumicën e rasteve shprehen në praktikë si përputhje e ushtrimit të pushtetit të një organi të njërës apo palës tjetër në një territor të caktuar. Në rast, kur bëhet e qartë se njëra palë ka zgjeruar kufirin e komunës kadastrore, dhe kur ato nuk përputhen me kufirin, ato kanë vetinë e njëjtë si hartat gjeografike. Ato, si rregull ngarkojnë palën tjetër e cila konstaton të kundërtën, por nuk përmbajnë *titullus* juridik për sovranitet shtetëror.

2. efektet juridike të Marrëveshjes së nënshkruar për kufi në mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

Kosova është shtet i pavarur, sovran, që nga fillimi i lindjes së saj është zotuar për parimet e përgjithshme juridike, për rregullat në fuqi të drejtës zakonore ndërkombëtare. Po ashtu është angazhuar për marrëveshje ndërkombëtare, anëtare e të cilave është. Kosova nuk është anëtare e OKB dhe nuk është palë e marrëveshjeve multilaterale që janë lidhur në korniza të saj.
Marrëveshja ndërkombëtare që rregullon lidhjen, interpretimin dhe ndërprerjen e marrëveshjeve ndërkombëtare është Traktati i Vjenës mbi të

would be "the point of departure for the final decision" on the land boundary. Aide-Mémoire of the Meeting of Surveying and Mapping, Expert Delegations of the Republic of Slovenia and the Republic of Croatia for the Definition of the Border, 26 May 1992, çështje që ka vu në pah edhe gjykata e Arbitrazhit në kontestin kufitarë në mes Sllovenisë dhe Kroacisë me 29. 06. 2017 në fq. 14– shih: https://pcacases.com/web/sendAttach/2172.
6. Martin Berishaj, Zhberja e kufirit etnik, Tiranë, 2017, fq 171
[17] *I.C.J. Reports 1986,* p. 583, para. 56.

drejta të marrëveshjeve ndërkombëtare (*Vienna Convention on the Law of Treaties*) nga viti 1969. E që është në fuqi nga viti 1980 . Kosova nuk është nënshkruese e saje .

Në nenin 12 të marrëveshjes së nënshkruar për kufi ndërshtetërorë në mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi është përcaktuar se, marrëveshja do të hyjë në fuqi me ditën kur me rrugë diplomatike të pranohet lajmërimi i fundit me shkrim, me të cilën të dy palët reciprokisht lajmërohen se janë plotësuar procedurat e tyre të brendshme për fillim të hyrjes në fuqi të marrëveshjes në fjalë.

Pra, behet fjalë për rastin kur shtetet të cilat kanë lidhur dhe nënshkruar marrëveshje, por për hyrje në fuqi të saje, është i obligueshëm ratifikimi. Si kusht për fillim të hyrjes në fuqi të marrëveshjes është caktuar qartë, se shtetet janë të obligueshme që marrëveshjen konform me kërkesat e brendshme dhe procedurat e te dy shteteve së pari ta ratifikojnë në parlamentet e tyre. Pastaj, janë të obliguara që pas përfundimit me sukses të procedurave të brendshme juridike ta lajmërojmë me rrugë diplomatike. Pranimi i lajmërimit të fundit vlerësohet si përfundim i mos/ ratifikimit si kusht për përfundim të tij. Vetë nënshkrimi i – Marrëveshjes- pra, shtetin nuk e obligon me asgjë! Pas mosratifikimit të saje. Po ashtu nuk do ta obligonte as ratifikimi në të dy parlamentet. Pas përfundimit të këtij procesi nevojitet që me rrugë diplomatike të këmbejnë lajmërimet me shkrim. Vetëm me ditën e pranimit të lajmërimit të fundit me shkrim shtetet obligohen sipas të drejtës ndërkombëtare për hyrjen në fuqi të atij vendimi!

Dispozitat e Traktatit të Vjenës lidhur me të drejtat e kontratave ndërkombëtare (në vazhdim TVPMN), të rëndësishme për çështjen e përgjigjes në pyetje çfarë pasojash juridike kanë dalë ,e nënshkrimin e marrëveshjes për kufi në mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, **janë në nenet 11., 12., 14, 16., dhe 18.**

Neni 11. (mënyrat e pëlqimit të shteteve që i lidhë marrëveshja) TVPMN përcakton :

" Pëlqimi i një shteti për t'u detyruar nga një traktat ndërkombëtar mund të shprehet me nënshkrimin, shkëmbimin e dokumenteve që përbëjnë një traktat ndërkombëtar, ratifikim, pranim, aprovim ose aderim ose me ndonjë mjet tjetër të rënë dakord"

Konform me këtë nen Republika e Kosovës dhe Mali i Zi janë marrë vesh që marrëveshja detyrohet me ratifikim sipas të drejtës ndërkombëtare siç ishte e shënuar më lartë.

Po që se shtetet do të dëshironin që marrëveshja i detyron vetëm me nënshkrim, ata konform nenit I2 (mënyra e pëlqimit të shteteve që i lidhë marrëveshja me nënshkrim) TVPNM do të duhej eksplicite të shënohej në Marrëveshje, se a do të merren vesh palët gjegjësisht do të duhej të dalë nga autorizimi i përfaqësuesit të autorizuar të shtetit i cili e ka lidhë Marrëveshjen gjegjësisht, do të duhej qartë të tregoj atë QELLIM gjatë negociatave. Asgjë nga kjo nuk është plotësuar në rastin e lidhjes së Marrëveshjes .

Për konstatim të efekteve juridike të nënshkrimit konform me dispozitat e Marrëveshjes është i rëndësishëm kryerreshti i parë i nenit I4 (Pëlqimi i shtetit që ta detyrojë marrëveshja ndërkombëtare e eksplikuar me ratifikim, pranim apo aprovim) TVPNM qartë e përcakton:

"*I. Pëlqimi i një shteti për t'u detyruar nga një traktat ndërkombëtar do të shprehet me ratifikim kur:*

a) traktati ndërkombëtar parashikon që pëlqimi të shprehet me ratifikim;

b) është konstatuar se vendet negociuese kanë rënë dakord që ratifikimi është i domosdoshëm;

c) përfaqësuesi i saj nënshkruan traktatin ndërkombëtar me rezervën e ratifikimit ose

d) qëllimi i Shtetit për të nënshkruar një traktat ndërkombëtar, që i nënshtrohet ratifikimit, rrjedh nga autorizimi i përfaqësuesit të tij ose është shprehur gjatë negociatave ".

Siç eksplikohet qartë nga neni i mësipërm, neni I2 , Marrëveshja del se shtetet kanë lidhë marrëveshje ndërkombëtare e cila do të shprehet me ratifikim dhe kanë shprehur pëlqimin e vet për detyrim me Marrëveshje,vetëm pasi që të kryhet procedura e ratifikimit

Tutje neni I6. (Këmbimi apo deponimi i dokumenteve mbi ratifikim, miratim, pëqim apo aderim) TVPNM përcakton:

"Përveç nëse traktati ndërkombëtar parashikon ndryshe, instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit do të thotë se Marrëveshja ndërkombëtare e lidh :

a) duke i shkëmbyer ato midis Shteteve Kontraktuese;

b) me depozitimin e tyre tek depozituesi ose

(c) duke njoftuar zyrtarisht shtetet të cilat janë palë kontraktuese ose depozituesi, nëse është rënë dakord."

Rregullimi i nenit 12 të Marrëveshjes pason edhe dispozitën e nenit 16 të TVPNM ku si filli, i vlefshmërisë së Marrëveshjes përcaktohet vetëm dita kur të pranohet lajmërimi i fundit me shkrim mbi plotësimin e kushteve juridike për fillim apo hedhje poshtë të vlefshmërisë së Marrëveshjes (pra në momentin kur dorëzohet dokumenti-nota mbi (mos)ratifikim).

Së këndejmi, kur pjesa e madhe e Kosovës dhe politika kundërshton ratifikimin e marrëveshjes sepse si e tillë shpien në humbje të madhe të territorit të Kosovës duke përfshirë këtu edhe burimet e ujit, është tejet i rëndësishëm **neni 18. (obligimi për tu hedhur poshtë përmbajtja dhe qëllimi i marrëveshjes ndërkombëtare para hyrjes së sajë n fuqi)** TVPNM, përcakton:

"Shteti duhet të përmbahet nga veprimet që mund të shkatërrojnë objektin dhe qëllimin e traktatit ndërkombëtar nëse:

(a) nënshkruajnë një traktat ndërkombëtar ose dokumente shkëmbimi që përbëjnë traktatin ndërkombëtar, që i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit, derisa qartësisht nuk shpreh qëllimin e tij për të mos u bërë palë në traktat ndërkombëtar;

(b) të shprehë pëlqimin për t'u lidhur me një traktat ndërkombëtar, përpara hyrjes në fuqi të saj dhe me kusht që zbatueshmëria të mos shtyhet në mënyrë të pajustifikueshme".

Para së gjithash duhet të qesim në pah pikën a) të nenit 18., e cila shtetet nënshkruese të marrëveshjes ndërkombëtare i ngarkon me obligime të caktuara të drejtës ndërkombëtare që tejkalojnë obligimet sipas parimit të besimit të mirë (*bona fide*) dhe shteteve nënshkruese të marrëveshjes ndërkombëtare u jep në zgjidhje dy mundësi; si të sillen pas nënshkrimit e që është shprehur si më poshtë.

Pa dyshim se shteti nënshkrues i obligimit të dalë nga e drejta ndërkombëtare, që të përmbahet veprimeve, për shkak të cilave do të hidhej poshtë përmbajtja dhe qëllimi i marrëveshjes ndërkombëtare. Por kjo e fundit vlenë nëse:

I) për deri sa shteti nuk e ratifikon marrëveshjen ndërkombëtare – atëherë mbetet detyrim qe del nga drejta ndërkombëtare për tërësi të përmbajtjes së saje

ose

2) për deri sa **qartazi nuk e shpreh qellimin se nuk do të behet palë e marrëveshjes ndërkombëtare.**

Shteti vepron ashtu, për të hedhur poshtë përmbajtjen dhe qëllimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mënyrë duke qenë si shkelës i rregullave të drejtës ndërkombëtare, po që se ndonjë sjellje e tij do të shkaktonte situatë e cila më vonë do të implikonte dhe do të sa i përket ishte plotësimit të marrëveshjes ndërkombëtare dhe rregullave të sajë pa rëndësi. Nëse shteti tjetër do të dinte se pala e parë nënshkruese do të sillej në këtë mënyrë, marrëveshjen ndërkombëtare nuk do ta nënshkruante me kushte të njëjta dhe atë nuk do ta lidhte. **Vetë fakti i mos ratifikimit nuk donë të thotë assesi veprim, që do ta anulojë përmbajtjen dhe qëllimin e marrëveshjes ndërkombëtare.**[18]

Në rast që në Kosovë do të mbizotëronte qëndrimi se për shtetin kjo marrëveshje nuk është e pranueshme, mundë të thirret në rregullën e të drejtës ndërkombëtare e përfshirë në pikën a) të nenit 18., të TVPNM, me kusht që Kosova (gjegjësisht lidhur me të, konform me të drejtën ndërkombëtare përfaqësuesit e autorizuar në formë të rregulltë) QARTAZI të shprehin qëllimin se nuk do të behet kontraktuese e Marrëveshjes .

Në natyrën e pamohueshme e **të drejtës zakonore**[19] është përfshirë rregulla brenda nenit 18 të TVPNM në vitin 1966 të cilin Komisioni për të drejtë ndërkombëtare[20] duke u mbështetur në Gjykatën e përhershme

[18] Villiger, M.E., Commentary on the 1969 Vienna Convention on the Law of Treaties, Martinus Nijhoff Publishers, Leiden, Boston, 2009, fq. 249.

[19] Villiger, M.E., Commentary on the 1969 Vienna Convention on the Law of Treaties, Martinus Nijhoff Publishers, Leiden, Boston, 2009, fq. 252.

[20] ILC Draft 1966, YBILC 1966 II 202

ndërshtetërore në Haag për çështjen Certain German Interests in Polish Upper Silesia Case[21] nga viti 1926. Po ashtu ishte konfirmuar qëndrimi mbi natyrën e të drejtën zakonore edhe në praktikat e mëvonshme gjyqësore dhe në praktikat e shteteve .[22]

Kosova pra, pa dyshim mund të thirret në rregullimin brenda nenit 18 të TVPNM mbase nga dita e themelimit të sajë është e lidhur me të drejtën zakonore ndërkombëtare që është në fuqi.

Rregullimi në këtë nen ka rëndësi të veçantë në hedhje drite të numrit të madh të marrëveshjeve ndërkombëtare që nuk kanë filluar kurrë të vlejnë, mbase shtetet kanë mbetur vetëm në nënshkrim.[23]

Kosova mundet pra, kurdoherë pas nënshkrimit (por para ratifikimit apo jo të sajë) të shpreh qartë se nuk do të bëhet kontraktuese e Marrëveshjes mbi kufi në mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi . Këtë gjë mundë ta bëjë kështu:

a) **me deklarim të qartë** apo

b) **implicite me sjellje të vetë**, mbase propozimi i Malajzisë në konferencën kodifikuese TVPNM, se shteti ka për obligim që qëllimin e vet të shprehi qartë " me shprehje më të qarta" në Vjenë nuk u pranua dhe nuk ishte miratua nga ana e shteteve tjera.

Po që se Kosova e bënë këtë gjë, Mali i Zi nuk mundë të kërkoj më që Kosova të përmbahet në veprime, për të cilat mundë të hedhet përmbajtja dhe qëllimi i Marrëveshjes për kufi në mes të republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Vendimi mbi atë se a do të ratifikojë apo jo shteti marrëveshjen ndërkombëtare pas nënshkrimit është krejtësisht vendim subjektiv i çdo shtetit i cili sa i përket saj është tërësisht i lirë. E drejta ndërkombëtare

---

[21] PCIJ (1926) Series A no. 7, 30.

[22] Për me tepër shih: Gjykata e shkallës se I. e bashkësive evropiane në çështjen e *Opel Austria GmbH v. Council of the European Union*, ILR 113 (1999) 323; qendrimi i SHBA , se neni 18. nënkupton vlefshmërinë e të drejtës zakonore ndërkombëtare, International Lawyer 6 (1972) 431; përmbledhja e praktikës së SHBA dhe BAshkimit Sovjetik në Turner, Virginia JIL 21 (1981) 766 dhe tutje .; qendrimi i Qeverise Zvicerane në SJIR 37 (1977) 150 dhe vijuese.

[23] Shih p.sh.. Swaine, Stanford Law Review 55 (2003) 2085.

kontraktuale bazohet në pajtimin e vullnetit të shteteve dhe çdo njëri shtet është sovran në dhënie të pajtimit të vet, për deri sa nuk do të ishte në kundërshtim me normat kognitive të drejtës ndërkombëtare. Shikuar nga këndi i të drejtës ndërkombëtare, shtetet e treta nuk kanë asnjë arsyetim ndërkombëtarë juridik të kërkojnë nga shteti ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare.

Në doktrinë nuk është krejt e qartë se, a mundë të thirret shteti në faktin se është shkelur neni 18. i TVPNM, para se të shprehet qartë qëllimi i shtetit tjetër, të konfirmojë qartazi pas shprehjes së qartë të qëllimit si vijon. Për Kosovën është tejet me rëndësi që të merret qëndrimi a dëshiron Marrëveshjen ta ratifikoj apo jo, mbase teorikisht, Mali i Zi edhe pas vendimit të mëvonshëm të Kosovës, e cila do të shprehte qartë vullnetin e vet, do të pohonte se Kosova e ka shkel obligimin e vet ndërkombëtarë juridik, siç del nga neni 18., i TVPNM për periudhën e ndërmjetme, pra nga nënshkrimi e deri te shprehja e qartë se marrëveshjen nuk do ta ratifikojë.

3. konkulzioni

Është vendim sovran i Republikës së Kosovës lidhur me Marrëveshjen e kufirit në mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, se a do ta ratifikojë apo jo atë marrëveshje të nëbshkruar me 26.gusht 2015 Bazuar në të drejtën ndërkombëtare konform të rregullave juridiko zakonore që janë shkruar në nenin 18., të TVPNM e ka lirinë e plotë që kurdo herë pas nënshkrimit të shprehi qëllimin e vet qe Marrëveshjen mos ta ratifikojë dhe për këtë nuk ka nevojë që të arsyetohet.

Çështje tjetër me rëndësi pa dyshim është vlerësimi politik se kur është oportune qnjë gjë e tillë, posaçërisht duke pas para sysh se përfaqësuesi më i lartë i shtetit ka deklaruar se Marrëveshja është konform me aktet themelore në bazë të cilës është pavarësuar Kosova.

THE RUSSIAN-UKRAINIAN CONFLICT OVER CRIMEA

Dr. Anton BEBLER

Security on our continent has been for the last four decades burdened, i.a., by armed violence and wars accompanying the disintegration of a number of states in the Eastern Mediterranean, Western Balkans and on the territory of the former Soviet Union. These developments resulted in the appearance on the political map of Europe of more than a dozen new and internationally recognized states. Mostly successful secessions within some of these new states created in addition, a group of parastates unrecognized or less than universally recognized by the international community. Northern Cyprus, Transnistria, Abkhazia, Southern Ossetia, Nagorny Karabakh and later also Kosovo became to be treated in the international relations literature as so-called "frozen" conflicts in Europe and its vicinity. With Kosovo moving out of this group a newcomer appeared in spring 2014. This newcomer is the Ukrainian-Russian conflict over Crimea. It has been closely related to the attempted secessions and armed violence in Eastern Ukraine in which the Russian Federation has been heavily implicated. However, the conflict in Eastern Ukraine differs in several important respects from that over Crimea and, so far, its present outcome.

Studimi im merr shkas nga 107-vjetori i Kryengritjes së Malësisë së Madhe të vitit 1911, që do të kulmonte në datën 6 prill të vitit 1911, ditën e ngritjes së flamurit kombëtar shqiptar në majën e Bratilës, pas shumë shekujsh nën robërinë osmane. Ngritja e flamurit do të përforconte karakterin kombëtar të Kryengritjes, duke hedhur poshtë zërat e osmanëve për një Kryengritje të nxitur nga Mali i Zi apo thjesht për një lëvizje fetare.

Duke analizuar politikën armiqësore të xhonturqve ndaj malësorëve vëmë re se malësorët nuk do të qëndronin duarkryq, por në maj të vitit 1911 do të parashtronin kërkesat e tyre lidhur me krijimin e një vilajeti të vetëm shqiptar, ruajtjen e tërësisë territoriale, përdorimin e gjuhës shqipe në shkolla, kisha dhe zyrat e Shqipërisë etj., madje në mbledhjen e Pikalës, ata do të bënin të qartë faktin se do të luftonin deri në çlirimin e plotë të atdheut. Vihet re qartësisht se sikurse ngjarja e prillit e vitit 1911, edhe qershori i po të njëjtit vit do të vinte me një tjetër ngjarje historike, Kuvendin e Përgjithshëm të krerëve shqiptarë në Greçë, që do të dëshmonte edhe njëherë karakterin kombëtar të kësaj kryengritjeje. Ky Kuvend do të nxirrte një dokument të quajtur "Memorandumi i Greçës", i cili kishte në përbërjen e tij kërkesat autonomiste të malësorëve të trajtuara në 12 pika.

Një tjetër ngjarje e rëndësishme, e trajtuar hollësisht brenda këtij studimi, është ngjarja pasuese e gushtit të vitit 1911, moment në të cilin malësorët do të nënshkruanin në Podgoricë marrëveshjen e paqes me përfaqësuesit e qeverisë xhonturke. Kjo marrëveshje do të realizohej si pasojë e qëndrimit kërcënues të Rusisë dhe Austro-Hungarisë, të cilat nuk pranuan që Mali i Zi të hynte në luftë kundër Perandorisë Osmane nëpërmjet kryengritësve malësorë. Ata do të kërkonin ndërprerjen e ndihmave ndaj

kryengritësve dhe shtyrjen e tyre drejt armëpushimit. Të gjendur në këtë situatë malësorët do të dorëzoheshin, pasi Mali i Zi do t'i kërcënonte ata me zi të bukës. Ngjarjet që do të vijonin në Malësi janë tregues të mirëfilltë se kryengritja e malësorëve nuk do të ndalonte, pasi Porta nuk do të zbatonte pothuajse asnjë nga pikat e marrëveshjes së paqes.

Në fokus të këtij studimi do të jetë edhe qëndrimi i politikës ndërkombëtare ndaj Kryengritjes së Malësisë së Madhe. Fuqitë e Mëdha si Gjermania, Franca dhe Anglia duke mos pasur interesa të drejtpërdrejta në Ballkan mbajtën qëndrim mospërfillës ndaj kësaj kryengritjeje, ndërsa Austro-Hungaria, Italia dhe Rusia u munduan të përfitonin prej saj, për shkak të planeve të tyre gjeopolitike në këtë rajon. Edhe disa shtete ballkanike do të bënin gjithçka që Kryengritja të dështonte pasi nuk iu interesonte krijimi i një shteti autonom shqiptar, që do të binte ndesh me interesat e tyre ekspansioniste. Ndërkaq Mali i Zi u mundua me të gjitha mënyrat ta shfrytëzonte Kryengritjen, duke synuar përmes saj realizimin e pretendimeve të tij territoriale mbi tokat shqiptare. Nga ana tjetër Porta e Lartë do ta cilësonte Kryengritjen si lëvizje të të krishterëve, duke dashur të mohonte karakterin kombëtar të saj. Mirëpo me ngritjen e flamurit kombëtar në Deçiq dhe me programin mbarëkombëtar të Greçës u vërtetua se Kryengritja nuk ishte as lëvizje lokale, as fetare dhe as e nxitur nga Mali i Zi.

Vështrim i përgjithshëm mbi Kryengritjen e vitit 1910 në vilajetin e Kosovës dhe shtrirja e saj në vilajetin e Shkodrës

Në fillimet e dekadës së dytë të shek. XX, Shqipëria thyen përfundimisht varësinë politike nga pushtuesi osman duke shënuar momente vendimtare në aspektin kombëtar, politik e kulturor. Marrëdhëniet shqiptare me xhonturqit ishin tensionuar së tepërmi. Mbledhja e taksave të prapambetura, çarmatosja e popullsisë, rekrutimi i shqiptarëve në ushtrinë turke, presioni që gjuha shqipe të shkruhej me shkronja arabe dhe centralizimi radikal i pushtetit do të çonin në luftë të armatosur kundër xhonturqve. Kudo në vilajetin e Kosovës u organizuan kuvende shqiptare, ku do të diskutohej rreth organizimit të kryengritjeve antiosmane. Nga ana

tjetër qeveria osmane do të shpallte gjendjen e jashtëzakonshme duke marrë masa të menjëhershme për shtypjen e kryengritjes, arrestimin e kryengritësve, regjistrimin e popullsisë dhe pasurisë së patundshme, rekrutimin e ushtarëve, mbledhjen e taksave, mbylljen e klubeve e gazetave etj.[55] Në muajin prill 1910, Shefqet Turgut pasha në krye të 40 mijë ushtarëve iu drejtua vilajetit të Kosovës për të vendosur rregull dhe qetësi. Kryengritja e Kosovës pati jehonë të madhe, sidomos në Malësinë e Madhe, prandaj turqit përdorën të gjitha mjetet për të penguar ndikimin e saj në viset e tjera shqiptare.[56] Duke dashur t'u shpëtonin përndjekjeve nga osmanët, shumë familje shqiptare nga Kosova dhe Malësia e Madhe u strehuan në Mal të Zi, mes tyre dhe shumë patriotë shqiptarë. Populli malazez dhe ai shqiptar i Malit të Zi pritën miqësisht refugjatët shqiptarë, ndërsa krajl Nikolla mendonte t'i shfrytëzonte ata për qëllimet e tij aneksioniste drejt Shqipërisë së Veriut.[57]

Ndërkohë që operacione luftarake vazhduan në muajt qershor-korrik në mjaft zona të Kosovës, turqit po përgatiteshin për të sulmuar në drejtim të Shkodrës, Dibrës, Lumës, Rugovës e Plavës. Kështu Shefqet Turgut pasha u nis në drejtim të Shkodrës për të nënshtruar Malësinë e Madhe që ishte çuar në kryengritje. Malësorët e Gashit, Krasniqes e Bytyqit u zunë pritë turqve në Qafë-Morinë, ndërsa dukagjinasit në Qafë të Kolçit, prandaj Shefqet Turgut pasha u detyrua të hynte në Shkodër përmes Pukës, në korrik 1910.[58] Kudo u shkatërruan fshatra, u terrorizuan banorët, u çarmatosën malësorët, u zbatua rrahja publike, burgosja pa gjyq, dënimi me vdekje, u ngritën gjyqe ushtarake, u grabit pasuria, u mblodhën taksa, u rekrutuan ushtarë, u ngritën shkolla turke, u vendos gjuha turke në administratë,

---

[55]Stavro Skendi, *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912,* Tiranë: PHOENIX: Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2000, fq. 368-370; Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX,* Tiranë: IDEART, 2004, fq. 49-50; Romeo Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914,* Tiranë: UET/PRESS, 2012, fq. 52-53

[56]Gjergj Nikprelaj, *Kryengritja e Malësisë e vitit 1911,* New York: Gjonlekaj Publishing Co., 2004, fq. 55, 71

[57]*Historia e Popullit Shqiptar II,* Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: TOENA, 2002, fq. 434-437; Nikollë Ivanaj, *Historija e Shqipëniës së ré, vuajtjet e veprimet e mija,* Pjesa e parë, Tiranë, 1943, fq. 18; Eqrem Vlora, *Kujtime (1885-1925)*, Tiranë: Botimet IDK, fq. 250

[58]Gj. Nikprelaj, *Kryengritja e Malësisë...,* fq. 63

shkrimi i gjuhës shqipe me alfabet arab, u mbyll Normalja e Elbasanit, u ndalua botimi i gazetave, dhe u bë regjistrimi i popullsisë, pasurisë, tokave, bagëtive etj., për efekt taksash.[59] Gjatë pranverës 1910 malësorët me në krye Dedë Gjo Lulin do të kërkonin nga valiu i Shkodrës, Bedri Pasha kthimin e armëve, heqjen e taksave te reja, emërimin e një kajmekani të krishterë, hapjen e shkollave kombëtare dhe hapjen e rrugëve, në të kundërt nuk pranonin kthim në atdhe. Meqë Bedri Pasha i hodhi poshtë kërkesat e tyre, kryengritja filloi nga mesi i vitit 1910.[60]

Rusia i trembej shpërthimit të luftës mes Malit të Zi dhe Perandorisë Osmane, kështu që kërkoi nga Mali i Zi që emigrantët shqiptarë të ktheheshin sa më parë në shtëpitë e tyre, pasi në të kundërt do të hiqte subvencionet. Qëndrim të njëjtë mbajtën edhe fuqitë europiane, sepse nuk iu interesonte një ndërlikim i ri në Ballkan. Vjena kërkonte nga malësorët që të mos hidheshin në kryengritje, ndërsa Porta kërkonte që shqiptarëve t'iu jepeshin liritë e kërkuara. Krajl Nikolla u shpreh i gatshëm për kthimin e emigrantëve, por këmbënguli për nënshkrimin e një marrëveshjeje mes qeverisë malazeze dhe Portës së Lartë[61] duke dashur të nxirrte përfitime në kurriz të shqiptarëve.

Në janar 1911, në Itali u themelua Komiteti "Pro Albania", i propozuar nga Partia Republikane, që kishte për qëllim mbledhjen e ndihmave në të holla për kryengritësit dhe regjistrimin e vullnetarëve italianë në mbështetje të kryengritësve shqiptarë. Ndërkohë Nikollë Ivanaj krijoi në Bari Organizatën Kombëtare të Shqipërisë që do të vendoste lidhje me kolonitë e mërgimit dhe komitetet e fshehta në Shqipëri në ndihmë të kryengritjes dhe për shtrirjen e saj në të gjithë Shqipërinë.[62] Në fillim të prillit 1911, gjeneral Ricciotti Garibaldi u shpreh i gatshëm për të marrë pjesë në kryengritjet shqiptare, mirëpo u pengua nga qeveria italiane, e cila i druhej një konflikti

[59]Edith Durham, *Lufta për Shkodrën,* Shkodër: Camaj – Pipa, 2005, fq. 42-43; Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942),* Tiranë: NERAIDA, 2000, fq. 51; Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*, PHOENIX, 1998, fq. 212-213

[60]R. Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914,* fq. 71-75; Ndoc Nikaj, *Shkodra e Rrethueme,* Shkup: Vatra, 2012, fq. 49-50

[61]Gj. Nikprelaj, *Kryengritja e Malësisë...,* fq. 79, 138-140

[62]N. Ivanaj, *Historija e Shqipëniës së ré...,* fq. 18, 23-24

me Austro-Hungarinë. Megjithatë në kryengritjen e Malësisë arritën rreth 30 vullnetarë italianë.[63]

Shpërthimi i Kryengritjes në Malësinë e Madhe dhe veprimet luftarake

Në muajin shkurt të vitit 1911, u themelua Komiteti i kryengritësve në Podgoricë që do të kishte për qëllim organizimin e kryengritjes, mbledhjen e ndihmave, strehimin e emigrantëve dhe shpërndarjen e ushqimit tek të gjithë të strehuarit në Mal të Zi. Komiteti i Podgoricës me në krye Sokol Bacin e Grudës do të bënte përpjekje të vazhdueshme tek Mbret Nikolla për të siguruar ndihma ushtarake, ndërsa Dedë Gjo Luli dhe Isa Boletini ishin kundër ndihmës nga trupat malazeze. Marrëdhëniet mes malësorëve dhe mbret Nikollës do të përkeqësoheshin, pasi kryengritësit nuk pranuan të vinin lëvizjen e tyre nën urdhërat e qeverisë malazeze dhe flamurit malazez. Për këtë arsye mbreti malazez jo vetëm që u ndërpreu ndihmat ushqimore, por edhe i detyroi të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Kryengritësit nuk pranuan që të dorëzoheshin në dorë të xhonturqve, por shpërthyen në kryengritje të armatosur për të fituar lirinë e shumëkërkuar.[64] Kështu më 24 mars 1911, në Rapshë të Hotit filloi Kryengritja e udhëhequr nga Dedë Gjo Luli, Kolë Marash Vata, Zef Lani e Gjon Pëllumbi, dhe brenda 3 ditëve ranë në duart e kryengritësve të gjitha fortifikatat kufitare përgjatë kufirit turko-malazez nga liqeni i Shkodrës deri në Gusi. Kalaja e Shipshanikut u rrethua, ndërsa Malësia u çlirua deri në Koplik.[65] Gjatë gjithë Kryengritjes, malësorët

---

[63]Oreste Camillo Mandalari, *Indipendenca shqiptare. Ndihmesa italiane në dritën e dokumenteve*, Tiranë: UEGEN, 2008, fq. 98, 106, 161-175

[64]Kristo Frashëri, *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (28 Nëntor 1912)*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008, fq. 59; Basri Lika, "Kryengritja e Malësisë së Madhe një hap i rëndësishëm drejt pavarësisë", *100 vjet nga Kryengritja e Malësisë 1911-2011* (Përmbledhje kumtesash dhe materiale të tjera), Tuz: Illyricumi, 2012, fq. 126; Gjergj Berisha, "Kryengritja e Malësisë së Madhe e vitit 1911 dhe politika zyrtare e Malit të Zi", *Kryengritja e Malësisë 1911 (1911-2001)* - (materialet e simpoziumit shkencor, Malësi 7-8 mars 2001), Tuz: Illyricum, 2001, fq 157

[65]Gj. Nikprelaj, *Kryengritja e Malësisë...*, fq. 163-165, 171; Gj. Berisha, *Kryengritja e Malësisë së Madhe...*, fq. 159; Marenglen Verli, "Përgatitja e Kryengritjes së Malësisë së Madhe sipas

llogarisnin rreth 3 mijë luftëtarë, ndërsa forcat turke ishin të shumta në numër dhe të organizuara mirë. Rezistenca e malësorëve për 6 muaj shpjegohet si rezultat i njohjes së mirë të terrenit dhe këmbënguljes për të fituar liri të plotë. Osmanët përmes valiut të Shkodrës Bedri Pasha u munduan të shkaktonin përçarje mes kryengritësve duke e quajtur Kryengritje të të krishterëve. Kjo taktikë e xhonturqve parashihte përçarjen e shqiptarëve duke dashur t'i tregonte botës se shqiptarët janë ngritur për çështje fetare dhe jo kombëtare.[66] Megjithatë shumë patriotë shkodranë iu bashkuan kryengritësve malësorë. Kryengritja u mbështet edhe nga malësorët e rënë nën Mal të Zi që nga Kriza Lindore 1875-1881, të ardhur nga Triepshi, Koja, Fundënat etj. Gjithashtu gjithë Dukagjini dhe sidomos të rinjtë e Shalës nën udhëheqjen e Mehmet Shpendit, morën pjesë në Kryengritjen e Malësisë që nga fillimi e deri në mbarim. Por krahas burrave malësorë luftuan dhe gratë heroina si Tringë Smajlja, Nore Kolja etj. Më 28 mars kryengritësit morën qytezën e Tuzit, dogjën kazermën dhe shtinë në dorë depot e armëve, duke detyruar ushtrinë osmane të mbyllej në kalanë e Shipshanikut. Disfata e osmanëve do të bënte që në drejtim të vilajetit të Shkodrës të niseshin batalione të reja me pajisje luftarake të rënda, që situata të mbahej nën kontroll.[67] Kështu osmanët, të nisur nga Shkodra nën komandën e major Emin Beut, dogjën e shkatërruan çfarë gjetën para, duke mos kursyer as kishat dhe qelat e besimtarëve dhe famullitarëve të Malësisë.[68]

Në mbledhjen e kryengritësve shqiptarë më 30 mars në Cetinë u miratua një memorandum prej 5 pikash, i nënshkruar nga Dedë Gjo Luli, Sokol Baci, Isa Boletini, Muharrem Bushati, Abdulla Aga, Mehmet Shpendi dhe Preng Mark Kola, që përmbante disa kërkesa të rëndësishme me karakter autonomist kombëtar dhe u drejtohej Fuqive të Mëdha dhe mbretit

dokumentacionit austro-hungarez", *100 vjet nga Kryengritja e Malësisë 1911-2011* (Përmbledhje kumtesash dhe materiale të tjera),Tuz: Illyricumi, 2012, fq. 48

[66]*Historia e Popullit Shqiptar II,* fq. 444; Dom Ndoc Nikaj, *Kujtime të nji jetës së kalueme,* Tiranë: Plejad, 2003, fq. 120-121

[67]R. Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914,* fq. 135-136; Antonello Biagini, *Historia e Shqipërisë nga zanafilla deri në ditët tona,* Tiranë: SHTËPIA E LIBRIT dhe KOMUNIKIMIT, 2000, fq. 63

[68]N. Nikaj, *Kujtime të nji jetës...,* fq. 122

malazez.[69] Duke qenë se Porta po përgatitej për luftë kundër Italisë për çështjen e Tripolit, u bëri shqiptarëve disa lëshime, për të shuajtur konfliktin me malësorët. Megjithatë Kryengritja nuk do të ndalej, pasi malësorët kërkonin autonomi të plotë të Shqipërisë. Luftime të ashpra u zhvilluan më 6 prill në Tuz, Kastrat, Helm, Vranë, Dinoshë dhe sidomos në Deçiq, që ishte epiqendra e ushtarëve turq nga ku kontrollonin Malësinë. Malësorët morën Deçiqin dhe po atë ditë në majën e Bratilës, Nikë Gjelosh Luli do të ngrinte për herë të parë, pas kaq shekujsh robërie flamurin shqiptar në emër të të gjithë shqiptarëve. Kjo ditë mori emrin "Dita e Shqipnisë".[70] Ngritja e flamurit kishte rëndësi të madhe pasi mbahej lart morali i kryengritësve dhe tregohej qartë karakteri i saj kombëtar, duke hedhur poshtë propagandën osmane që tentonte ta paraqiste Kryengritjen si vegël të mbret Nikollës apo lëvizje fetare. Osmanët do të mësyjnë Malësinë edhe nga ana veriore duke dërguar nga Gjakova ushtri nën komandën e Et'hem Pashës, mirëpo do të thyhen keqas tek Hani i Gropës së Zezë nga banorët e Kelmendit pa arritur të shkojnë drejt Tuzit.[71]

Pasi valiu i Shkodrës Bedri Pasha nuk po shënonte ndonjë rezultat për shtypjen e Kryengritjes së malësorëve, në vend të tij u emërua Shefqet Turgut pasha, i cili më 18 prill zbarkoi në Shëngjin. Shefqet Turgut pasha u bëri thirrje malësorëve të ktheheshin në shtëpitë e tyre dhe të hiqnin dorë nga Kryengritja, përndryshe nuk do të trajtoheshin më si nënshtetas të Perandorisë Osmane.[72] Malësorët e hodhën poshtë këtë kërkesë, prandaj osmanët sulmuan. Më 18 prill në rrjedhën e poshtme të Përroit të Thatë, kryengritësit i bënë ushtrisë turke qëndresë të fuqishme dhe po këtë ditë ata do të korrnin fitore në Selcë. Ndërkohë më 27 prill 1911, arbëreshi Terenc Toçi mblodhi një Kuvend në Mirditë me pjesëmarrës nga Mirdita, Puka, Dukagjini, Lura, Dibra, Zadrima e Gjakova që shpallën pavarësinë e Shqipërisë me kryetar Terenc Toçin. Kjo lëvizje kishte për qëllim nxitjen e

---

[69] *Historia e Popullit Shqiptar II,* fq. 445; Arkivi i Institutit të Historisë (më tej: AIH), Dosja (më tej: D.): A-IV-10, Karl Ritter Von Sax, *Historia e tatëpjetës së Turqisë,* Wien, 1913, fq. 20

[70] Gj. Nikprelaj, *Kryengritja e Malësisë...,* fq. 174, 200; Lulash Palushaj, *Malësia dhe fiset e saj,* (Pjesa II), Lezhë: "Gjergj Fishta", 2010, fq. 294

[71] Gj. Nikprelaj, *Kryengritja e Malësisë...,* fq. 205

[72] A. Biagini, *Historia e Shqipërisë nga zanafilla...,* fq. 65; E. Durham, *Lufta për Shkodrën,* fq. 47

këtyre krahinave në kryengritje, në mbështetje të Malësisë, mirëpo ky aksion nuk do kishte ndonjë sukses për Kryengritjen dhe jetëgjatësia e kësaj qeverie do të ishte e shkurtër.[73]

Më I maj 1911, kryengritësit dolën me një proklamatë me anë të së cilës deklaronin se nuk do t'i lëshonin armët nëse nuk do të realizohej krijimi i një vilajeti të vetëm shqiptar, ruajtja e tërësisë territoriale, përdorimi i gjuhës shqipe në të gjitha shkollat, kishat dhe zyrat e Shqipërisë, mbajtja e shkollave shqiptare nga shteti etj. Këto kërkesa nuk u pranuan nga Porta e Lartë, pasi në thelb synohej autonomia e Shqipërisë.[74] Malësorët thyen qëndresën osmane në rrugën drejt Shkodrës më 3 maj, dhe Luigj Gurakuqi do të shprehej se "do të kishim marrë edhe Shkodrën, po të kishim pasë armë ".[75] Më 10-11 maj Shefqet Turgut pasha nxori në Shkodër një proklamatë prej 12 nenesh, ku u premtonte kryengritësve shqiptarë falje nëse ata dorëzoheshin brenda 5 ditëve, duke përjashtuar nga falja 8 krerë malësorë, që do të nxirreshin para gjyqit ushtarak. Kryengritësit u përgjigjën përmes një deklarate të nënshkruar nga 60 udhëheqës malësorë në mbledhjen e Pikalës, e cila iu paraqit edhe konsujve të huaj në Cetinë më 12 maj. Dokumenti shprehej kundër djegies dhe rrënimit të shtëpive të kryengritësve nga ushtritë osmane, kundër dhunës mbi nderin e malësorëve, kundër mbylljes së shkollave etj. Sipas tyre kthimi në atdhe do të realizohej kur Stambolli të siguronte drejtësi dhe barazi mes shqiptarëve, kur të respektonte zakonet dhe traditat e tyre, kur populli shqiptar të pranohej si komb, të jetonte i lirë si çdo popull tjetër etj., në të kundërt do të luftonin deri në fund për çlirimin e atdheut.[76] Më 14 maj Shefqet Turgut pasha goditi befasisht malësorët në Deçiq dhe shkatërroi me artileri gjithë fshatrat që bënë qëndresë, por edhe kishat katolike shqiptare. Kjo i revoltoi malësorët,

[73]Shukri Rahimi, *Lufta e shqiptarëve për autonomi (1897-1912)*, Botimi i dytë, Prishtinë, fq. 181

[74]R. Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914,* fq. 160-162; A. Biagini, *Historia e Shqipërisë nga zanafilla...,* fq. 71

[75]*Historia e Popullit Shqiptar II,* fq. 447

[76]R. Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914,* fq. 167-168; Gj. Nikprelaj, *Kryengritja e Malësisë...,* fq. 218-219

pasi ata nuk kishin prekuar asnjë xhami gjatë kryengritjes.[77] Në qershor 1911 do të shpërthejë në Lezhë dhe Mirditë kryengritja antiosmane, e cila do të japë sinjalin e shtrirjes së kryengritjes edhe në treva të tjera shqiptare. Ajo do të shtrihej edhe në jug të Shqipërisë.

Mali i Zi më 22 maj u deklaroi Fuqive të Mëdha, se ishte i përgatitur për luftë kundër Turqisë, por nuk u përkrah nga asnjëra prej tyre. Austro-Hungaria dhe Rusia i kërkuan Portës që shqiptarëve t'u bëheshin disa lëshime në mënyrë që krizës t'i jepej fund. Kjo ndërhyrje rezultoi e suksesshme, pasi Shefqet Turgut pasha më 17 qershor shpalli amnisti të përgjithshme për kryengritësit shqiptarë nëse dorëzonin armët brenda një afati 10-ditor. Malësorët nuk u tunduan pasi nuk kishin garanci për zbatimin e këtyre lëshimeve dhe luftuan deri në fund për të drejtat e tyre.[78] Porta kërkoi nga Austro-Hungaria të ndërhynte në Vatikan dhe përmes tij tek kleri katolik shqiptar për t'i bindur malësorët të dorëzonin armët. Austria e priti mirë këtë propozim, pasi mundësohej kufizimi i kryengritjes, mbajtja nën kontroll e situatës dhe ruajtja e ndikimit tradicional mbi klerin dhe popullsinë katolike.[79] Porta e Lartë përmes angazhimit të arqipeshkvit të Shkodrës synonte të nxirrte jashtë loje mbretin malazez. Arqipeshkvi i Shkodrës mori përsipër këtë detyrë të vështirë ndërmjetësimi për t'iu paraqitur malësorëve kushtet e ofruara prej osmanëve. Së bashku me arqipeshkvin, udhëtuan edhe at Gjergj Fishta dhe dom Luigj Bumçi. Por imzot Serreqi në takimin e Podgoricës, nuk iu përmbajt propozimit austriak dhe i njoftoi kryengritësit se ata nuk duhej të ndikoheshin prej misionit të

---

[77] E. Durham, *Lufta për Shkodrën,* fq. 48-49

[78] Nertila Haxhia-Ljarja, Sereta Koperaj, "Kryengritja e vitit 1911 e Malësisë së Mbishkodrës sipas Zv. konsullit britanik në Shkodër, Nikolla Summa", *100 vjet nga Kryengritja e Malësisë 1911-2011* (Përmbledhje kumtesash dhe materiale të tjera), Tuz: Illyricumi, 2012, fq. 176; Sh. Rahimi, *Lufta e shqiptarëve për autonomi...,* fq. 184; Mid'hat Frashëri, *Elita shqiptare*, Tiranë: Plejad, 2008, fq. 52; Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939,* Tiranë: Toena, 2009, fq. 15

[79] Romeo Gurakuqi, "Aspekte të qëndrimit të klerit katolik shqiptar në agimin e pavarësisë shqiptare: (mars 1911-maj 1914)", *Krishtërimi ndër shqiptarë* (Simpozium Ndërkombëtar Tiranë, 16-19 nëntor 1999), Shkodër, 2000, fq. 280-281

tij,[80] mision i cili do të dështonte. Për pasojë, mbret Nikolla do të mbetej figurë qendrore e negociatave mes Portës dhe malësorëve.

Memorandumi i Greçës dhe Marrëveshja e Podgoricës

Kryengritësit malësorë, të cilët nuk hoqën dorë nga kërkesat autonomiste dhe kundërshtuan nënshtrimin ndaj xhonturqve, me nismën e Komitetit të Podgoricës thirrën Kuvendin e Përgjithshëm të krerëve shqiptarë në pllajën e Greçës së Triepshit nga 10-23 qershor 1911. Kuvendi i përbërë nga paria e Malësisë, famullitarë të saj dhe patriotë të tjerë shqiptarë, miratoi dokumentin e quajtur "Memorandumi i Greçës". Ky Memorandum, i quajtur ndryshe "Libri i Kuq", kishte karakter kombëtar mbarëshqiptar dhe pajisi kryengritjen me një program politik që do të bëhej edhe programi i gjithë Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.[81] Memorandumi përbëhej nga 12 pika dhe kërkonte autonominë e Shqipërisë në kuadër të 4 vilajeteve.[82] Më 26 qershor, "Libri i Kuq" iu paraqit ambasadorit turk në Mal të Zi, mbretit malazez dhe ambasadorëve të Fuqive të Mëdha të akredituara në Cetinë. Një memorandum i veçantë do t'i dërgohej edhe qeverisë angleze si propaganduese e lirisë së kombeve të shtypura.[83] Ministri i Jashtëm anglez, Grey, pasi shqyrtoi kërkesat e shqiptarëve, kërkoi nga Fuqitë e Mëdha që të ndërhynin pranë Stambollit, por nuk gjeti asnjë mbështetje. Qeveria osmane i quajti të papranueshme kërkesat e malësorëve pasi sillnin shkatërrimin e Perandorisë. Edhe shqiptarët e jugut më 21 korrik 1911 mbajtën një Kuvend në Manastirin e Cepos (Gjirokastër), ku miratuan

[80] Gj. Nikprelaj, *Kryengritja e Malësisë...*, fq. 196

[81] Ferdinando Salleo, *Shqipëria: gjashtë muaj mbretëri,* Tiranë: Shtëpia e Librit & Komunikimit, 2001, fq. 32; N. Smirnova, *Historia e Shqipërisë...*, fq. 53; L. Palushaj, *Malësia dhe fiset e saj,* fq. 313

[82] Stefanaq Pollo, Selami Pulaha, *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912,* Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë - Instituti i Historisë, 1978, fq. 223-226 dokumenti (më tej: dok.): 142;

[83] *Historia e Popullit Shqiptar II,* fq. 451; Frashër Demaj, "Qëndrimi i fuqive të mëdha ndaj Kryengritjes së vitit 1911", *100 vjet nga Kryengritja e Malësisë 1911-2011* (Përmbledhje kumtesash dhe materiale të tjera),Tuz: Illyricumi, 2012, fq. 217

një memorandum drejtuar qeverisë xhonturke, i cili përkrahte Kryengritjen e Malësisë së Madhe dhe programin e saj politik për autonomi të Shqipërisë si dhe kërkesën për shtrirjen e reformave në të gjitha vilajetet shqiptare. Më 18 gusht 1911 në Tepelenë, turqit njohën disa koncensione edhe për Shqipërinë e Jugut, por që qëndronin shumë larg programit të Greçës.[84]

Duke qenë se Rusia nuk pranonte që Mali i Zi të hynte në luftë kundër Perandorisë Osmane nëpërmjet kryengritësve, ajo bënte presion që të ndërpriteshin ndihmat ndaj malësorëve dhe të shtyheshin drejt armëpushimit. Me ndërhyrjen e Rusisë dhe Austro-Hungarisë, më 28 korrik, u arrit marrëveshja mes osmanëve dhe malazezëve për rregullimin e çështjes së kufirit dhe kthimit të kryengritësve në atdhe.[85] Mbreti Nikolla duke dashur të përfitonte nga roli i ndërmjetësit, mblodhi përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha në Cetinë duke u shprehur se koncensionet turke duhej të riformuloheshin dhe të sigurohej një garanci evropiane për zbatimin e tyre, në të kundërt edhe kjo përpjekje do të dështonte, pasi malësorët nuk hiqnin dorë nga 12 kërkesat e tyre. Kështu mbreti Nikollë mori miratimin e riformulimit të kërkesave.[86] Mali i Zi, pasi siguroi kompensimet materiale për mbajtjen e emigrantëve shqiptarë, bëri të gjitha veprimet e nevojshme për sigurimin e paqes mes malësorëve dhe osmanëve. Më 31 korrik në Podgoricë, ambasadori turk Sadredin beu i shoqëruar nga emisarë malazezë u ul për bisedime me malësorët, por duke qënë se malësorët nuk lëviznin nga kërkesat e Greçës, Porta kërcënoi që afati i fundit i dorëzimit ishte 3 gushti, dhe po ashtu njoftoi qeverinë malazeze, se në qoftë se vazhdonte t'i nxiste malësorët më tej, trupat osmane do t'i dëbonin malësorët përtej kufirit.[87] Qeveria ruse reagoi pranë oborrit malazez dhe këta të fundit bënë presion

---

[84]Gazmend Shpuza, *Në vazhdën e gjurmimeve për epokën e Rilindjes Kombëtare,* Tiranë: TOENA, 1997, fq. 274-275; Abas Ermenji, *Vendi që zë Skënderbeu në historinë e Shqipërisë,* Tiranë: ÇABEJ, 1996, fq. 300

[85]*Historia e Popullit Shqiptar II,* fq. 457; Sokol Gjermeni, *Kryengritja Shqiptare e vitit 1911 në optikën e diplomacisë evropiane dhe ballkanike,* Tiranë: TOENA, 2011, fq. 54

[86]R. Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914,* fq. 274-275; Gazmend Rizaj, *Shqipëria e Sipërme 1800-1913,* Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2011, fq. 213

[87]Gj. Nikprelaj, *Kryengritja e Malësisë...,* fq. 293; Gazmend Shpuza, *Në prag të pavarësisë,* New York: EAGLE PRESS, fq. 144

mbi malësorët që të pranonin kërkesat turke duke i kërcënuar me zi të bukës. Kështu malësorëve nuk u kishte mbetur rrugë tjetër përveç se të dorëzoheshin. Malësorët kërkuan që së paku ato të drejta që do t'iu njiheshin atyre t'iu njiheshin gjithë shqiptarëve, mirëpo xhonturqit nuk pranuan. Të gjendur në një situatë mjaft të vështirë dhe pa asnjë mbështetje, më 2 gusht 1911 malësorët nënshkruan në Podgoricë marrëveshjen e paqes me përfaqësuesit e qeverisë xhonturke.[88] Sokol Baci kërkoi nga ministri turk që kushtet të shkruheshin në letër dhe të nënshkruheshin nga vetë ai, pasi nuk kishin besim në premtimet turke, por propozimi nuk u pranua. Duke mos pasur rrugë tjetër, pjesa më e madhe e kryengritësve u strehuan në shtëpitë e tyre brenda Perandorisë Osmane gjatë 5, 6 dhe 7 gushtit. Veprimet për riatdhesimin e tyre u ndoqën nga afër prej Edith Durhamit, e cila vëzhgoi zbatimin e marrëveshjes nga ana e turqve.[89] Dedë Gjo Luli me gjithë shpërblimet, postet dhe pensionet e ofruara nga xhonturqit nuk pranoi të bindej për t'u kthyer në atdhe derisa nuk njihej autonomia e Shqipërisë. Më 21 korrik 1911 "The Times" e Londrës, shkruan: "Ishte kjo një mbrojtje e lavdishme e cila, kur të shkruhet historia e asaj kohe, do të hyjë në radhën e episodeve më të shkëlqyera të luftimit modern".[90] Duke qenë se ndërkombëtarët nuk dhanë asnjë garanci për lëshimet e bëra, Porta nuk do të zbatonte pothuajse asnjë pikë të koncensioneve të bëra. Të ndodhur në këtë situatë tejet të vështirë për mbijetesë, malësorët do të bëjnë gjithçka që të sigurojnë armë dhe të fillojnë kryengritjen e radhës për çlirim të plotë nga pushtimi shekullor turk.

Qëndrimi i Fuqive të Mëdha dhe shteteve ballkanike kundrejt Kryengritjes

Për sa i përket qëndrimit të Fuqive të Mëdha ndaj kryengritjes së Malësisë, mund të themi se ai ishte mospërfillës, injorues dhe po ashtu kundërshtues i kërkesave të shqiptarëve për liri dhe autonomi të Shqipërisë.

[88]Nevila Nika, *Përmbledhje dokumentesh mbi kryengritjet shqiptare (1910-1912)*, Prishtinë: Instituti I Historisë, 2003, fq. 157-160 dok. 91; Sh. Rahimi, *Lufta e shqiptarëve për autonomi...*, fq. 187

[89]E. Durham, *Lufta për Shkodrën,* fq. 84-85

[90]Gj. Nikprelaj, *Kryengritja e Malësisë...*, fq. 239; T. Zavalani, *Histori e Shqipnis*, fq. 213

Duke qenë se Gjermania, Franca dhe Anglia nuk kishin interesa të drejtpërdrejta në Ballkan, politika e tyre ishte pasive. Anglia do të interesohej për fatin e kryengritjes, vetëm atëherë kur malësorët do t'i dërgonin një peticion më 23 qershor që ajo të ndërhynte tek Fuqitë e tjera për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Ajo pranoi të ndërhynte, pavarësisht se nuk gjeti mbështetje.[91] Pothuajse të njëjtin qëndrim do të mbanin edhe Austro-Hungaria, Italia dhe Rusia, por në ndryshim nga Fuqitë e sipërpërmendura ato u munduan të përfitonin nga kjo kryengritje. Austro-Hungaria, mbrojtjen e interesave të saj në Ballkan dhe shtrirjen drejt Adriatikut, mund t'i realizonte vetëm përmes ekzistencës së Perandorisë Osmane, për këtë arsye qëndrimi i mbajtur ndaj shqiptarëve u bazua në ruajtjen e pozitave të status quo-së. Vetëm gjatë muajit qershor të vitit 1911, Vjena u interesua për çështjen shqiptare, duke i kërkuar Stambollit disa lëshime kulturore në favor të shqiptarëve, pasi çështja e Kryengritjes së Malësisë kishte filluar të ndërkombëtarizohej. Por Austro-Hungaria, e indinjuar që malësorët nuk ia kishin drejtuar asaj memorandumin me kërkesat e tyre, por diplomacisë angleze, nuk do ta pranonte propozimin anglez për një ndërhyrje të Fuqive pranë Portës për njohjen e të drejtave për shqiptarët, dhe as propozimin ruso-malazez që shqiptarëve t'u garantoheshin premtimet turke.[92] Në Itali, kryengritja e Malësisë u pa me simpati nga opinioni publik, dhe pritej mobilizimi i vullnetarëve nën komandën e Ricciotti Garibald-it dhe dërgimi i tyre në Shqipërinë e Veriut, mirëpo kryeministri Giolitti do të ndalonte me çdo mjet vajtjen e tyre.[93] Italia dëshironte të shmangte nga Ballkani, shqetësime që mund të ktheheshin në avantazh të Rusisë dhe Austro-Hungarisë, prandaj nuk mbështeti as agresionin e mundshëm malazez dhe as kryengritjen shqiptare.[94] Megjithatë duke parë neglizhencën e Austrisë ndaj Kryengritjes, ajo u mundua ta shfrytëzonte këtë avantazh për të fituar

---

[91]Romeo Gurakuqi, "Rreth qëndrimit të Fuqive të Mëdha ndaj Kryengritjes së Malësisë së Madhe të vitit 1911", *Kryengritja e Malësisë 1911 (1911-2001)* - (materialet e simpoziumit shkencor, Malësi 7-8 mars 2001), Tuz: Illyricum, 2001, fq. 69

[92]S. Gjermeni, *Kryengritja Shqiptare e vitit 1911...*, fq. 70-76

[93]O. C. Mandalari, *Indipendenca shqiptare...*, fq. 80-82

[94]S. Gjermeni, *Kryengritja Shqiptare e vitit 1911...*, fq. 94, 110-111; R. Gurakuqi, *Rreth qëndrimit të Fuqive të Mëdha...*, fq. 72

simpatinë e shqiptarëve, duke këshilluar Stambollin që të mbante një qëndrim më të përmbajtur dhe më të moderuar ndaj shqiptarëve. Rusia kërkonte të mbetej faktor i dorës së parë në Ballkan, duke kërkuar nga Porta që të ishte e vëmendshme në veprimet e saj kundrejt Malit të Zi dhe t'i jepte zgjidhje sa më të shpejtë problemit me malësorët.[95] Shteti rus e shfrytëzoi krizën e Malësisë për të fituar simpatinë e shteteve sllave duke mbrojtur Malin e Zi dhe po ashtu për të fituar simpatinë e Evropës dhe Turqisë, si ruajtëse e balancës gjeopolitike në Ballkan.

Për sa i përket shteteve ballkanike, ato u munduan të përfitonin nga Kryengritja, ose në rast të kundërt të bënin gjithçka që ajo të dështonte pasi nuk donin që shqiptarët të fitonin autonominë. Bullgaria nuk pranoi kërkesën e shqiptarëve për ndihmë pasi ajo nuk i konsideronte ata faktor të rëndësishëm politik në Ballkan, ndërsa Greqia e ndihmoi kryengritjen, pasi i interesonte një luftë e mundshme mes Malit të Zi dhe Perandorisë Osmane, në mënyrë që edhe vëmendja e shqiptarëve të përqendrohej në veri të Shqipërisë. Por kur Kryengritja u shtri edhe në jug, ajo ndryshoi qëndrim.[96] Malësorët iu drejtuan për ndihmë edhe Serbisë përmes patriotit Nikollë Ivanaj, mirëpo serbët u shprehën se dëshironin të mbanin marrëdhënie të mira me Perandorinë Osmane dhe se ishin kundër çdo veprimi që mund të cënonte paqen në Ballkan. Kështu Serbia këshillonte Portën që t'i jepte fund problemit shqiptar, pasi nuk donte që çështja shqiptare të ishte diskutim i politikës ballkanike dhe që mbret Nikolla të fitonte pozitë të privilegjuar nga Kryengritja e Malësisë.[97] Mali i Zi u mundua me të gjitha mënyrat ta shfrytëzonte këtë Kryengritje, duke synuar që përmes saj të realizonte pretendimet e tij territoriale mbi tokat shqiptare. Sipas Durhamit, malësorët nuk ishin në dijeni për planet e Malit të Zi, ata luftonin për autonomi.[98] Gjatë zhvillimit të Kryengritjes, Mali i Zi i ndihmoi malësorët me ushqime, veshmbathje, para dhe armë, mirëpo meqenëse shqiptarët nuk iu bindën urdhërave të tij që të luftonin nën flamurin malazez, ai iu ndërpreu ndihmat

[95]Gj. Nikprelaj, *Kryengritja e Malësisë...*, fq. 225
[96]S. Gjermeni, *Kryengritja Shqiptare e vitit 1911...*, fq. 196-211
[97]R. Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914,* fq. 261; Sh. Rahimi, *Lufta e shqiptarëve për autonomi...*, fq. 181-182
[98]E. Durham, *Lufta për Shkodrën,* fq. 50

në mënyrë që të nënshtroheshin me anë të urisë. Gjithashtu malazezët i detyruan të nënshkruanin marrëveshjen e paqes me osmanët duke i përdorur si vegla, dhe kur ndërmarrja e tyre ushtarake dështoi, ata nxituan t'i nxirrnin malësorët jashtë shtetit të tyre për t'iu provuar Fuqive të Mëdha pafajësinë në këtë Kryengritje.[99]

Shtetet ballkanike duke mos dashur të pranonin realitetin e vërtetë të Kryengritjes, e quanin atë vepër të ndonjë fuqie tjetër rivale, në këtë rast të Austrisë apo Italisë. Të njëjtën strategji përdorte edhe Porta që e quante lëvizje të të krishterëve, duke dashur t'i mohonte karakterin kombëtar. Mirëpo me ngritjen e flamurit kombëtar në Deçiq dhe me programin mbarëkombëtar të Greçës u vërtetua se Kryengritja nuk ishte as lëvizje lokale, as fetare dhe as e nxitur nga Mali i Zi, siç dëshironin ta quanin armiqtë e Shqipërisë.

BIBLIOGRAFIA

I - Burime arkivore të pabotuara

- Arkivi i Institutit të Historisë – Tiranë (AIH)
- AIH, Dosja: A-IV-10, Karl Ritter Von Sax, *Historia e tatëpjetës së Turqisë,* Wien, 1913

II - Burime dokumentare të botuara

- NIKA Nevila, *Përmbledhje dokumentesh mbi kryengritjet shqiptare (1910-1912),* Prishtinë: Instituti I Historisë, 2003
- POLLO Stefanaq, PULAHA Selami, *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912,* Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë - Instituti i Historisë, 1978

III - Literatura Historike

[99]Edith Durham, *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike,* Tiranë: Argeta-LMG, 2001, fq. 232; S. Gjermeni, *Kryengritja Shqiptare e vitit 1911...,* fq. 162

- BERISHA Gjergj, "Kryengritja e Malësisë së Madhe e vitit 1911 dhe politika zyrtare e Malit të Zi", në: *Kryengritja e Malësisë 1911 (1911-2001)* - (materialet e simpoziumit shkencor, Malësi 7-8 mars 2001), Tuz: Illyricum, 2001
- BIAGINI Antonello, *Historia e Shqipërisë nga zanafilla deri në ditët tona,* Tiranë: SHTËPIA E LIBRIT dhe KOMUNIKIMIT, 2000
- DEMAJ Frashër, "Qëndrimi i fuqive të mëdha ndaj Kryengritjes së vitit 1911", në: *100 vjet nga Kryengritja e Malësisë 1911-2011* (Përmbledhje kumtesash dhe material tjera), Tuz: Illyricumi, 2012
- DURHAM Edith, *Lufta për Shkodrën,* Shkodër: Camaj – Pipa, 2005
- DURHAM Edith, *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike,* Tiranë: Argeta-LMG, 2001
- ERMENJI Abas, *Vendi që zë Skënderbeu në historinë e Shqipërisë,* Tiranë: ÇABEJ, 1996
- FRASHËRI Kristo, *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (28 Nëntor 1912),* Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë , 2008
- FRASHËRI Mid'hat, *Elita shqiptare,* Tiranë: Plejad, 2008
- GURAKUQI Romeo, "Aspekte të qëndrimit të klerit katolik shqiptar në agimin e pavarësisë shqiptare: (mars1911-maj 1914)", në: *Krishtërimi ndër shqiptarë* (Simpozium Ndërkombëtar Tiranë, 16-19 nëntor 1999), Shkodër, 2000
- GURAKUQI Romeo, "Rreth qëndrimit të Fuqive të Mëdha ndaj Kryengritjes së Malësisë së Madhe të vitit 1911", në: *Kryengritja e Malësisë 1911 (1911-2001)* - (materialet e simpoziumit shkencor, Malësi 7-8 mars 2001), Tuz: Illyricum, 2001
- GURAKUQI Romeo, *Shqipëria 1911-1914,* Tiranë. UET/PRESS, 2012
- GJERMENI Sokol, *Kryengritja Shqiptare e vitit 1911 në optikën e diplomacisë evropiane dhe ballkanike,* Tiranë: TOENA, 2011

- HAXHIA-LJARJA Nertila, KOPERAJ Sereta, "Kryengritja e vitit 1911 e Malësisë së Mbishkodrës sipas Zv. konsullit britanik në Shkodër, Nikolla Summa", në: *100 vjet nga Kryengritja e Malësisë 1911-2011* (Përmbledhje kumtesash dhe material tjera), Tuz: Illyricumi, 2012
- *Historia e Popullit Shqiptar II,* Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: TOENA, 2002
- IVANAJ Nikollë, *Historija e Shqipëniës së ré, vuajtjet e veprimet e mija,* Pjesa e parë, Tiranë, 1943
- LIKA Basri, "Kryengritja e Malësisë së Madhe një hap i rëndësishëm drejt pavarësisë", në: *100 vjet nga Kryengritja e Malësisë 1911-2011* (Përmbledhje kumtesash dhe material tjera), Tuz: Illyricumi, 2012
- MANDALARI Oreste Camillo, *Indipendenca shqiptare. Ndihmesa italiane në dritën e dokumenteve,* Tiranë: UEGEN, 2008
- NIKAJ Dom Ndoc, *Kujtime të nji jetës së kalueme,* Tiranë: Plejad, 2003
- NIKAJ Ndoc, *Shkodra e Rrethueme,* Shkup: Vatra, 2012
- NIKPRELAJ Gjergj, *Kryengritja e Malësisë e vitit 1911,* New York: Gjonlekaj Publishing Co., 2004
- PALUSHAJ Lulash, *Malësia dhe fiset e saj (Pjesa II),* Lezhë: "Gjergj Fishta", 2010
- PUTO Arben, *Shqipëria politike 1912-1939,* Tiranë: Toena, 2009
- RAHIMI Shukri, *Lufta e shqiptarëve për autonomi (1897-1912),* Botimi i dytë, Prishtinë
- RIZAJ Gazmend, *Shqipëria e Sipërme 1800-1913,* Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2011
- SALLEO Ferdinando, *Shqipëria, gjashtë muaj mbretëri,* Tiranë: Shtëpia e Librit & Komunikimit, 2001
- SKENDI Stavro, *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912,* PHOENIX

- SMIRNOVA Nina, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX,* Tiranë: IDEART, 2004
- SHPUZA Gazmend, *Në vazhdën e gjurmimeve për epokën e Rilindjes Kombëtare,* Tiranë: TOENA, 1997
- SHPUZA Gazmend, *Në prag të pavarësisë,* New York: EAGLE PRESS
- VERLI Marenglen, "Përgatitja e Kryengritjes së Malësisë së Madhe sipas dokumentacionit austro-hungarez", në: *100 vjet nga Kryengritja e Malësisë 1911-2011* (Përmbledhje kumtesash dhe material tjera), Tuz: Illyricumi, 2012
- VLORA Eqrem, *Kujtime (1885-1925),* Tiranë: Botimet IDK
- VLORA Syrja, *Kujtime,* Tiranë: "ICEBERG" PUBLISHING HOUSE, 2013
- VLLAMASI Sejfi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942),* Tiranë: NERAIDA, 2000
- ZAVALANI Tajar, *Histori e Shqipnis,* PHOENIX, 1998

ANEKSIMI I KISHAVE KATOLIKE TË KRYEDIOQEZËS SË SHKODRËS NGA ANA E MALIT TË ZI (1878-1913)

Dom Nikë UKGJINI

Lëkundjet politike dhe kishtare

Kongresi i Berlinit, i cili ishte thirrur më 13 qershor 1878 nga Fuqitë e Mëdha, për të rishikuar traktatin e Shën Stefanit, kishte marrë përsipër të hartonte një hartë të re politike të Gadishullit të Ballkanit të robëruar nga Perandoria Osmane, pa lënë anash përfitimet territoriale në kurriz të popullit shqiptar, që do të gëzonin shtetet fqinje të Ballkanit, si Greqia, Bullgaria, Serbia dhe Mali i Zi. [100]Për shkak të gjendjes së faktit në terren, Kongresi nuk pranoi ta ndërtonte hartën politike të Evropës Juglindore në bazë të parimit të kombësisë, por vendimet u morën sipas interesave të njërës apo tjetrës fuqi të mëdha. Në Kongresin e Berlinit edhe përkundrejt peticioneve protestuese për mos copëtimin e trojeve shqiptare, të dërguara nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Fuqitë e Mëdha, duke i identifikuar shqiptarët në masën 70 % të islamizuar me turqit, pa ndonjë hezitim

---

[100] H. GROTHE, *Durch Albanien und Montenegro,* München, 1913, fq.. 150, 153; A. BALDACCI, *L' Albania,* Roma, 1930, fq. 136, 138; *Enciclopedia Cattolica*., vol. VIII, Firence, 1952, fq. 1361; *Enciklopedija Jugoslavije,* vol. 3, Zagreb, 1984, fq. 157: Në enciklopedin e lartpërmendur ndër të tjera thuhët: " Malit të Zi iu është dhën: Podgorica, Tivari, Plava dhe Guci më një numër të konsiderushëm të banorëve shqiptarë"; J. JOVANOVIĆ, Stvaranje Crnogorske Državе i razvoj Crnogroske nacionalnosti, Cetinje, 1947, fq.. 322-323. Ai thotë : »Mali i Zi i ka dyfishuar trevat e veta. Pikërishtë pas Kongresit të Berlinit sipërfaqja e tij ka patur 8.655 km ^{2} por për afërsisht 7.000 km ^{2} më pak siç ka qenë e paraparë sipas po vendimëve të paqës së Sanstefanit."; H.D. SCHANDERL, *Die Albanienpolitik Österreich-Ungarns und Italiens 1877–1908*, botuar. Otto Harrassowitz, Wiesbaden,1971, fq.. 41.

vendosën që tokat shqiptare të behën plaçkë tregu ndërmjet Perandorë Osmane, Greqisë, Bullgarisë, Serbisë dhe Mali të Zi. [101]
Mbretëria e Malit të Zi, për të cilën bën fjalë tema, nga ky Kongres, pos të tjerash, kishte përfituar trevat më etni shqiptare: Podgoricën, Tivarin, Kolashinin, Plavën dhe Gucinë e Rugovën, kurse në vitit 1880 edhe Ulqinin.[102] Copëtimi i trojeve shqiptare pati pasoja jo vetëm politike kombëtare, por edhe pasoja të rënda fetare.
Dioqeza e Tivarit, me vendimet e Kongresit të Berlinit, vërtetë nuk gjendej më tej brenda shtetit islamik, por brenda një shteti ri të krishterë. Për të, nga ky moment, fillon momenti i ri i ballafaqimit të drejtpërdrejtë me sllavoortodoksizmin. Në lidhje më marrjen nën kontroll të dioqezës së Tivarit e cila tashmë gjendej në trevën e Mbretërisë, knjaz Nikolla që në vitin 1878 i ishte drejtuar për ndihmesë ideologut të *"unionit sllav"*, ipeshkvit të Gjakovës (Kroaci), Josip Juraj Strossmayerit (1815-1905), duke kërkuar prej tij që të ndërmjetësojë tek Selia e Shenjtë, (Vatikani) për kinse ripërtëritjen e dioqezës së Tivarit. Me atë rast knjazi i Malit të Zi, Strosmayerit i shkroi edhe këtë:*"Mali i Zi si shtet i pavarur i pranuar, nuk mund të pranojë që një pjesë e shtetasve të tij, qoftë edhe vetëm nga aspekti fetar, të varet nga një pushtet në kufijtë e tij, aq më tepër, kur ai gjendet në perandorinë turke,"* [103]duke aluduar kështu në faktin se kryedioqeza e Tivarit në vitin 1867 i ishte bashkuar asaj të Shkodrës, e cila asokohe ende gjendej brenda kufijve osman. Lutjen e knjazit të Malit të Zi, Strossmayeri e pranoi krahëhapur, pasi ideja e tij për nënshkrimin e konkordatit në mes të Selisë së Shenjtë dhe Unionit të Sllavëve të jugut, gjegjësisht Rusisë dhe Serbisë

[101] N. DOM UKGJINI, *Veshtrim i shkurtër historik mbi zhvillimin e katolicizmit në Ulqin gjatë shekujve,* Simposiumi: Ulqini në rrjedhat e kohës, 26-27 maj, Ulqin, 2000. fq. 80. K. FRASHERI, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, 1878-1881, ASHSH, vol.I, Tiranë, 1989, fq. 210-211.

[102] *Enciklopedija Jugoslavije,* vol. 3, o.c. fq.. 103; J. JOVANOVIĆ, o.c., fq.. 323-324; P. BARTL, *Die albanischen Muslime zur der Nationalen Unabhängikteitabewegung*: Albanische Forschungen, band, 8, botuar. S.Otto Harrassowitz–Wiesbaden 1968, fq. 115-116; H.D. SCHANDERL *o.c.,* fq.. 41-42.

[103] M. ZÖLLER; *O odnosima J. J. Štrosmajera prema Crnoj Gori:IZ*, 1-2, Titograd, 1978, fq. 179-180; K. NIKOLA, *Politički spisi*, Titograd, 1989, fq. 187-190; Për Unien e sllave krahaso: F. ŠIŠIĆ, J. *Strossmayer i jugoslovenska misao,* pjesa e parë, Beograd, 1922;

kishte pësuar mossukses. Kështu, bisedimet në mes të Malit të Zi dhe Selisë së Shenjtë të filluara më parë, të cilat Rusia i shikonte si dinakëri politike. Ato përfunduan më 18 gusht të vitit 1886 me nënshkrimin e konkordatit me katërmbëdhjetë nene, i cili u ratifikua më 7 tetor të të njëjtit vit.[104]

Me këtë konkordat kryedioqeza e Tivarit nga aspekti kishtar iu nënshtrua drejtpërsëdrejti Selisë së Shenjtë (Vatikanit), ndërsa nga ana tjetër, ishte nën kontrollin e plotë të Mbretërisë së Malit të Zi. Me këtë konkordat, të nesërmen, më 8 tetor të vitit 1886, me dekretin e papës, Leonit XIII, për shkak të situatës imponuese të krijuar në terreni, shkëputët lidhja e dioqezës së Tivarit me kryedioqezën e Shkodrës. [105]

Me sugjerimin e ipeshkvit Strossmayer, e sipas vullnetit të knjaz Nikollës, më 8 tetor të vitit 1886 Selia e shenjtë emëroi për kryeipeshkëv të ri të kryedioqezës së Tivarit françeskanin Shimun Milinoviqin, nga Dalmacia (1886-1910) të cilit njëherazi iu vërtetua titulli i trashëguar nga shek. XV *"primas Serbiae".* Kryeipeshkvi Milinoviq, tashmë si *Primas tutius Serbiae* [106]s bashku më mbretin Nikolla dhe Strossmayrin, të prirë nga ideja për bashkimin e sllave të jugut, bënin projekte për asimilimin e shqiptarëve katolikë të vendit. Në vazhdën e këtij projekti, pos të tjerash, ishte dhe futja e liturgjisë kishtare në gjuhën e vjetër sllave (starosllavene), alfabeti glagolicë, në kryedioqezën i Tivarit, vitin 1895, [107]i dhe angazhimi i priftërinjve kroatë, për të vepruar ndër famullitë shqiptare. Pushteti austro-hungarezë i cili që në vitin 1837 kujdesonte shqiptarët katolik në Ballkan, ndaj kësaj çmendurie dhe shumë fenomeneve të tjera diskriminuese, të cilat vazhduan të kryhen edhe në kohën e pasardhësit të tij kryeipeshkvit, Nikolla Dobriçiq (1912-1955), shprehej si kundërshtar i përbetuar. [108]

---

[104] N. UKGJINI, *Albanci katolici u sjevernoj Albaniji i u današnjoj Crnoj Gori za vrijeme Turskog Gospodstva* (XV-XIX) , tezë doktorature në dorëshkrim, Fakullteti Katolik Teologjik, Zagreb, 2002, fq. 112.

[105] Po aty, fq.113.

[106] Po aty, fq.113-14; I. MARKOVIĆ, *Dukljansko-Barska Metropolija,* Zagreb, 1902, fq.175, 212-213.

[107] I. MARKOVIĆ, *o.c.*fq. 161; Š. RASTODER, *Konkordat između Crne Gore i Vatikana 1886. godine,* Simposiumi: Krishterimi ndër Shqiptarë, Shkodër, 2000. fq. 255-256.

[108] Š. RASTODER, o.c. fq. 257; M. ZÖLLER , o.c. , fq. 191.

Shkëputja e famullive katolike nga kryedioqeza amë

Kryedioqeza, e Tivarit, me një histori sa të lavdishme aç sa tragjike në këtë pjesë të Ballkanit, për shkak të situatës konfuze të krijuar në rrethina, në vitin 1878, humbi katër famullitë e veta bregdetare: Shushanin, Brcin, Kastel Lastva (Petrovaci i sotëm), dhe Spiçin të cilat kalojnë në kompetencën e dioqezës së Kotorit, [109] kurse me vendimet e Kongresit, përfiton famullitë nga territori i Bunës: Ulqinin, Salçin, Shëngjergjin, *Shënkollin,* diçka më vonë edhe famullinë e Podgoricës, Triepshit dhe Kojës së Kuçit. [110]Sipas relacionit të kryeipeshkvit Milinoviç të vitit 1908, kjo kryedioqezë kishte 12 famulli, me 4 qendra katolike; në Vir, Rijeka Crnojeviç, Danilovgrad dhe Nikshiq. Sipas relacionit në fjalë, gjendja statistikore në famullitë që ishin marrë nga kryedioqeza e Shkodrës ishte kjo: *Podgorica,* 65 familje me 240 besimtarë; *Koja e Kuçit,* 68 familje me 425 besimtarë; *Trijepshi* 189 familje me 1174 besimtarë. *Ulqini* së bashku më filialin *Zogaj* dhe *Pistull* kishte 125 familje dhe 493 besimtarë, *Shën Nikolli* 60 familje me 385 besimtarë; *Shën Gjergji* 30 familje me 240 besimtarë, *Salçi* 126 familje me 680 besimtarë. Gjithsej ishin 663 familje me 3.637 shpirtra.[111] (Preng Doçi) Primo Dochi, deri atëherë meshtar në dioqezën e Lezhës, e nga viti 1888 abat "abbatiae nullius"i Mirditës, i cili për një kohë qëndroi në Cetinë, në relacionin e tij nga Tivari dërguar në vitin 1883 Kongregacionit për përhapjen e fesë, në mes tjerash thotë, se përveç në Cetinë, Rijekë (mendon në Rijeka Crnojeviq), ku jetojnë 92 katolikë nga Shkodra, të tillë ka edhe në Nikshiq dhe në Danillovgrad. Në vazhdim të relacionit abat Doçi, shton se

[109] I. MARKOVIĆ, *o.c.*fq. 155.

[110] *Decretum,* De Propaganda Fide, 14. Aprilis, AN., MDCCCLXXXVII. Arkivi i kryeipeshkvisë së Tivarit, (dorëshkrim); I. MARKOVIĆ, *o.c.*fq. 155.

[111] Š. MILINOVIĆ, *Relacioni nga vizita pastorale, 24. nëntor ,1908,* Arkivi i kryeipeshkivë së Tivarit, (dorëshkrim); Podgorica si qendër e françeskanëve për Nikshiq dhe Danilovgrad, si famulli është themeluar nga kryeipeshkvija e Tivarit në vitin 1903, shif. *Opći Šematizam katoličke crkve u Jugoslaviji,* Zagreb, 1975.fq. 647.

Qeveria e Mali të Zi , nuk duron kurrfarë ndërhyrjeje të jashtme në mbretërinë e vet, qoftë laike apo fetare.[112]
Konferenca e Ambasadorëve e Londrës e cila në vitin 1913, përfundimisht vulosi në mënyrë arbitrare copëtimin e trojeve shqiptare nga trungu i Atdheut, ku pothuajse gjysma e popullsisë mbetën jashtë kufijve shtetërorë, në veri të Shqipërisë, bëri që famullitë e tjera katolike si: Traboini, me 9 fshatra dhe 1.276 shpirtra; Gruda, 15 fshatra dhe 2.242 shpirtra; Vuksan Lekaj, 5 fshatra dhe 397 shpirtra, [113]dhe Kllezna me 235 shpirtra [114] të bëhen gjithashtu pjesë e Mali të Zi, dhe më vonë pjesë e shtetit Jugosllav. Por, këto famulli, falë klerikëve atdhetarë dhe popullatës e cila në shpirtin e vet të plagosur e mbante një vetëdije të lartë kombëtare, në aspektin juridiko- kishtare edhe më tutje, deri në vitin 1923 ngelën si pjesë e kryeipeshkvisë së Shkodrës. Mali i Zi, për shkak të mospërputhjes së kufijve shtetërorë me ato kishtare, duke apeluar vazhdimisht tek Selia e Shenjtë, (Vatikani) për harmonizimin e kufijve, bëri që Selia Shenjte, pas marrjes së informatave të sakta në terren në vitin 1920 nga delegati i saj Ernesto Koci, [115]më shkresën nr. 688/ 23. dt. 8 mars 1923, me qëllim që këtyre famullive të cilat gjendeshi në territorin e Jugosllavisë, t'u sigurohej kujdesi shpirtërorë, t'i jepej si "Administraturë Apostolike", nën administrimin e përkohshëm deri tek ndonjë vendim tjetër, kryeipeshkvisë së Tivarit.[116] Në lidhje më këtë vendim të *"Kongregatës për Ungjillëzimin e Popujve"* (Kongregacio de Propaganda Fide) kryeipeshkvi i Shkodrës, imzot Lazër Mjeda,(1922-1935) në letrën e tij nr. 223/ dt. 24 mars 1923, njofton, kryeipeshkvin e Tivarit, imzot Nikolla Dobriçiq, (1912-1955) i cili që më parë ishte në pritje të këtij vendimi. [117]Selia e Shenjtë në shenjë mospajtimi me vendimet arbitrare

---

[112] P. DOCHI, *Relacioni mbi kryedioçezën e Tivarit 1883,* Arkivi Propaganda Fide, SC. Alb. vol.42, fq.991-994. (dorëshkrim)

[113] L. MIHAČEVIĆ, *Po Albaniji*, Zagreb, 1911. fq. 78-79.

[114] C. POOTEN, *Kryedioçeza e Shkodres* , 12. mars, 1877. APF. SC. Alb,vol. 41. fq. 62b.

[115] GJ. GASHI, *Vatikani dhe Arbëria,* Tiranë, 1998, fq. 205, 439-452.

[116] *Dokumenti* APF., SC. Alb. nr. prot. 688/23, 8. mars, 1923. Arkivi i kryeipeshkvisë së Tivarit. (dorëshkrim)

[117] L. MJEDA, Letër dërguar kryeipeshkvit të Tivarit, nr. 223/ 23, 24. mars 1923. Arkivi i kryeipeshkvisë së Tivarit, (dorëshkrim)

të Fuqive të Mëdha, la famullitë e lartpërmendura edhe pas shkatërrimit të kishës në Shqipëri (1967), nën administrimin e përkohshme të kryedioqezës Tivarit, deri në vitin 1976. Duhet theksuar se edhe kisha katolike e Gucisë e cila kishte 40 shtëpi me 300 besimtarë, për shkak të përcaktimit të kufijve shtetërorë, në vitin 1925, u shkëput nga famullia e Selcës dhe u vendos nën administrimin e dioqezës së Shkup-Prizrenit. [118]
Sipas, të dhënave statistikore, si rezultat i copëtimit të trojeve, rezulton se jashtë kryedioqezës së Shkodrës, duke mos llogaritur këtu, në rangun e famullive Podgoricën dhe Gucinë, të cilat në kryedioqezën e lartpërmendur nuk kanë figuruar si të tilla, kanë mbetur 10 famulli, me 8.087 besimtarë katolikë. Përndryshe, kryedioqeza e Tivarit, pa këto famulli, kishte ngelur me 3.095 besimtarë.

Ndëshkimet malazeze mbi shqiptarët katolikë

Mbretëria e Mali të Zi, duke qenë e vetëdijshme së popullata shqiptare, e cila u përvetësua në mënyrën arbitrare, nuk do të inkorporohet lehtë nën Mbretërinë e lartpërmendur, (kjo u shpreh në peticionet e Malësorëve dërguar Kancelarive Evropiane në vitet 1878 Kongresit të Berlinit; më 1913, Memorandumi dërguar Londrës; më 8. maj 1914, princ Wilhelm Wied I; më 1918, ministrive të punëve të jashtme të Uashingtonit, Londrës, Parisit, Romës; më 1919 Konferencës së Paqes në Paris etj.) për t'i disiplinuar ata, Qeveria e Mbretit Nikollë, përdori metoda diskriminuese veprimi. Në këtë kohë, Gjakova dhe Peja, duke qenë nën administrimin e Malit të Zi, kjo qeveri, për ta frikësuar shpirtin e besimtarit katolik, në vitin 1913 në Janosh afër Gjakove, mbyti më bajoneta atdhetarin, bariun shpirtëror, atë Luigj Paliqin. [119]Gazeta *"Neue Frei Presse"* më 20 mars 1913, ndër të tjera shkruan për këtë ngjarje: *"Pas sinjali që dha prifti Ortodoks, ushtarët iu hodhën Françeskanit i shqyen habitin, ia hoqën nga trupi, dhe pastaj nisën ta godisnin me kondakët e pushkëve. Atë Liugji ra përdhe më disa brinjë*

[118] A. GERZINIČ, *Janez Gnidovec,* Buenos Aires, 1972. fq. 125.
[119] B. BABIĆ, *Politika Crne Gore u novo oslobođenim krajevima, 1912-1914,* Cetinje- Titograd, 1984, fq. 216-218; L. FREUNDLICH, *Albaniens Golgota,* Wien, 1913, fq. 28-29.

dhe kocka të thyera...., Ata e pyetën priftin e plagosur rënd nëse ai tanimë do të vendoste për të ndërruar fenë e tij, prifti tundi kokën përsëri foli i qetë: Nuk e braktis fenë time, nuk e thyej besën! Atë Luigjit iu vërvit një breshëri tjetër kundakesh. Një ushtar e shtyu fort bajonetën në mushkëritë e priftit. Jeta e tij mori fund. [120]Më këtë mbytje sikur iu hapën shtigjet kishës ortodokse nacionaliste për ta vazhduar çka qeveria më parë kishte filluar. Kështu me bekimin e saj, jashtë çdo mendjeje të kodeksit të krishterë, në vitin 1913, në Gjakovë me rrethina u bë ripagëzimi i dhunshëm i 1.200 katolikëve. [121] Sipas shtypit Austriak, po në këtë vit, në rrethin e Ulqinit gjithashtu ishin ripagëzuar edhe 300 besimtarë katolikë. Sipas gojëdhënave, ripagëzime të tilla, në grupime më të vogla ka pasur edhe në vende të tjera. Në vazhdim, shtypi Austriak tregon rastin se, në Kosovë pas largimit të Turkut dhe ardhjes së pushtuesit të ri serbo-malazez, kur disa qindra "Laramanë", detyroheshin në kishën ortodokse, të pagëzoheshin, ata kërkonin që të rikthehesin në kishën katolike, por pushteti serbo-malazez, duke mos lejuar të bëhet kjo gjë u thoshin "*ose Mysliman ose Ortodoks, por jo Katolik*". [122] Synimet e qeverisë nuk u ndaluan më kaq, ajo për t'i marrë nën kontrollin e plotë në zonat kufitare, organizoi ekspedita ndëshkuese ushtarake të pareshtura të cilat vazhduan edhe gjatë vitit 1914.[123] Nga ky represion i kryer në vitin 1913 nga Gjakova më rrethina, për në Shqipërinë veriore, janë shpërngulur pa kthim 2.000 banorë. [124] Kurse në viti 1914 nga

---

[120] L. FREUNDLICH, *Albaniens Golgota,* Wien, 1913, 28-29.

[121] B. BABIĆ, *Politika Crne Gore u novo oslobođenim krajevima, 1912-1914,* o.c. fq. 208.

[122] N. DOM, UKGJINI, *Veshtrim i shkurtër historik mbi zhvillimin e katolicizmit në Ulqin gjatë shekujve,* Simposiumi: Ulqini në rrjedhat e kohës, 26-27 maj, Ulqin, 2000. fq. 82 (mbi pagëzimin në rrethinën e Ulqinit); L. FREUNDLICH, *Albaniens Golgota,* vep. e cit., fq. 27. Sipas, këtij burimi Austrijak, Mbretëria e Malit të Zi –Kisha Ortodokse, duke mos lejuar „Laramanët" të këthehën në fen e vjetër, haptazi tregon se hala është kundra kishës katolike dhe se aleanca e bërë ndërmjet Kishës Ortodokse dhe Mbretërisë Osmane e nënshktuar në vitin 1453 në Konstantinopojë (Istambol) edhe pse në anën juridike nuk ekzistonte më, ajo në terrën hala ishte në përdorim.

[123] B. BABIĆ, *Politika Crne Gore u novo oslobođenim krajevima, 1912-1914. o.c.*,fq. 59, 188, 189.

[124] Po aty, fq. 186.

Hoti e Gruda u shpërngulën për në Shkodër, gjithashtu pa kthim 500 familje katolike. [125]

Në vazhdën e diskriminimit ishte, në vitin 1913, edhe mbyllja e të gjitha shkollave katolike në të cilat mësohej gjuha shqipe, brenda kësaj Mbretërie. Për këtë dukuri, ndër të tjera Branko Babiq thotë *"Shkollat kanë qenë një ndër fushat e arritjeve politike, ndikimit politik dhe madje edhe të ripërtëritjes nacionale shqiptare të katolikëve në pjesët të reja të Malit të Zi.*[126] Edhe pse kjo gjë, ishte përcaktuar qartë në vendimet e Konferencës së Londrës të 22 marsit 1913 mbi Konceptin e mbrojtjes dhe të drejtave të katolikëve në Mal të Zi.[127] Më nën fund, pushteti nuk kishte harruar që t'i mbante nën mbikëqyrjen e vet rigoroze të gjithë klerikët katolikë, qoftë ata shqiptarë apo italianë, duke i konsideruar ata si agjentë të huaj të cilët dëshironin ta destabilizonin vendin. [128]

Shënime:

Famullija ose kisha, *është njësia e vogël kishtare e një dioçeze, e cila ka nën kujdesin e vet shpirtërore dhe administrative një fshat ose një grupë fshatrash.*

Dioçeza, *krahin kishtare e cila përbëhët nga disa famulli të cilat funkcionojnë nën jurisdikcionin e saj.*

Kryedioçeza, *krahin kishtare e cila nën vehte ka disa dioçeze (dioçeze sufragane).*

---

[125] Po aty, fq. 69.

[126] N. DOM, UKGJINI, *Veshtrim i shkurtër historik mbi zhvillimin e katolicizmit në Ulqin gjatë shekujve,* o.c. , fq. 81-82; B. BABIĆ, *Politika Crne Gore u novo oslobođenim krajevima, 1912-1914. o.c.*, 206-208.

[127] N. DOM, UKGJINI, *Veshtrim i shkurtër historik mbi zhvillimin e katolicizmit në Ulqin gjatë shekujve,* o.c. , fq. 81-82; B. BABIĆ, *Politika Crne Gore u novo oslobođenim krajevima, 1912-1914. o.c.*, 206-208.

[128] Š. RASTODER, - J. RASTODER, *Dr Nikola Dobrečić*, Budva 1991, fq. 72.

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT NË SHTYPIN SLLOVEN

dr. Martin BERISHAJ

Shekulli i nëntëmbëdhjetë karakterizohet me procesin e emancipimit të popujve ballkanik, posaçërisht për shkak të ndikimit të atyre forcave që garonin për dominim në Ballkan. Ky proces, për shkak të luftërave të tilla nuk ishte vetëm i vështirë por, ishte shpesh i nënshtruar po asaj luftë qoftë me përmbajtje apo me metoda.

Ndërhyrja e fuqive të mëdha në shumë fusha në vendet ballkanike kontribuoi në zgjerimin e shoqërisë qytetare në ato vende. Karakteri, dinamika dhe përmbajtja e zhvillimit, zbaticat dhe baticat e lëvizjeve kombëtare të vendeve ballkanike si dhe luftërat e tyre për pavarësi ishin më shumë të përcaktuara me ndikimet e jashtme sesa me ligjshmëritë e gjendjes së brendshme dhe strukturën e atyre vendeve ballkanike.

Krahas Rusisë dhe Austrisë gjegjësisht Austro-Hungarisë në këtë lojë ndihet interesi i Anglisë dhe i Francës, dy faktorëve kyç për Ballkan, e të cilave në funde të viteve 60 u bashkua edhe Italia me penetrimin e sajë në Ballkan,

Kriza lindore (185-1878) shkaktoi edhe egërsim shtesë në të gjitha komponentët e çështjes lindore e kështu edhe çështjes shqiptare. Ne arenën ndërkombëtare çështje shqiptare u paraqit në suaza të aranzhimit të marrëveshjes së Reichtadit të cilën e lidhen fuqitë e mëdha me 8.7. 1876 , si refleks për garanci ndërkombëtare perandorisë otomane dhe për shkak të traktateve në mes Rusisë dhe Austro- Hungarisë. Austro-Hungaria përpiqej ta zvetënonte interesin e tretë për ndarje të zonave të ndikimit dhe zhvatjes së territoreve në vendet ballkanike. Të gjitha çështjet në Ballkan donte ti zgjidhte me marrëveshje dypalëshe. "....qëllimi i traktatit të fshehtë që e nënshkruan me 18.I. 1877 ishte mundësia të parandalohet formimi i nj[shteti të fort sllav në Ballkan. Po që se do të shpartallohej perandoria

osmane, atëherë do të lejonte konstituimin e shteteve të pavarura siç janë: Bullgaria, Shqipëria dhe mbetjet e Rumelisë"[129].

Shtrirja horizontale e debatit rreth ndikimit apo "depërtimit te bute" Austriak ne truallin shqiptare hapi shtigje për lojëra diplomatike ne prag dhe gjatë Krizës lindore, e në veçanti ajo i shpalojë tendencat konkurruese ne boshtin në mes Austro- Hungarisë dhe Italisë, për ta zaptuar ata qe pa zaptua kishte mbet, duke e bërë me dije se prezenca e kapitalit industrial mundë të kthente kahun shqiptarë nga perëndimi. Krahas kësaj tendence, "fuqitë ballkanike" të vetëshpallura (Greqia, Serbia dhe natyrisht Mali i Zi) qe kishin ngre kokën për të zgjerua territorin shtetërorë në dëm të Shqipërisë, kishin hy thellë në indin territorial shqiptarë. Teoria e zaptimit qe kishte për bazë moton: " ose pranoni autonominë (por jo edhe shtetin!) ose do tu "shpërfytyrojmë anatominë" ishte fillimrruga që i dedikohej një krijese (Shqipëria) që ende nuk ishte shtet, por te cilën ne vitet e mëvonshme do të dizajnohej.

Forcat konservatore politike, kishin për qëllim parandalimin e tendencave centrifugale të zhgoglitjes së shtetit dhe rënien e monarkisë si superfuqi, lëvizje kjo që kishte në ball arkidukën Franz Ferdinand-in, trashëgimtar të fronit, i cili mblodhi rreth vetes një grup këshilltarësh, të quajtur sipas rezidencës së tij "Rrethi i Belvederes", të cilët u bashkuan nën flamurin e lëvizjes për *Austrinë e Madhe* në dekadën para luftës së parë botërore.

Në Belvedere, ishte qendra e qeverisë në hije, ku ishte zyra ushtarake e arkidukes. Aty gravitonte një numër i mirë i politikanëve me ndikim dhe oficerëve të lartë të ushtrisë. Thelbi i Rrethit të Belvederes përbehej nga tre grupime politike. Rrethi më i ngushtë – njerëzit më të besueshëm të Franz Ferdinandit vinin, padyshim, nga radhët e aristokracisë çeke. Midis tyre dalloheshin, në mënyrë të veçantë, princi Karl Schwarzenberg, dhe konti Ottokar Czernin-Chudenitz.

Grup tjetër me ndikim i përbërë nga oficerë të lartë të ushtrisë, në mesin e tyre figuronte këshilltari kryesor i Franz Ferdinandit dhe kryeshefi i shtatmadhorisë, baroni Franz Conrad von Hötzendorf.

[129] Slovenski narod, Xi leto, 17.9.1878..

Grupi i tretë i rëndësishëm i këshilltarëve të arkidukës vinte nga pjesa hungareze e monarkisë. Para së gjithash ishin, politikanë kroatë dhe rumunë, të cilët kërkonin mbështetje nga trashëgimtari, kundër dominimit politik hungarez.

Rreth Franz Ferdinandit tashmë ekziston një seri e biografish[130] të shkruara, ndër të cilat, si studim standard dhe më me vlerë pa dyshim veçohet, për konceptet e tij politike, libri i Georg Franz-it 1943[131], ndonëse në të nuk janë përpunuar të gjitha dokumentet nga trashëgimia e arkidukes. Këto seri debatesh më në detaje i ka studiuar Robert A. Kann-i,[132] i cili, në studimet e veta, e përshkruan trashëgimtarin e fronit Franz Ferdinandin si ultrakonservativ dhe legjitimist autokratik[133].

Shtypi slloven i kohës për Lidhjen e Prizrenit

Ne gjuhën sllovene shtypi i kohës numëronte këto gazeta (ketu do te përqendrohem ne "Slovenski narod", "Slovenec", "Sava" "Štajerc«, »Straža« si dhe ne shtypin slloven qe dilte ne Amerikë »Amerikanski Slovenec« e poashtu shtypi i kohës ne Trieste »Edinost« dhe Gorizia (Gorica).

Në arkitekturën e ngjarjeve të cilat i kanë strukturuar fuqitë e mëdha me qellim të sundojnë me atë pjesë të Ballkanit, çështja shqiptare u paraqit si një gurë i cili nuk plotësonte mozaikun e paraparë. Fuqitë e mëdha përpiqen që të shfrytëzojnë dobësitë e perandorisë otomane dhe të "zënë frymën"

---

[130] Paul Nikitsch-Boulles, Vordem Sturm. Erinnerungen an den Erzherzog-Thronfolger (Berlin 1925); Leopold Chlumecky, Erzherzog Franz Ferdinands Wirken und Wollen (Berlin !929); Theodor Sosnosky, Der Erzherzog-Thronfolger. Ein Lebensbild (München-Berlin 1929); Victor Eisenmenger, Erzherzog Franz Ferdinand (Zürich-Leipzig-Wien 1930); Maurice Muret, L'archiduc François Ferdinand (Paris 1932); Rudolf Kiszling, Erzherzog Franz Ferdinand vofi Österreich-Este. Leben, Pläne und Wirken am Schicksahweg der Donaumonarchie (Graz- Köln 1953); Emil Franzel, Franz Ferdinand d'Este. Leitbild einer konservativen Revolution, Wien 1964); Gerd Holler, Franz Ferdinand von Österreich-Este (Wien-Heidelberg 1982); Friedrich Weissensteiner, Franz Ferdinand. Der verhinderte Herrscher (Wien 1983); Max Pollatschek Franz Ferdinand. Europas veriorene Hoffnung (Wien-München 1989).

[131] Georg Franz, Erzherzog Franz Ferdinand und die Pläne zur Reform der Habsburger Monarchie (Bninn-M\inchen-Wien 1943).

[132] Robert A, Kann, Erzherzog Franz Ferdinand Studien (Veröffentlichungen des Österreichischen Ost- und Südosteuropa-Instituts 10, Wien 1976);

[133] Kann, Erzherzog, 34

zgjimit të ndërgjegjejes politike shqiptare e cila tashmë kishte marrë hov me tendencë të bashkimit të gjithë shqiptarëve për luftë çlirimtare kundre okupimit . Ky zgjim i shqiptarëve duhet ti dedikohet përpos tjerash edhe shkallës se shpartallimit të perandorisë otomane. Shqiptarët në këtë rrugëtim shikohen si aleat të turqve në synim për copëtim të vete Turqisë.

Të pafuqishëm, që deri në perfeksionim të parashihnin lojërat e diplomacisë së fuqive të mëdha, shqiptarët përpiqen që interesat e tyre ti mbronte një nga fuqitë e mëdha. Kjo pasiguri e shqiptareve krahas proceseve ne fjalë, ishte tërësisht e qartë mbase kishin mungesë të elitës qytetare e cila do të duhej të ishte bartës i ndërgjegjes politike dhe nacionale kombëtare. Në anën tjetër, kundërthëniet fetare të cilat paraqiteshin brenda shqiptareve, në dukje shpalonin antagonizmin nacional, që shkaktonin fraksione në politiken e udhëheqjes[134].

Ne pah dalin dallimet brenda shqiptareve të besimit katolik gjegjësisht rrjedhave që i ndanin ata. Nga njëra anë ndikimi i diplomacisë italiane nëpërmjet farnçeskaneve shqiptare dhe ai austrojezuit i cili ne suaza të tij mblidhte inteligjencën shqiptare të kohës.

Anticipimi i emancipimit politik, që paraqitet në fillim të "zgjimit nacional te shqiptarët shkaktoi kundërthënie nacionale. Pa marrë para sysh se sa "pa mëkat" ishin këto rryma brenda kishës katolike, e që nuk prezantonin dy rrugëtime për shëlbim, por, njëkohësisht paraqitnin orientim politik të mbështetur në shtet të posaçëm; në Austro-Hungari dhe Itali[135]. Këto dy shtete nuk mbronin interesat shqiptare por nën rrogoz artikulonin interesat e veta për tu përqendruar në detin Adriatik dhe si mundësi e zgjerimit të territoreve të tyre. Politiken e vet dhe diplomacinë e proklamonin nëpërmes shtypit të kohës, por jo vetëm nga qendrat e pushtetut të tyre, Vjenë dhe Romë, por edhe nga territoret e përfituara ku i artikulonin intereset e tyre.

Kur bëhet fjalë për shtypin slloven, nuk qëndron teza se ishte i tëri nën ndikim Austro-Hungarez. Në pjesën e inteligjencës së ndritur sllovene, dhe interesit qe ata mbulonin, ata shkruanin të pandikuar nga Austro-Hungaria.

[134] Slovenec, ...
[135] Slovenec, ibidem

Kështu gazeta Slovenec (Sllovenec) e përshkruan gjendjen në trojet shqiptare:

"Shqipëria vlon. Shqiptaret sulmojnë tokat serbe, i kundërvihen Malit të Zi, kërcënojnë Greqinë dhe gjithë Evropën, para syve të Turqisë, e cila, ose nuk dëshiron ose nuk mundet të kontrollojë shqiptaret e egër. Ne nuk jemi për atë që shqiptaret të nënshtrohen, dhe assesi në kohë kur edhe popjt tjerë ballkanik janë të pavarur apo shkojnë asaj rruge, që shqiptaret ti ndajmë sikurse dhënë në mes shteteve tjera; ne besojmë se shqiptareve u duket shumë rëndë kur një pjese e trollit të tyre u hiqet dhe i jepet Serbise, pjese tjetër Malit të Zi, një pjesë tjetër Greqisë kurse tjetra Turqisë! Se u bë kështu, fajtorë janë vet diplomatet që nuk bënë asgjë për shqiptarët, fajtor janë edhe vet shqiptarët qe nuk deshten të bashkohen me serb dhe bullgar kundër Turqisë, por iu nënshtruen edhe me tepër asaj. Po që se është Turqia vertetë aq e dobët sa që nuk mundë ti kontrolloje ata, atëherë, le të hiq dorë nga shqiptaret në mënyrë që ti mundësohet njërës nga fuqitë evropiane dhe të bëjnë Shqipërinë si principatë të re. Tuqeët, me qellim e lëjeojnë këtë situatë duke i shty në konflikt malazeztë dhe shqiptaret për territor qe ata tashmë ia kanë premtuar Malit të Zi. ... me shqiptaret duhet te bëjnë diçka, se ata nuk u takojnë turqëve dhe perandorisë otomane, ata nuk janë as serb e as bullgar, por janë në troje të tyre qysh se mbahet mend, pra para sllaveve e ndoshta edhe para grekëve. [136] Në analizën e çështjes shqiptare korrespodenti në mnyrë simbolike i drejtohet sllaveve duke përdorur subjekt tjetër , pra atë shqiptar, duke e egërsuar kështu ideologjikisht me këtë edhe me tepër pozitën sllave brenda Austro-Hungarisë.

Hipertrofia e diplomacisë austrohungareze dhe tendenca e sajë për çështje te adratikut ishin më se evidente e me këtë interesi për shqiptar dukshëm më i madh. Si moto i diplomaciasë austrohungareze ishte thënia jezuite e gjeneralit Aquavive:" *fortier in re suaviter in modo*" (*fuqishëm në ekzekutim dhe të butë në realizim*). Kështu tregonte frikën latente para lojërave tjera diplomatike para se gjithash para Rusisë (më dorën e sajë të zgjatur Bullgarine e Madhe) e cila detin Adriatik dëshironte të shndërronte në Liqenin e vet.

---

[136] Slovenec, nr. 47., 29.4. 19880

Primicia e emancipimit politik shqiptarë në konstelacionin e fuqive në Ballkan nënkuptonte hapa pionere qe reflektonin brenda elitës politike shqiptare, kurse në arenën ndërkombëtare reflektimi i asaj diplomaci shqiptare përjetohej "si jo e pjekur" në vendosjen e kërkesave për autonomi të plotë të shtetit shqiptarë. Ndjeshmëria e shqiptarëve në artikulim të programit nacional të përbashkët, fuqitë e mëdha dijten ta shfrytëzojnë, për tu rrëfyer popujve tjerë se ata e përdorin shtypin për interesa të tyre si monopol për informim.

Shtypi Slovenski narod dhe Slovenec, shpalonin situatën ndërkombëtare gjatë Krizes së Lindjes dhe traktatit të Shenstefanit. Posaçërisht ishin tejet të përqendruar në këtë situatë nga Traktati i Shenstefanit e deri te Kongresi i Berlinit. Për të treguar se sa janë të hapur ndaj çështjes shqiptare citohet "...një prift katolik shqiptarë Myeddei (Mjeda vërejta MB) i cili shpjegon ne një predikim në rrethin e Belvederës ne Vjenë se për shqiptarë para lagja e Shën Stefanit quhet Shën Shtjefni se kështu do te kuptohet nga shqiptaret me lehtë"[137]

Veçanërisht gazeta Slovenski narod ishte tej mase e interesuar për përkufizim shqiptaro malazias ku ne mes tjerash shkruan:"... kufiri e merr në njërën anë Drekalloviqet, Kuçin fiset e Grudes dhe Kelmendin, fushën e Podgoricës dhe Pllavnicën, Hotin dhe Grudën ua lëshon shqiptareve". [138] ky kufi ishte mjaft problematik posaçërisht sa i përket Hotit dhe Grudës.

Ne lidhje me dorëzimin e Podgoricës dhe Shpuzës (Spuzhit) me 19.I.1879 shton se princit malazias do ti dorëzohet shumë shpejtë Podgorica e Shpuza. Veziri i madh Hajredin dhe deputeti rus Lobanov premtojnë se turqit nuk do ti shkatërrojnë ato dy qyteza. Vetem shqiptaret duen të ruejn ato qyteza, për këtë çështje princi malazias me 16.I 1879 ka tubuar 1200 ushtar për ti zaptuar ato[139]

Vend te posaçëm shtypi slloven i jep vrasjes së Mehmet Ali Pashës" : " ... vrasja e tij ishte e kurdisur për ti ndihmuar Lidhjes se Prizrenit por Porta

[137] Slovenec ibide,
[138] Slovenski narod , XI leto, 23.7. 1878
[139] libidem 27, 4.2.1880

nuk mund të marrë masa kundër kryengritësve. Aty shihet dyfytyrësia e sajë dhe dobësia e saj[140].

Për aktivitetin diplomatik shënohet serisht mbiemri Mjeda..." ne bisede me të deleguarin francez St Vallier lidhur me Mirditën"[141].

Një periudhë kohe nuk kemi qe ne gazetën Slovenec nuk kishte shkrim për Lidhjen e Prizrenit. Kështu qe me dt 3.8. 1879 korrespodenti nga Cetinja shkruan se"... malazezet janë tërbuar, sepse shqiptareve nu u shkon ndërmend ta lëshojnë Plaen dhe Gusinë. Portës i ankohen se shqiptaret po u sjellin telashe, por nuk dihet se ai shkon per shtat kjo gje Portes?[142] Ministri i Puneve et Jashtme Hymerle i raporton Turqisë se nuk lejohet qe ajo te premtoj dhe mos te realizoj asgjë. Se kështu mundë të shpërthej lufta shqiptaro malaziase.[143] Kështu në fakt siç pohon gazeta ne fjalë mund të shpërthej lufta sllavo turke qe Bullgari mezi e pret.

Shtetet per rreth kanë fillua te frigohen se shpërthimi i luftës n ëmës Malit te Zi dhe shqiptareve shpien në lufte balkanike. Kështu, dergata angleze në Stamboll ka dërguar St John qe te bindet në këtë gjendje[144]. Duke shtuar se nëse kjo gjendje përmirësohen edhe Gjermania do të dërgojnë emisarin e vetë për të ndërmjetësuar në dorëzim në me Portes dhe Malit te Zi.[145].

Organizimi i ushtrisë së Lidhjes së Prizrenit evidentohet edhe ne shtypin tjter përpos këtij sllloven. Mbi te gjitha përcjellja e gjendjes ne territoret etnike shqiptare trajtohet me nje vëmendje të posaçme, kështu Slovenec ne majt të viti 1880 në numrin 56 shkruan si vijon :" Flitet se ushtria e Lidhjes do të kundërshtoj dhe refuzojë vendimet e Kongresit të Berlinit duke u organizuar mbi 80000 ushtar te vet. Korrespodenti petët se me çka e ushqejnë ate ushtri... kush u ndihmon atyre... se me kete ushtri mund ti mbrojnë tokat e veta para grekeve, turqeve dhe sllaveve. Shqiptaret kane te drejte të mbrojnë trollin e vet dhe te formojnë shtetin e vet te pavarur..."[146]

---

[140] Slovenski narod, XI leto, 17.9.1878

[141] Ibidem 18.06.1878

[142] Slovenec, 3, 8.1. 1879

[143] Ibdiem, nr 47, 10.1.1880

[144] Ibidem

[145] Ibidem, nr. 47, 29.4. 1880

[146] Ibidem, nr. 56, 25.05. 1880

Ne fund dua te shtoj se shtypi slloven i kohës për deri sa nuk kishte korrespodentët e vet ne territoret etnike shqiptare ndihej ndikimi i politikes ditore, mirëpo, pastaj i shmangen asaj dhe situatën ne terren e trajtojnë mjaft realisht, (posaçërisht kur autoret ishin slloven).

Literatura:

1. Andrej Mitrovič, (Beograd 1981); Prodor na Balkan. Srbija u planovima Austrougarske i Nemačke 1908-1918
2. Andrej Rahten, Federalistični koncepti v politiki Habsburške monarhije na Balkanu 1908-1918
3. Andrej, Rahten, (Minnepolis 2009); Archduke Francis Ferdinand and the South Slav question
4. Eve Demmerle, (Ljubljana 2013) Habzburžani
5. Ferdo Šišić, (Zagreb 1920); Jadransko pitanje na konferenciji mira u Parizu. Zbirka akata i dokumenata
6. Martin Berishaj, (Ljubljana 1989) ; Mednarodni pomen Prizrenske Lige, založba krt, knjiga 61
7. Fran Zwitter, Die nationalen Fragen in der Österreichisch-Ungarischen Monarchie (1900-1914)
8. Paul Nikitsch-Boulles, Vordem Sturm. Erinnerungen an den Erzherzog-Thronfolger (Berlin 1925);
9. Leopold Chlumecky, (Berlin 1929) Erzherzog Franz Ferdinands Wirken und Wollen
10. Rudolf Kiszling, Erzherzog Franz Ferdinand vofi Österreich-Este. Leben, Plane und Wirken am Schicksahweg der Donaumonarchie (Graz- Köln 1953)

Shtypi slloven i kohes:

1. Slovenski narod
2. Slovenec
3. Edinost

4. Sava
5. Štajerc
6. Straža
7. Gorizia
8. Amerikanski Slovenec

COPËZA LETËRKËMBIMI TË DE GAULLE ME MBRETIN ZOG DERI NË VITIN 1961

Thomas Frashëri[147]

Gjenerali Charles de Gaulle Ish-presidenti francez, vlerësim rezistencës mbretërore. Oficerë të lartë, njerëz të afërt të Ahmet Zogut, pjesë e ushtrisë franceze, ku dhe janë nderuar. Qëndrimi i Francës ndaj vendosjes së pushtetit komunist në Shqipëri. Zogu-grekëve: Më mirë mbështes Enver Hoxhën se t'ju jap Epirin. Pas mynxyrave të qershorit, në territorin anglez kishin mbërritur sovranët dhe ministrat e Norvegjisë, Holandës, Luksemburgut, presidenti dhe ministrat e qeverisë polake dhe më vonë kabineti qeveritar belg. Çekosllovakët nisën të organizoheshin, ndërkohë që Mbreti i Shqipërisë ndërmerrte disa kontakte". Në "Kujtimet e luftës" së gjeneralit De Gaulle është i vetmi aluzion që i bëhet qeverisë shqiptare mbretërore në mërgim. Lakonik, pothuajse i parëndësishëm, ky shënim kumton gjithsesi opinionin që kreu i Francës së lirë kishte mbi situatën e Mbretërisë shqiptare gjatë viteve të para të Luftës së dytë Botërore: ai njihte legjitimitetin e Mbretit të shqiptarëve dhe, duke e radhitur përkrah sovranëve të tjerë të mërguar të vendeve aleate (Holandë, Luksemburg, Poloni, Çekosllovaki), e konsideronte Shqipërinë si një vend aleat rezistent. Ai nuk e ndryshoi as më pas këtë opinion dhe do të shprehet vazhdimisht me keqardhje për faktin që ky vend aleat ra nën zgjedhën e sundimit sllav dhe komunist. Bindja që gjenerali De Gaulle kishte mbi këtë pikë nuk ishte e parëndësishme në vitet 1940. Duke njohur rezistencën shqiptare, Franca e lirë përmbyste pozicionin franko-anglez të prillit 1939, që konsistonte në mosdenoncimin e hapur të agresionit italian mbi Shqipërinë të datave 7-12 prill të të njëjtit vit. Nëse Republika III franceze kishte heshtur mbi këtë agresion, kjo i detyrohej faktit që Franca nuk donte të ripërsëritej

[147] I ngarkuar me punë pranë Mbrojtësit të të Drejtave të Republikës franceze, anëtar i fondacionit "Charles de Gaulle". Laureat i Akademisë së Shkencave morale dhe politike të Francës dhe i Fakultetit të Drejtësisë së Parisit

kundërvënia e saj e hapur në Lidhjen e Kombeve ndaj pushtimit italian të Abisinisë, tre vjet më parë. Ky reagim e kishte shtyrë Duçen të nënshkruante "Paktin e hekurt" me Hitlerin, ndërkohë që vetë Musolini vazhdonte të shprehte një vullnet afrimi me "Plutokracitë" perëndimore, siç i cilësonte ai demokracitë e pasura kapitaliste, Anglinë dhe Francën në veçanti. Më 1939-n, ndërkohë që qeveria fashiste projektonte aneksimin e Shqipërisë, e cila ndodhej tashmë prej kohësh nën influencën italiane, për të kundërpeshuar aneksimin e Çekosllovakisë nga Rajhu gjerman, dhe bënte përpjekje për të mos bashkëndarë fatin e Gjermanisë dhe Japonisë, Franca nuk mund të bënte gjë tjetër, veçse të shpresonte një zbutje të konfliktit në dukje të menjëhershëm dhe të paevitueshëm me Romën. Mosangazhimi i Italisë duhej ruajtur me çdo kusht, edhe pse Parisi e Londra ishin në dijeni të faktit që Roma nuk ishte në gjendje të angazhonte njësi të plota ushtarake përpara 1942-shit. Kështu duhej hequr dorë nga çdo përplasje frontale me Boshtin, mbi çështjet ballkanike dhe në mënyrë të veçantë në lidhje me Shqipërinë, për të evituar ndërhyrjen e Gjermanisë, gjë e cila mund të zgjonte simpatitë e fjetura të qeverisë greke, jugosllave, bullgare ose asaj rumune për Rajhun III. Kjo është arsyeja për të cilën Republika III franceze, jo vetëm që kishte pranuar në mënyrë të heshtur uzurpimin e kurorës mbretërore shqiptare prej Mbretit Viktor Emanuel III, por kishte vepruar në mënyrë të tillë që denoncimi i agresionit italian mbi Shqipërinë, i transmetuar zyrtarisht kryetarit të Lidhjes së Kombeve, Jozef Avenol, nga vetë Mbreti Zog I, i ndodhur në Greqi, më 9 prill 1939, të mos kishte asnjë jehonë në arenën ndërkombëtare. Si për cinizëm të historisë, Franca do të ndodhet në një situatë të ngjashme me atë të Shqipërisë në maj-qershor të vitit 1940, pasi, e agresuar nga Italia e Musolinit, do ta shohë veten të shkelur prej "çizmes" së Duçes.

Ahmet Zogu Në mënyrë të logjikshme dhe si pasojë e denoncimit të politikës së jashtme të papërgjegjshme të viteve 1930 të Republikës III, gjenerali De Gaulle do të konsiderojë të pavlefshme dhe të paqenë rrëzimin e mbretit Zog I i shqiptarëve nga italianët, gjë për të cilën dëshmon korrespondenca midis dy liderësh shteti, nëpërmjet së cilës udhëheqësi i Francës së lirë i drejtohet një sovrani legjitim, jo thjesht përfaqësuesit të një grupimi të caktuar në mbrojtje të interesave shqiptare.

Ishte pikërisht pushtimi italian ai që e detyroi familjen mbretërore të braktisë Shqipërinë. Mbreti Zog I nuk mundi të organizojë një rezistencë të brendshme, për arsye të ndryshme për të cilat historianët debatojnë ende. Por ai shpresoi në organizimin e një rezistence jashtë Shqipërisë me trupa dhe materiale më të shumta në krahasim me ato ç'ka dispononte aktualisht Shqipëria dhe që ndodheshin prej kohësh në duart e italianëve. Për të, një rikthim në vend ishte i mundshëm, nëpërmjet bashkimit të forcave që i kishin qëndruar besnike, ashtu si kishte ndodhur në vitin 1924, kur, i larguar nga pushteti dhe i mërguar për shkak të një revolucioni, ai kishte triumfuar mbi kundërshtarët. Megjithatë, konteksti ndërkombëtar në vitet 1939-1940 nuk ishte më i njëjti si në vitin 1924. Si përfaqësues i unitetit të të gjithë kombit shqiptar, autokton në disa territore jugosllave dhe greke, prezenca e Mbretit Zog nuk ishte më e mirëpritur as në Beograd, as në Athinë. I detyruar të largohej nga trojet shqiptare nëpërmjet një udhëtimi të gjatë në det, ai kaloi nëpër Turqi, në vendet baltike, në Francë ku, mes të tjerash, ai njohu dhe disfatën e Republikës III. Mbreti Zog dhe suita e tij u instaluan në Angli më 26 qershor të vitit 1940, si fillim në hotelin "Ritz", pastaj në vila "Forest Ridge" të Sunningale Ascot dhe më së fundi në vilën e Parmoor House, në Oxfordshire. Nuk është e pamundur që Mbreti Zog dhe një pjesë mirë e të rinjve shqiptarë, të ndodhur brenda dhe jashtë territorit shqiptar, të kenë dëgjuar apelin e 18 qershorit ose atë të 22 qershorit 1940 të gjeneralit De Gaulle nëpërmjet valëve të BBC, ashtu siç është pranuar nga disa dëshmi. Edhe pse anglezët i kishin ndaluar kategorikisht çdo lloj akti rezistence, Mbreti Zog tentoi dy herë ndërmjet nëntorit të vitit 1940 dhe prillit të vitit 1941 të organizojë trupa luftimi, të cilët do të depërtonin në territorin shqiptar nëpërmjet Jugosllavisë ose Greqisë për të destabilizuar italianët dhe për të nxitur popullin shqiptar në kryengritje. Po në këtë periudhë, Mbreti Zog u përpoq të hidhte bazat e një aksioni të përbashkët antifashist greko-shqiptaro-jugosllav, por pa sukses. Këto projekte nuk u miratuan nga anglezët, të cilëve regjenca jugosllave, në afrimitet me Rajhun, i kishte bërë të ditur oponencën e saj formale. Qeveria greke nuk dëshironte në asnjë mënyrë përforcimin e një rezistence shqiptare nacionaliste, konkurrente me të sajën, e cila mund të bëhej pengesë në të ardhmen për aneksimin e jugut të Shqipërisë nga Greqia. Vlen të nënvizohet që anglezët besonin më shumë në

të ardhmen e rezistencës komuniste të organizuar dhe të konsoliduar fuqishëm, falë ideologjisë së emisarëve të Partisë komuniste jugosllave. Në këto rrethana mjaft të vështira, Mbreti Zog, i cili përpiqej të kishte sa me tepër kredibilitet përpara fuqive aleate, e shihte të arsyeshme të mos braktiste mundësinë për të peshuar sadopak në zgjidhjen e ardhshme të konfliktit botëror. Për këtë arsye, ai vendosi të ndihmojë rezistencën mbretërore të krijuar brenda Shqipërisë rreth një oficeri të ish-ushtrisë së rregullt shqiptare, majorit Abas Kupi. Po për këtë arsye, Mbreti filloi të inkurajonte dhe të autorizonte oficerët e rrethit të tij, por gjithashtu dhe të gjithë shqiptarët që e mbështetnin jashtë Shqipërisë, të angazhohen në kuadrin e forcave të armatosura të fuqive aleate për të qenë prezent në teatrot e ndryshëm të operacioneve luftarake. Edhe pse ky angazhim nuk mund të ishte, numerikisht, veçse simbolik, ai duhej të kontribuonte në pjesëmarrjen e Shqipërisë në fitoren përfundimtare. I frymëzuar nga shembulli i rezistencës goliste jashtë Francës, Mbreti i shqiptarëve dëshironte një pjesëmarrje ushtarake, simbolike, por konkrete. Këtë dëshmojnë memorandumet e ndryshme që monarku i dërgoi Ruzveltit, por edhe fuqive të mëdha të mbledhura në Konferencën e Londrës, më 23 shtator 1941. Gjenerali De Gaulle iu përgjigj kërkesës së Mbretit nëpërmjet një letre të 3 dhjetorit 1941, në të cilën mes të tjerash lexojmë: "Madhëria Juaj mund të jetë i sigurt se Franca e shumëvuajtur nga lufta dhe pushtimi i huaj merr pjesë në hidhërimin dhe vuajtjet e popullit shqiptar dhe i qëndron besnike miqësisë tradicionale midis dy vendeve". Gjenerali De Gaulle kishte dijeni për organizimin e një rezistence në Shqipëri. Ai i ndiqte nga afër dhe me mjaft interes luftën dhe rezistencën greke e jugosllave, duke shprehur një parapëlqim të theksuar dhe pa komplekse për nacionalistët në dëm të partizanëve komunistë të Titos. Ai kishte synuar që prej vitit 1940 dërgimin e një kontingjenti francez në Shqipëri, me qëllim pjesëmarrjen në çlirimin e këtij vendi dhe të Greqisë, por Foreign Office i ishte kundërvënë duke u bazuar mbi pretekste të rreme. Në fakt, qeveria angleze nuk e shihte me sy të mirë vendosjen e një kontingjenti francez në Greqi, i cili mund të vinte në rrezik të nesërmen e fitores përfundimtare, influencën angleze në rajon. Në Shqipëri, rezistenca komuniste, e cila kishte bërë disi të vetën moton e gjeneralit De Gaulle, "Një luftë të vetme, nën një udhëheqës të vetëm", ishte

e organizuar dhe e përgatitur mjaft mirë falë misioneve angleze. Megjithatë, edhe pse Enver Hoxha, shef i rezistencës komuniste, dëgjonte në radio emisionet e Londrës, asnjë kontakt nuk duket të jetë ndërmarrë me Francën e lirë, deri në krijimin e qeverisë provizore të Republikës franceze në Algjer dhe hyrjen e komunistëve në kabinetin qeveritar. Gjenerali De Gaulle pati rastin të njihte dhe të vlerësonte elementë të rezistencës mbretërore shqiptare të ndodhur jashtë vendit. Këtyre të fundit iu desh të luftonin nën flamurin e Francës luftëtare, për atdheun dhe sovranin e tyre, por edhe për Francën dhe për lirinë kudo në botë. Ky angazhim nuk do të ishte pa pasoja në konceptimin e politikës ballkanike të Francës gjatë momenteve të para të pas-Luftës së Dytë Botërore. Angazhimi i shqiptarëve dhe i diasporës nën flamurin francez. Të parët që shfaqën hapur angazhimin e tyre, ishin anëtarët e një grupimi shqiptar të Stambollit, besnikë të Mbretit, të inkuadruar nga oficerët e Ushtrisë shqiptare, veçanërisht nga oficerët e Gardës mbretërore që ndodheshin në kryeqytetin e vjetër të Perandorisë Osmane, një ndër të rrallët ku konsullata shqiptare ishte ende e hapur. Republika e Turqisë nuk e kishte njohur, në fakt, aneksimin italian të Shqipërisë dhe vazhdonte të kishte marrëdhënie diplomatike me Mbretin Zog. Të mobilizuar nga agjentët angleze të SOE (Special Operations Excecutive), shqiptarët që jetonin në Stamboll këmbëngulnin për pjesëmarrjen e tyre në luftë nën uniformën franceze dhe jo nën atë angleze. Disa ditë pas përgjigjes që gjenerali De Gaulle i drejtoi Mbretit, në lidhje me Konferencën e aleatëve, në fundvitin e 1941-shit, 38 shqiptarë u bashkuan me Forcat franceze të lira të Legjionit të huaj në Siri, Liban dhe Palestinë.

* * *

Shumica e vullnetarëve shqiptarë ishin pro monarkisë. Kontaktet e tyre të përhershme me Mbretin Zog siguroheshin nëpërmjet oficerëve të Gardës mbretërore: kapitenit Adem Shehi dhe Faik Elmazi, nëntogerit Rexhep Bajraktari dhe rreshterit Ismail Shemsedini. Të gjithë udhëhiqeshin nga kreu këshillues i Mbretit, koloneli i Gardës, Hysen Selmani. Midis atyre që u angazhuan nën forcat franceze të lira nuk pati vetëm individë mbi të cilët harresa ka hedhur pluhurin e kohërave. Rrethi intim i Mbretit Zog nuk mungoi të jepte shembullin. Nuk mundemi të mos kujtojmë komandantin Hysen bej Agolli-Doshishti (1914-2004), nipin e Mbretit Zog, anëtar i

familjes mbretërore ish-student i Saint Cyr, i cili iu bashkua Legjionit të huaj, që në vitin 1941 dhe luftoi përkrah forcave shqiptare të inkorporuara në Forcat franceze të lira në Levant. Që në momentin e rekrutimit si vullnetar, ai mori pjesë në Batalionin VI të këmbësorisë, të Brigadës III të forcave të Levantit, të krijuara pas riorganizimit të tyre nga gjenerali De Gaulle, më 16 korrik 1943. Mbretit Zog iu desh gjithashtu të ndahej për shumë vite nga një ndër personat më besnikë të tij, togeri i Gardës Jusuf Begeja (1912-1992). Ky ish-student i Shkollës Ushtarake të Romës (Collegio Scoula Militare di Roma) e kishte filluar karrierën e tij ushtarake si toger i këmbësorisë të Batalionit I të regjimentit I të Gardës mbretërore në Tiranë në vitet 1930, ashtu si komandanti Hysen bej Agolli-Doshishti. Oficer i Mbretit Zog në mërgim, ai i kishte kërkuar leje sovranit për t'u angazhuar vullnetarisht nën forcat franceze të lira. Ashtu si komandanti Agolli-Doshishti (miku i tij më i mirë i armëve), ai u emërua fillimisht në kampin ushtarak Old Dean të Anglisë, për të kaluar disa kohë më vonë në Algjer, më 1943-shin. Pasi u vu në dijeni të shkrirjes së forcave të armatosura vishiste të Levantit prej gjeneralit De Gaulle, në nëntor 1942, togeri Begeja u bë pjesë e forcave ushtarake të Levantit të riorganizuara, në 1943-shin. Po në këto njësi u angazhua edhe komandanti Agolli-Doshishti. Mjaft i vlerësuar prej oficerëve dhe ushtarakëve francezë, togeri Begeja iu rikthye jetës civile në 1946-n, pasi kishte luftuar denjësisht për çlirimin e Francës. I cituar në rendin e ditës së Brigadës I franceze të pavarur, nën komandën supreme të Levantit, më I shkurt të vitit 1946, koloneli Sajous e përshkruan me këta terma: "Ky oficer i huaj i angazhuar vullnetarisht në forcat franceze të lira ka dhënë prova në çdo rrethanë, të ndërgjegjes dhe vlerave të larta profesionale, të denja për t'u marrë shembull, duke merituar vlerësimin dhe miqësinë e shokëve të tij. Largohet nga brigada me kujtimin më të mirë pranë eprorëve, trupave që komandoi dhe të gjithë atyre që e njohën". Me një besnikëri të padiskutueshme ndaj kujtimit të gjeneralit De Gaulle dhe Francës luftëtare, ky njeri modest dhe vetëmohues, i cili u dekorua mes të tjerash edhe me Medaljen përkujtimore të shërbimeve vullnetare të Francës së lirë, i shërbeu për vite të tëra kurorës mbretërore shqiptare, si oficer i shtatmadhorisë të Mbretit Zog, e më vonë mbretit Leka I i shqiptarëve. Me dekret mbretëror të datës 2 tetor 1975 të publikuar në

Madrid, Mbreti e emëroi kolonel komandant të Gardës mbretërore në mërgim. Mbi varrin e tij në varrezat parisiene të Thias, aty ku ndodhej, deri në nëntor 2012, varri i Mbretit Zog, kryqi i madh i Lorenës shihet i gdhendur dhe, bashkë me të, edhe një pllakë përkujtimore, në të cilën mund të lexohet letra që gjenerali De Gaulle i shkroi togerit Begeja më I shtator të 1945, në homazh të angazhimit të tij. Franca mirënjohëse Në letrën që gjenerali De Gaulle i shkruante togerit Begeja, më I shtator 1945, gjenden këto fjalë: "Duke iu përgjigjur thirrjes së Francës dhe duke rrezikuar jetën, ju u bashkuat me Forcat franceze të lira. Ju u bëtë pjesë e ekipeve vullnetare të shokëve tanë të luftës, falë të cilëve vendi ynë mundi të vazhdonte, me nder, luftën e nisur. Ju ishit ndër më të merituesshmit e atyre që i mundësuan vendit tonë fitoren. Tanimë që qëllimi është arritur, më lejoni t'ju falënderoj miqësisht, thjeshtësisht, në emër të Francës!" Për gjeneralin De Gaulle, kontributi i dhjetëra shqiptarëve që luftuan me krenari nën flamurin francez, nuk ishte thjesht prova e vërtetësisë së thirrjes universale të Francës në luftën për liri. Ky kontribut dëshmonte hapur se populli shqiptar nuk kishte reshtur së dashuri, me gjithë vështirësitë e panumërta, të luftonte përkrah Francës së lirë dhe aleatëve. Kështu, kur më 22 janar 1959, Charles de Gaulle, president i Republikës, takoi për herë të parë në Paris ministrin fuqiplotë të Shqipërisë, e cila ishte tashmë një Republikë popullore, ai pati rastin të shprehë këto konsiderata: "Jam i lumtur që po ju njoh. Kam një vlerësim tepër të madh për popullin shqiptar trim, i cili luftoi me armë në dorë. Shpresoj se marrëdhëniet midis dy vendeve tona do të zhvillohen dhe do të përmirësohen, ashtu siç ka ndodhur kur një fuqi e tretë s'ka mundur të ndërhyjë mes nesh". Diplomat i hollë, gjenerali De Gaulle i referohej si Italisë, e cila kishte penguar Mbretin Zog në vitet 1930 të vendoste marrëdhënie më të forta me Francën, ashtu edhe Bashkimit Sovjetik, i cili i bllokonte vazhdimisht marrëdhëniet midis Perëndimit dhe Shqipërisë. Sjellja në kujtesë dhe në bashkëbisedim me diplomatin shqiptar i rezistentëve shqiptarë që luftuan përkrah tij, dëshmon kujdesin e gjeneralit De Gaulle për të mos i lënë në harresë vullnetarët shqiptarë, të cilëve kreu i Francës së lirë pati rastin t'u njihte dhe t'u admironte vlerat dhe virtytet. Ishin pikërisht këto vlera dhe virtyte që e bindën gjeneralin De Gaulle për t'i dhënë Shqipërisë, vendin e një fuqie aleate dhe fitimtare pas mbarimit të Luftës.

Kështu, më 1945-n, i mbështetur nga Quai d'Orsay (Ministria e Punëve të Jashtme franceze), ai ishte i mendimit që kushdo të ishte regjimi që do të vendosej në Shqipëri, me kusht që të garantonte pavarësinë e vendit, duhej të gëzonte ushtrimin e sovranitetit mbi të gjithë territorin shqiptar në kufijtë e para 1939-s. Më 7 janar 1945, gjenerali De Gaulle dërgoi në Tiranë misionin e parë ushtarak zyrtar pranë qeverisë së përkohshme shqiptare. Shqipëria sapo ishte çliruar (29 nëntor 1944) pa ndihmën e ushtrisë së kuqe dhe shefi i rezistencës komuniste, Enver Hoxha, ishte ende thjesht komandanti i Ushtrisë nacionalçlirimtare dhe jo kreu i një republike sovjetësh. Qëllimet e tij totalitare do të dalin në dritë pak kohë më vonë. Raporti i parë, drejtuar në datën 20 janar 1945 kreut të qeverisë franceze, nënvizonte faktin se ky vend është tashmë i pavarur, edhe pse influenca jugosllave e Titos ishte shumë e ndjeshme. Raporti nxirrte në dukje rrezikun e copëtimit të vendit midis influencës sllave dhe asaj italo-angleze dhe theksonte faktin se Franca kishte të paktën një rol moral për të luajtur në favor të garantimit të unitetit të vendit. Por në vitin 1945, rreziku më i madh nuk ishte që Shqipëria të binte nën orbitën sllavo-komuniste. Vendi rrezikonte sërish – ashtu si dhe shumë herë të tjera – një copëtim në përfitim të Greqisë, e cila megjithëse i njihte mirë meritat e rezistencës shqiptare, këmbëngulte, me aprovimin gjysmë të heshtur të anglezëve, të kishte të drejta kompensimi territoriale mbi Shqipërinë, meqenëse Greqia ishte sulmuar nga ky vend "bashkëpunëtor" i fuqive të boshtit, më 1940-n. Mbreti Zog, i ndodhur fillimisht në Angli, pastaj në Egjipt, ku mërgoi pas luftës, nuk rreshti, për vite me radhë, së luftuari pretendimet greke në Shqipëri. Emisarëve grekë të cilët i propozuan disa herë ndihmë për ta rivendosur në fron, në shkëmbim të lëshimit në favor të Athinës të një pjese të territoreve të Epirit të Veriut, ai u përgjigjej se preferonte të ndihmonte komunistët shqiptarë që luftonin përkrah Enver Hoxhës, të cilët kishin në plan të parë sovranitetin kombëtar, sesa t'i jepte Greqisë qoftë edhe një grimcë të territorit shqiptar. Gazetat e Athinës e akuzuan madje Zogun I se ishte në shërbim të komunistëve të Tiranës, ndërkohë që në realitet ai ishte armiku i tyre i betuar. Në kundërshtim me atë ç'ka pohuar një autor, nuk ka fakte të pakundërshtueshme që Franca të ketë mbështetur – në vitet 1940 – rivendikimet greke mbi të ashtuquajturin Epir të Veriut, dhe as që të ketë

inkurajuar planet e inkorporimit të vendit të vogël në federatën jugosllave, mundësi që nuk përjashtohej as nga Beogradi, as nga Moska dhe as nga Londra. Drejtoria politike e Quai d'Orsay, në një letër të datës 25 qershor 1945, e inkurajonte gjeneralin De Gaulle për të bërë gjithçka që ishte e mundur për ruajtjen e integritetit dhe sovranitetit shqiptar prej orekseve territoriale të fqinjëve të saj, nëpërmjet një aktiviteti të dendur në fushën ekonomike dhe kulturore, duke evituar fërkimin me interesat anglezë dhe sovjetikë në vend. Në këtë letër rekomandohej një ndërhyrje pranë niveleve më të larta të Selisë së shenjtë, për të emëruar në Tiranë një nunc apostolik me kombësi franceze. Kjo do të zhvillohej në traditën më autentike të mbrojtjes së katolikëve shqiptarë nga Franca, aq më tepër që në këtë fushë Italia e mundur sapo kishte humbur rangun e saj të privilegjuar në Shqipëri. Franca nuk i neglizhoi elementët e lartpërmendur dhe, megjithëse tregoi kujdes të madh që politika e saj të mos dukej si një aprovim pa kusht i regjimit të ri, ajo e njohu qeverinë shqiptare në dhjetor të 1945-s, nëpërmjet një letre të firmosur nga Gjenerali. Me këtë akt, Parisi jepte një sinjal në favor të ekuilibrimit të forcave në rajon, duke kontribuar kështu në dobësimin e të gjithë pretendimeve të shpallura haptazi nga Athina dhe hoveve aneksioniste më të përmbajtura të Beogradit. Edhe pas largimit të gjeneralit De Gaulle nga pushteti, një muaj pas njohjes zyrtare, Franca bëri gjithçka që ishte e mundur për mbajtjen e ekuilibrit dhe nuk u bashkua me oponencën greko-angleze–amerikane lidhur me ftesën e Shqipërisë në Konferencën e Paqes së Parisit, e cila filloi punimet më 29 korrik 1946. Duke konsideruar se Shqipëria duhej të njihej si një vend viktimë e agresionit italian, Georges Bidault, president i Konferencës, votoi kundër pretendimeve territoriale greke të Kryeministrit Caldaris, dhe mundësoi njohjen e së drejtës se dëmshpërblimeve të luftës nga ana e Italisë, në favor të Shqipërisë. Franca ishte gjithashtu në favor të njohjes përfundimtare të sovranitetit shqiptar mbi ishullin e lakmuar të Sazanit në gjirin e Vlorës. Mbështetja që Franca i ofroi shtetit shqiptar të asaj kohe, mbështetje e bazuar mbi kujtimet e një rezistence të përbashkët, nuk do të thotë se Parisi zyrtar i dha, në çdo kohë, "carte blanche" regjimit të Tiranës. Në emër të kujtimeve të përbashkëta të rezistencës, që mishëronte në një farë mënyre figura e Mbretit Zog, si dhe të ushtarakëve vullnetarë të tij, qeveria franceze

e bëri veshin shurdh ndaj të gjitha kërkesave të përsëritura të Republikës popullore të Shqipërisë për arrestimin dhe rikthimin e emigrantëve politikë, të cilët rreth Mbretit Zog kishin krijuar në 1949-n Komitetin e Shqipërisë së Lirë. Ky komitet vazhdoi në mënyrë të lirë aktivitetet politike dhe propagandistike antikomuniste, gjatë presidencës se gjeneralit De Gaulle midis 1959-s dhe 1969-s, situatë që krijoi një konflikt madhor ndërmjet Parisit dhe Tiranës, në fillimet e Republikës V. Por ka edhe më. Gjenerali De Gaulle nuk hezitonte të shkëmbente letra zyrtare, kur qe nevoja, me Mbretin Zog, sidomos në muajt që paraprinë ndarjen e tij nga jeta, në prill 1961. Disa herë, madje, korrespondenca zyrtare që shërbimet postale të Quai d'Orsay, duhet të dorëzonin pranë përfaqësisë së "Mbretërisë shqiptare", në pamundësi për të lokalizuar këtë të fundit, depozitohej në kutinë e Ambasadës së Republikës Popullore të Shqipërisë, gjë që s'kishte si të mos i dëshpëronte diplomatët e Tiranës. Sipas të dhënave të kundërspiunazhit shqiptar, Gjenerali e kishte takuar të paktën një herë Mbretin dhe princin Leka, por ky informacion nuk është konfirmuar aktualisht nga asnjë burim tjetër. Duke mos harruar qëndrimin e Mbretit Zog gjatë luftës dhe besnikërinë e ushtarakëve të tij ndaj Francës, gjenerali De Gaulle, president i Republikës Franceze, i bëri homazh sovranit, kur ai ndërroi jetë në spitalin amerikan të Neuilly-sur-Seine, në prill 1961. Ai dërgoi si përfaqësues Roger Frey, ministër i Brendshëm, i cili kishte lidhje të vjetra me rrethet antikomuniste dhe njihte mirë familjen mbretërore. Roger Frey asistoi edhe në funeralin e njërës prej motrave të Mbretit Zog më 1965-n.

Përktheu nga frëngjishtja dr. Jonilda Bejko

KONTRIBUTI I PROF. DR. RAJKO NACHTIGAL-IT NË FUSHËN E ALBANOLOGJISË

Elbasanishtja si themel i duhur për gjuhën e njënjëshme letrare shqipe

Nikollë Berishaj

Struktura e brishtë shtetërore e Shqipërisë, e shpallur botërisht më 28 nëntor 2012 në Vlorë dhe e pranuar prej Fuqive të Mëdha, mbeti objekt i politikës rrëmbyese të fqinjëve, si të malaziasve (rrethimi i Shkodrës) dhe serbëve që pretendonin pjesët veriore të shtetit, ashtu edhe të grekëve, që kishin synime për rrëmbimin e pjesëve jugore, para së gjithash ortodokse.

Edhe rolin e Italisë intelektualët e kohës e marrin si dëshirë për okupimin e Shqipërisë, gjë që nuk ndodhi me rolin e Austro – Hungarisë.

Perandoria Austro –Hungareze kohë më parë e kishte marrë rolin e mbrojtëses së katolikëve në pjesën shqiptare të Perandorisë Otomane, pra si mbrojtëse e shqiptarëve katolikë. Okupimi austro-hungarez në këtë mënyrë u pranua më parë si ndihmë dhe hap përparimtar për shqiptarët, sesa si okupim. Kjo, madje edhe nga veprimtarët atdhetarë dhe nacionalistët, si Luigj Gurakuqi me shokë, i cili e vlerëson "okupimin" austro-hungarez të Shqipërisë si "*okupim të fuqisë mikneshë*", për dallim nga "*okupimet e fuqive anmike*", siç i vlerëson ndërhyrjet e shteteve tjera në Shqipëri.

Vërtetë se Austro-Hungaria u fut në Shkodër, më 23 janar 1916, duke sjell korpusin e XIX të përbërë nga tre divizione, mirëpo ajo edhe në popull njihej si mbrojtëse e tokave shqiptare nga copëtimi serbo-malazez, veçanërisht si mbrojtëse e qytetit të Shkodrës në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës (1913). Botërisht njihej presioni i fuqishëm që ia kishte bërë Malit të Zi në pranverën e 1913 për t'u larguar nga Shkodra pas më se një viti rrethim, me kosto rreth 10.000 viktima, që i kishin pasur malaziasit gjatë këtij rrethimi.

Madje edhe udhëpërshkruesit nga territori i Perandorisë së Austro-Hungarisë nëpër tokat e Shqipërisë Veriore, nuk ngurronin që autoriteteve të huaja, të vendosura në Shkodër, t'u mbajnë ligjërata për moskujdesin e tyre për kulturën shpirtërore të shqiptarëve. Ta përkujtojmë këtu sllovenin Niko Niniç dhe udhëpërshkrimin e tij "Albanija in Albanci" ("Shqipëria dhe shqiptarët")[148]. Fill pas librit të Niko Niniçit e kemi edhe librin e Fra Lovro Mihaçeviq (meshtar kroat në Shqipëri) *"Po Albaniji. Dojmovi s puta"* (Nëpër Shqipëri. Mbresat nga udhëtimi), *MH Zagreb 1911.* Fryma e këtyre udhëpërshkruesve tregon qartë simpatinë e tyre për popullin dhe kulturën shqiptare, dhe kujdesin që, sipas tyre, Austro – Hungaria duhet t'ia kushtojë Shqipërisë.

Gjithashtu, t'i përmendim këtu edhe studimet arkeologjike të dy studiuesve austriakë, Camilo Praschniker dhe Arnold Shober, publikuar në librin *Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro*[149] në Vjenë, më 1919.

Përgatitja e terrenit që i ishte bërë 'okupimit' austro-hungarez të Shqipërisë bëri që AH të mos humbte kohë, por të ndërmerrte masa dhe aksione në frymën e *Kultusprotektoratit.* Planin e masave dhe aktiviteteve që duhej ndërmarrë në Shqipëri e futën në dokumentin *Programi i veprimit,* që parashihte, para së gjithash, përmirësimin e aparatit kishtar, sistemit shkollor dhe kulturës në përgjithësi në Shqipëri.

Se qëndrimi i Austro-Hungarisë nuk ishte vetëm rezultat i politikës së ditës dhe interesave të saj afatshkurtra në këtë pjesë të Ballkanit, tregon edhe fakti se në universitetet e kohës: në Vjenë mësohet edhe *Albanien im Mittelalter (Shqipëria në Mesjetë),* të cilën e ligjëronte prof. Dr. Jozef K. Jireçek-u[150]. Po ashtu edhe në Universitetin e Gradecit (Grazit)[151] bëheshin studime mbi gjuhën shqipe, si pjesë e pandarë e lëndëve mësimore.

---

[148] Edinost Trieste. Përkthimin tim të kësaj broshure interesante e botoi revista Koha Javore, Podgoricë

[149] Botimin në shqip të këtij libri, me titullin *Kërkime arkeologjike në Shqipëri dhe Mal të Zi* e bëri SHB "Pegi", Tiranë 2003

[150] shih Miroslav Karaulac, Rani Andrić, Prosvjeta Beograd, Svjetlost Sarajevo 1980, fq. 29, 36

Censori mbretëror për librat sllavë dhe ballkanikë, Jernej Kopitari, në interesimin e vet për shqipen, ngarkon me detyrë mbledhësit e folklorit ballkanik, në mes tyre edhe Vuk Karaxhiqin, të merren edhe me folklorin shqiptar. Pasuesi i tij, Franc Miklloshiçi, më 1870 boton punimin e vet *Die slavischen Elemente im albanischen* (Elementet sllave në gjuhën shqipe). Në libër ai jep edhe shtrirjen e shqiptarëve dhe të dhënat statistikore për popullsinë, por çka është më me rëndësi, në fund të librit e jep edhe një bibliografi të botimeve të deriatëhershme (për të të njohura) shqipe, që fillon me fjalorin e F. Bardhit –1635 dhe përfundon me Kangët e Milosaos të J. De Radës - 1886, por që nuk i njeh as Buzukun e as dokumentet para tij. Gjithashtu, fakt interesant është edhe vendimi i shtatmadhorisë së ushtrisë austro-hungareze që gjuha shqipe të bëhet gjuhë zyrtare e saj. Këtë e bën publike në Lajmet e ditës gazeta sllovene Slovenski narod.[152]

Por, t'i kthehemi objektit kryesor të interesimit tonë në këtë studim, e ky është njëri nga linguistët më të mëdhenj slloven, dhe jo vetëm, prof. dr. Rajko Nachtigal[153] (Nahtigal).

Rajko Nachtigal, u lind më 14 prill 1877 në Novo Mesto në një familje intelektuale. Shkollën fillore dhe dy vjet të gjimnazit i përfundoi në Novo Mesto, ndërsa gjashtë klasat tjera në Lublanë. Diplomoi filozofinë në Vjenë, si student i profesorëve Jagiq, K. Jireçek, Vondrák, Meringer etj. Promovohet në doktor (Filologjia sllave dhe gjuhësia krahasuese) më 1901, në kohën kur, si bursist i Ministrisë së arsimit, ishte në studime në Moskë dhe Petrograd. Më 1902 merr pozitën e profesorit të rusishtes në Vjenë, bëhet docent i gjuhës ruse dhe lektor i po të njëjtës në Seminarin e historisë së Evropës Lindore dhe Seminarin e Filologjisë Sllave. Më 1913 fiton titullin e profesorit inordinar, ndërsa më 1917 profesorit të rregullt të Universitetit të Grazit (Gradec / Graz), ndërsa më 1919 prof. i rregullt i

[151] dualizmi në shënimin e emrit të qytetit Gradec – Graz vjen nga emërtimi slloven apo austriak. Populllsia shumicë e këtij qyteti është sllovene, dhe emërtimi Gradec (në përkthim Qytezë) është rrjedhojë e kësaj

[152] Slovenski narod (14.02.1914), viti 47, numri 36

[153] shënimi Nachtigal na del gjithkund në botimet josllovene (pra Gjermane ..., ndërsa versioni Nahtigal në botimet sllovene

Universitetit të Lublanës (u zgjodh dekani i parë i Fakultetit filozofik, më vonë edhe rektor i Universitetit, më 1927/28).

Gjatë viteve të studimit, u njoftua dhe krijoi miqësi të vërtetë me diplomatin dhe linguistin shqiptar nga Ohri, Gjergj Pekmezin (1872-1938), i cili në vitin 1902 u promovua në bartës të katedrës së gjuhës shqipe pranë Institutit oriental në Vjenë. Duhet cekur se Gj. Pekmezi, R. Nachtigali dhe Ivan Prijatelji, që të tre studentë të Vatrosllav Jagiqit, ishin "treshe e pandarë miqësore" aq sa më 1902 edhe e morën banesën e përbashkët. Interesimi i përbashkët për linguistikën krahasuese i Pekmezit dhe Nachtigalit rezultojnë me botimin e veprës monumentale "Grammatik der albanesischen Sprache", të nënshkruar nga Gj. Pekmezi, por që sipas të gjitha gjasave e ka edhe mbështetjen shumë të madhe të mikut të tij, Nachtigalit[154]

Interesimi i Nachtigalit për gjuhën shqipe rezultoi me botimin e disa studimeve dhe publikimeve të rëndësishme për gjuhën shqipe dhe historinë e saj, si:

- *Die Bildung der Possessivpronomina im Albanischen und ihre bisherige falsche Auffassung* (Posta e Shqypniës, Shkodër 28 Prill 1917, 3–4);
- *Die Frage einer einheitlichen albanischen Schriftsprache* (Graz 1917);
- *O elbasanskem pismu in pismenstvu na njem* (Arhiv za arbanasku starinu, jezik in etnologiju I, 1923);
- *Luk. XV 11–32 v prevodu bratov Anastasija in Spyridona Tsellio (Tsel'o) iz Argyrokastra. Iz Kopitarjeve zapuščine* (Arhiv za arbanasku starinu, jezik in etnologiju II, 1924).[155]

---

[154] shih Rajko Nahtigal: Pisma Ivana Prijatelja s študijskega potovanja 1903-1904. në: Ljubljanski zvon, 57, 1937, str. 301-313

[155] për më shumë shih: Franc Jakopin: Albanološke študije Rajka Nahtigala. në: Jezik in slovstvo, 23, 1977-78, fq. 65-70

Komisija Letrare e Shkodrës dhe Nachtigali

"Dishiri dhe përkrahja e Austrisë për të mëkambë gjuhën shqipe i dhanë zemër veteranëve të kombit për punë përherë e ma të vlefshme në këtë drejtim. Kjo përkrahje trimënoi L. Gurakuqin të themelonte, më 3 gusht 1916, nën mbrojtjen e autoriteteve ushtarake të kryesueme nga gjeneral Trollman dhe i ndikuem nga Dr. R. Nachtigal, studiues ky i gjuhës sonë, si dhe nga dr. Gjergj Pekmezi Komisinë Letrare"[156].

Më duhet të cekë këtu se nuk e kuptoj kundërshtimin e autorëve të nderuar Tomorr Osmanit dhe Mentor Qukut që e mohojnë rolin e Gurakuqit, Nachtigalit dhe Pekmezit, si themelues të Komisisë, por këtë ia mveshin vetëm Austro-Hungarisë përmes komandantit Trollman[157].

Askush nuk mund t'ia mohojë Austro-Hungarisë rolin nismëtar të Komisisë, por a nuk është vet emri AH paksa imagjinar për një aktivitet konkret. Vet fakti se prof. dr. Gjergj Pekmezi emërohet nga Komanda ushtarake austro-hungareze kryetari i parë i Komisisë Letrare dhe se përpara ishte mjaft i eksponuar në Vjen pikërisht lidhur me çështjet e gjuhës shqipe, pastaj fakti i miqësisë së ngushtë (Nachtigali e quan probatini) të Pekmezit me Nachtigalin, më çojnë të mendoj pozitivisht lidhur me qëndrimin e cituar më sipër të Daniel Gjeçajt (alias Pal Dukës). Për më tepër prof. dr., Gjergj Pekmezi si profesor i Akademisë diplomatike Vjeneze caktohet ta përcjell Princ Weidin në Shqipëri. Në fund të fundit komandanti Trollman është, si të gjithë ushtarakët, vetëm zbatues i politikës së definuar diku tjetër. Çështja e gjuhës, sigurisht se nuk është definuar në kabinetet ushtarake, por në institucione shkencore, ku zënin vend të merituar të dy të lartpërmendurit.

Edhe vet fakti se Komisia letrare prej të gjithë albanologëve të kohës e fton pikërisht Rajko Nachtigalin për ekspeditën studimore lidhur me mundësinë e përcaktimit të bazës më të mirë për gjuhën e përbashkët

---

[156] Pal Duka-Gjini në monografinë "Gjergj Fishta jeta dhe vepra" (Tiranë, 1992, f.100)
[157] Mentor Quku, Mjeda 4, fq 220 /shënimi 58/

letrare, thotë mjaft. Përndryshe, duhet cekur se po në atë kohë edhe Maximillian Lambretzi i kryen studimet e veta gjuhësore nëpër Shqipëri.

"... Mbas urdhrit të Qeverisë AH vajti tash në Shqipëri edhe Dr. Rajko Nachtigall, profesor i universitetit të Grazit e bashkëpunëtor i prof. dr. Gjergj Pekmezit. Këta profesorë (*pra* Nachtigalli dhe Lambretzi, vër ime*), bashkë me prof. Gjergj Pekmezin e me D. Ndre Mjedën kanë me u nisë për Elbasan, ku do vijojnë studimet e dijalektevet të Shqypnies së mesme..."*[158]

I. Është Gjergj Pekmezi anëtari më i flakët i KLSH, për ta ftuar Nachtigallin që ta bëjë vlerësimin nëse është ende gjallë gjuha e Kristoforidhit (e folmja e Elbasanit) dhe a duhet të merret ajo si bazë për gjuhën letrare. Përndryshe, vendimi për ta ftuar një albanolog të huaj merret në mbledhjen e KLSH më 12. 12. 1916. Lajmërimin lidhur me vendimin Pekmezi ia bën me dije Nachtigallit në letrën e tij me rastin e Krishtlindjes 1916. Më vonë, me vendimin e mbledhjes së datës 21. 03. 1917 caktohet që në ekspeditë të marrë pjesë edhe Dom Ndre Mjeda, ndërsa në Elbasan u bashkëngjitet edhe Aleksandër Xhuvani .

Ekspedita filloi më 01. 05. 1917 dhe përfundoi, sipas të gjitha gjasave, më 26. 05. 1917. Raportin mbi punën e nënshkruan Rajko Nachtigali, Gjergj Pekmezi dhe Ndre Mjeda.

Pas ekspeditës studimore në fshatrat e Elbasanit, me emrin e prof. dr. Rajko Nachtigalit botohet në Graz, më 1917 vepra: *Die Frage einer einheitlichen albanischen Schriftsprache.*[159]

Ta shohim se si e përshkruan daljen e këtij dokumenti të rëndësishëm të albanologjisë linguisti tjetër slloven, prof. dr. Fran Ramovsh[160]:

---

[158] *Vendim i gjuhës letrare në Shqypni,* Vëllaznija, v2. nr. 57, fq 2, Vjenë, 14. 05. 1917 (sipas Mentor Quku, Mjeda 4, fq 213)

[159] "Çështja e një gjuhe shqipe të njënjëshme"

"Dr. R. Nachtigall, Die Frage einer einheitlichen albanischen Schriftsprache, Gedruckt als Manuskript bei "Leykam", Graz 1917.

Çështja e gjuhës unike letrare shqipe, nuk është më çështje e re, por është bërë edhe më e rëndësishme, qëkur është rritur interesimi politik për këtë popull ballkanik. Se këtu, medoemos nevojitet një themel i fortë, e ka të qartë çdokush, që ka studiuar kurdoherë shqipen. Edhe vet studimi i kësaj gjuhe ka qenë i vështirë dhe e ka penguar nxënësin në cilindo aspekt; së pari deri në kohë të fundit nuk ka pasur asnjë libër praktik dhe të besueshëm, dhe së dyti, edhe gramatika e Weigandit e vitit 1913, ndonëse ka pasur përparësinë e bukur dhe të madhe se është bazuar në dialektin qendror, atë të Elbasanit, është jo e plotë dhe e vështirë, pasi që për shkak të jounitetit të shqipes së shkruar është dashtë të bazohet në dialekte, gjë që e dëmton librin praktik. Këto mungesa i ndjen secili i huaj, që e studion gjuhën shqipe, e aq më tepër vet shqiptarët.

Komisia Letrare e Shkodrës ka ardhur deri në përfundim se këto vështirësi i tejkalon dialekti qendror, që do të duhej të krijonte bërthamën e shqipes letrare, dhe ka vendosur edhe në terren t'i bëjë studimet e mëtutjeshme dhe të vendosë unitetin në pikat problematike. Për këtë studim e ka ftuar edhe mendimtarin slloven, z. prof. universitar dr. Nachtigall në Gradec, të cilit shqiptarët edhe për shkak të bashkëpunimit të tij të madh në gramatikën shqipe të Pekmezit, i kanë borxh falënderim të madh. Në librin e cekur më sipër, që përbëhet nga Parathënia (fq. III-VI), Promemoriet për çështjet aktuale (fq. I-18) dhe shtojca e tij (fq 19-29), prof.

[160] **Fran Ramovš**, linguisti, dialektologu dhe topologu slloven (1890-1952). Ka studiuar në Vjenë dhe Graz. Më 3. dhjetor 1919 ka pasur ligjëratën e parë mbi sllovenishten në Universitetin e posaformuar të Lublanës, (sot dita e Universitetit). Profesor në Fakultetin Filozofik në Lublanë dhe rektor i Universitetit (1934/35) Bashkëthemelues i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Sllovenisë (SAZU) dhe kryetari i katërt i saj. Emrin e tij e mban Instituti për gjuhën sllovene pranë Qendrës hulumtuese shkencore (ZRC SAZU).

Nachtigalli na jep mendimin e vet mbi gjuhën e njësuar letrare shqipe sipas vlerësimeve që vijojnë:

Gjithçka që është shkruar deri më sot në gjuhën shqipe është shkruar në dialektin e gegëve, që banojnë në Shqipërinë e Veriut, apo në dialektin e toskëve, që banojnë në Shqipërinë e Jugut. Mirëpo, këto dy dialekte dallojnë aq shumë njëri prej tjetrit, që gegët vështirë, apo aspak nuk i kuptojnë toskët, apo anasjelltas. Për këtë arsye plotësisht përjashtohet mundësia, që cilido nga këto dy dialekte, të mund të krijojë kurdoherë gjuhën letrare të tërë kombit shqiptar. E nëse të dy dialektet mbesin edhe më tutje në përdorim letrar, Zoti e di kur do të vinin shqiptarët deri te uniteti. Ndërsa gjuha artificiale, si përzierje e të dy dialekteve, do të ishte diçka e jo e natyrshme, dhe pikërisht për këtë askurrë nuk do të mund të bëhej pronë e popullit. Nga kjo shohim se çështja e gjuhës së njësuar letrare shqipe nuk është aq e thjeshtë, siç do të mendonte dikush në çastin e parë. Mirëpo, popujt tjerë të kulturuar mund të na e japin dritën në rrugë: Vuku e ka vendosur te kroatët dhe serbët dialektin qendror jekavik për përdorim të gjuhës letrare, ndërsa sllloveni i Koroshkës dhe i Bella Krajinës, që po ashtu kuptohen vështirë ndërmjet vetes, e lexojnë dialektin e Dolenjskës, edhe ky dialekt qendror, dhe e kuptojnë atë. Në mënyrë të njëjtë dialekti qendror te shqiptarët i lidh të dy dialektet anësore dhe e krijon gjuhën e njësuar letrare! Ky dialekt është elbasanishtja, të cilin mund ta kuptojnë të dy pjesët, gegët dhe toskët. Prof. Nachtigalli e arsyeton këtë zgjedhje, të cilën e ka bërë të qëndrueshme disa vite më parë kongresi i Elbasanit, e tani edhe Komisia Letrare në Shkodër. Në aspektin e dallimeve, qofshin të natyrës fonetike apo morfologjike në të dy dialektet dhe refleksionet e bazuara në to, prof. Nachtigalli, duke u bazuar në gjuhën e Kristoforidhit, vendos formën që do të jetë karakteristike për gjuhën e njësuar letrare. Ndërsa, në aspektin sintaksor dhe leksikologjik prurjet e veta duhet t'i japë secili dialekt, pra i tërë populli, e posaçërisht për faktin se fjalët e huaja duhet të zëvendësohen me fjalë të gjalla shqipe.

Rëndësi shumë më të madhe fiton e folmja e Elbasanit si themel i gjuhës letrare, nëse e dimë se ky dialekt është, të thuash letrar, nëse i shikojmë shkrimet e Konstantin Kristoforidhit, që e ka përpiluar edhe gramatikën dhe fjalorin e gjuhës shqipe. Është shumë interesant fakti se edhe Kristoforidhi u është përmbajtur parimeve që i propanon dhe i argumenton z. profesor Nachtigali. Pra, shkrimet e Kristoforidhit duhet të përshkruhen me ortografi të re, me ç' gjë bëhet një hap i madh në rrugën e njësimit të gjuhës letrare shqipe. Në këtë frymë edhe këshillimi i z. prof. Nachtigall: "Schafft zunächst die Grammatik nach Kristoforidi und dem Elbasaner Dielekt[161]" (fq. 29) është plotësisht i bazuar, e për këtë arsye edhe i vetmi që mund të sjellë sukses.

Në shtojcë, prof. Nachtigalli polemizon me prof. Lambretzin, i cili vlerëson se e folmja shkodrane është e gatshme të bëhet themel i gjuhës letrare shqipe. Kundërshtimet e tij janë të qarta dhe plotësisht të arsyeshme. Përkundrazi, jam i mendimit se do të ishte më së miri që për *k'* dhe *g'* palatale (tani *q* dhe *gj*) të merren shenjat kroate (shih faqet 21 dhe 10); mendim të njëjtë ka edhe z. prof. Nachtigalli, që në fund i pranon shenjat *q* dhe *gj* duke vërejtur: "die einmal hergestellte Einheit soll nich weiter gestört werden. Spätere Zeiten werden ngewiss auch hierin besseren Wandel shaffen". Mirëpo, më vonë, kur të mishërohen plotësisht shenjat e gatshme, kjo nuk është më e lehtë; për këtë arsye do të ishte mirë që të ndërmerren menjëherë masa.

Shqyrtimet e z. prof. Nachtigallit na e japin këtë mëndim të tijin lidhur me gjuhën e njësuar shqipe: Bazuar në gjuhën e Kristoforidhit dhe dialektin e Elbasanit të punohet edhe gramatika; dialekti i cekur le të jetë kriter për ortoepinë shqipe, ndërsa gjuha e Kristoforidhit shembull për fiksimin e shkruar. Si bazament që jep kahun e duhur, kjo me siguri do të mjaftojë.

161

Z. prof. Nachtigalli premton në librin në fjalë më shumë debate rreth dukurive të caktuara fonetike të gjuhës shqipe, në mesin e të cilëve më interesanti do të ishte debati mbi *ë*-në. Shkencëtarit të mirëfilltë i dëshirojmë që ta ketë sa më parë të mundshme t'i japë këndvështrimet e veta, me ç'gjë do ta pasurojë edhe gramatikën krahasuese.

Dr. Ramovš«[162]

Fill pas ekspeditës studimore në Elbasan dhe botimit të *Die frage...*, më 3 tetor 1917 në Universitetin e Grazit hapet Instituti i Ballkanit, dhe si na lajmëron Posta e Shqypniës, e drejtuar nga P. Gjergj Fishta: "*Aty ka me u msue edhe gjuha shqipe. Në këtë zyre u emnue profesori i universitetit Dr. Rajko Nachtigal*"[163]

Ekzistojnë tentativa që t'i mohohet autorësia ekskluzive e *Die Frage...* prof. Nachtigallit, duke ia shtuar Don Ndre Mjedën si bashkautor. Këtë tenton ta argumentojë studiuesi i spikatur, mjedologu më i madh, profesori Mentor Quku. Argumentimi i tij për bashkautorësinë bazohet në bashkëveprimin e të dy studiuesve në ekspeditën studimore dhe aktin e përkthimit të *Promemories* në gjuhën shqipe nga Don Ndre Mjeda. Sa i përket bashkëveprimit, përpos Mjedës, aty merr pjesë edhe prof. dr. Gjergj Pekmezi, por edhe Aleksandër Xhuvani. Siç e pamë edhe nga artikulli i dr. Ramovshit, *Promemorja* është vetëm njëra pjesë e librit, padyshim e bazuar në veprimtarinë shkencore të ekipit, përkthimin në shqip të së cilës e bëri Don Ndre Mjeda. (Ky version, sipas M. Qukut, nuk është zbuluar ende. Nachtigali ndërkohë ishte kthyer në Graz!)

Gjithashtu, në mbledhjen e KLSH, të datës 23. 01. 1918, vendoset që "*përkthimi i promemories së* ***Z. Dr. Nachtigalit,*** *(theksimi im, N.B.) tue qenë se shumica e misvet (anëtarëve, vër. N.B.) janë të mendimit se nuk del*

[162] Ljubljanski Zvon, viti 38, nr 1, janar 1918
[163] Posta e Shqypniës, nr 89., Shkodër, më 3.10.1917

nji fitim prej saj, mbasi s'asht vepër origjinale por përkthim, prandaj lihet me nji anë."[164]

Vet fakti se as pjesëmarrësit tjerë të ekspeditës nuk shënohen si bashkautorë dhe bazuar në vendimin e sipërshënuar nga mbledhja e KLSH, e 23. 01. 1918, ku padyshim merr pjesë edhe Mjeda, jam i mendimit se bashkautorësia e tekstit *Die Frage...* nuk mund të mbrohet.

Pavarësisht vendimit të Komisisë Letrare, argumenteve të fuqishme të shumicës së anëtarëve të saj, me në krye pjesëmarrësit e Ekspeditës, në punën e KLSH ka edhe divergjenca të mëdha, para së gjithash këtu mund t'i marrim kundërshtimet e Maksimilian Lambretzit, që ishte këmbëngulës që e folmja e Shkodrës të bëhet themel për gjuhën e përbashkët letrare shqipe, me pretekst se elbasanishtja nuk kishte traditë letrare, e Shkodra po, vendimi përfundimtar nuk u mor. Ky edhe falë rrethanave historike pas Luftës së Parë Botërore. Lidhur me shkodranishten "Nachtigali tërheq vërejtjen për gjendjen tipike periferike të kësaj të folmeje, ku reduksioni ka arritur vrullin më të madh dhe për këtë nuk do të ishte e përshtatshme t'u imponohet shqiptarëve tjerë kjo formë e gjuhës letrare"[165]

Nachtigali e përdor thënien e njohur *shqipja e Elbasanit e turçja e Stambollit*, mirëpo alfabetet e ndryshme shpesh e kanë mjegulluar pamjen unike të gjuhës. Propozon edhe themelimin e Bletës shqiptare, apo Arkivit për gjuhën dhe kulturën shqiptare, që do të publikonte në vazhdimësi artikuj shkencorë dhe gjuhësorë, material folklorik, si dhe pasurinë gjuhësore shqiptare.

Mirëpo, edhe përkundër kësaj, (shkatërrimit të Perandorisë AH ...) interesimi i prof. dr. Rajko Nachtigalit për çështjet e gjuhës së njësuar letrare shqipe nuk përfunduan. I shtyrë nga kundërshtimet e Lambretzit dhe qëndrimi i po të njëjtit mbi mungesën e traditës së të shkruarit shqip në

---

[164] AQSH, regjistri i procesverbalëve të KLSH, mbl. dt. 23.1.1918, cituar sipas M.Çuku, Mjeda 4, fq245

[165] Shih: Franc Jakopin, *Albanološke študije Rajka Nahtigala,* Jezik in slovstvo Letnik XXIII številka 3-4 Ljubljana, december-januar 1977/78, fq 65-71

Elbasan, ai në revistën e udhëhequr nga prof. Henrik Barić[166], që botohet në Beograd, i boton dy studime tejet të rëndësishme[167]:

I. *O elbasanskem pismu in pismenstvu na njem (1923);* dhe

2. Luk. XV 11–32 v prevodu bratov Anastasija in Spyridona Tsellio (Tsel'o) iz Argyrokastra. Iz Kopitarjeve zapuščine (ibid. II, 1924).

Lidhur me punimin e parë, pra lidhur me alfabetin e Elbasanit, studenti i tij Franc Jakopin, përndryshe ndër linguistët më të njohur sllovenë të pjesës së dytë të shekullit 20, shkruan në artikullin e tij: *Albanološke študije Rajka Nahtigala*[168], dhe mes tjerash thotë:

"Nuk mund ta anashkalojmë konstatimin se nga i tërë shqyrtimi buron simpatia e dukshme e Nachtigalit ndaj gjuhës shqipe dhe shqiptarëve; ai sinqerisht dëshiron që ata të ngrihen sa më shpejt në aspektin kulturor dhe arsimor, e për këtë është parakusht – gjuha e përbashkët letrare."[169]

Pra, gjashtë vjet pas *Die frage...* Nachtigali i qaset edhe një herë problematikës së albanologjisë. Në studimin e tij *Mbi alfabetin e Elbasanit...* ai e jep fillimisht historikun e zbulimit të atij alfabeti, për të cilin kishte folur në mënyrë mjaft sensacionale albanologu dhe vicekonsulli austriak në Janinë, J. G. Hahn. Hahni që me veprën e tij madhore *"Albanesische Studien",* 1854, (Studime shqiptare), në tri vëllime njihet si themelues i studimeve mbi shqiptarët. Pavarësisht këtyre epiteteve, Hahni në ligjëratat e veta dhe në shtyp e vlerëson gabimisht alfabetin e Elbasanit si alfabet të burimit fenikas, që është edhe më i vjetër se alfabeti i greqishtes së vjetër.

---

[166] Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju, Beograd 1923-1924

[167] Të dy punimet e prof. dr. Rajko Nachtigalit i kam përkthyer në shkurt-mars të këtij viti (2015) në shqip me kërkesën e Akademisë së Shkencave të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Sllovenisë. I pari mban titullin *Mbi alfabetin e Elbasanit dhe letërshkrimin në të,* ndërsa i dyti *Luka XV 11-32 në përkthimin e vëllezërve Anastas dhe Spyridon Tsellio (Tsel'o) nga Argyrocastra*
(Nga punishtja e Kopitarit). Sipas informative të mia, përkthimi deri më tani nuk është botuar.

[168] Franc Jakopin, *Albanološke študije Rajka Nahtigala...*

[169] ibidem

Edhe në fillim të shekullit, diku rreth vitit 1900, kur Gjergj Pekmezi solli në Vjenë të dhënat e para mbi alfabetin në fjalë, miku i tij i ngushtë, Rajko Nachtigalli ishte i mendimit se vjetërsia e këtij alfabeti nuk mund të jetë më e madhe se dy shekuj. Me një argumentim shkencor e me përpikëri të madhe, Nachtigali e hedh tezën se autori i alfabetit është dhaskal-i (mësuesi, vër. N.B.) Todhëri, elbasanasi që i kishte marrë mësimet në Moshopol (ashtu e quan fillimisht Voskopojën, vër. N.B.). Edhe Hahni e kishte lidhur këtë alfabet me Voskopojën dhe me Todhërin, por nuk e mendonte të kishte buruar pikërisht aty. Me këtë alfabet ishte marr edhe paleografi zagrebas Geitler (*Die albanesischen und slavischen Schriften*, 1883), mirëpo teza e Nachtigalit se autori i këtij alfabeti ishte dhaskal Todhëri u pranua nga shkenca si e vërtetë. Ndihmë për argumentimin e autorësisë së alfabetit Nachtigalit i sjellin edhe shënimet e Dositej Obradoviqit, që i kishte kaluar disa vite nëpër shkollat shqipe dhe greke të kohës dhe që e kishte njoftuar në Venecia mësuesin voskopojar Todhërin.

"Edhe përkundër dyshimeve të arsyeshme personale, Hahni është përcaktuar për një vjetërsi të madhe të alfabetit të Elbasanit, duke e parë në të motrën më të vjetër të alfabetit fenikas, apo motrën e alfabetit paragrek (shih fq. 863). Në faqen 853 ai e krahason alfabetin e Elbasanit me alfabetin fenikas dhe paragrek dhe vjen deri te përfundimi se: I. alfabeti i Elbasanit si edhe ai grek, buron nga alfabeti i fenikasve dhe 2. alfabeti i Elbasanit në shumë forma më shumë bazohet në prototip se në alfabetin grek"[170].

Mirëpo, albanologët e ndryshëm e njohin shprehinë e vjetër të shqiptarëve për të komunikuar me shenja (shifra) të fshehta. Duket se vet jeta nën okupim shekullor ua ka imponuar një gjë të tillë, pavarësisht se këto "alfabete" nuk kanë shtrirje aq të madhe territoriale. Është interesant këtu ta japim fusnotën 5 nga teksti i Nachtigalit: "*Për një alfabet të tillë të fshehtë nga Shqipëria e jugut raporton Hahni në faqen 867. Atij ia ka shpjeguar njëri nga udhëheqësit më në zë nga Argyra, "Vrastron Veso beu nga familja e Alisot Pashalidit." Në rininë e hershme këtij ia ka mësuar alfabetin mësuesi*

[170] R.Nachtigal, *O elbasanskem*... në përkthimin tim

i tij vendor - një hoxhë me prejardhje shqiptare. Alfabeti i fshehtë është trashëguar në familje, kështu që beu e ka përdorur këtë në letërkëmbim me të afërmit."[171]

Për Moshopolin (*Voskopojën* vër. N.B.) autori jep shënime të intelektualëve tjerë të kohës, që nga Jireçeku e deri te dr. Vlladan Gjorgjeviqi, që ndonëse i njohur si antishqiptar i përbetuar (shih p.sh. veprën e tij *Arnauti i velike sile,* Beograd 1913) shprehet: *"Në Arbaninë (Shqipërinë vër. N.B.) e epërme hasim në shkolla në shumë manastire, në veçanti në Ἰ'ςά μουή dhe në manastirin e Shën Naumit në Beograd (Berat), Koric, Ahridi, Siptiki. Shkolla më e rëndësishme e këtyre anëve ka qenë në Moshopolis (Voskopojë, vër ime N.B.), ku në vitin 1710 është themeluar edhe shtypshkronja, duke iu falënderuar baronit S. Sini-t, me prejardhje prej atij vendi, shkolla ekziston edhe sot aty"*

Lajmet e para të reja mbi alfabetin e Elbasanit, sipas Hahnit, i ka sjell nga Elbasani Gjergj Pekmezi, të cilin Komisioni ballkanik i Akademisë së Shkencave të Vjenës e dërgoi në vitin 1900 në Shqipëri me qëllim të studimeve dialektologjike. Mirëpo Hahni nuk gjen më shumë se një faqe të shtypur në atë alfabet, ndërsa dy artikuj të shtypur i gjeti Gjergj Pekmezi në bibliotekën e Shën Gjon Vladimirit në Elbasan me ligatura që përsëriten në mënyrë krejtësisht identike si në alfabetin e Elbasanit.

Më tutje Nachtigali jep njohuri tjera mbi dhaskal Todhërin, autorin e alfabetit, të fituara nga njerëz në manastiret e Elbasanit, por edhe tërthorazi, nga shënimet anësore në përkthimet e bëra nga Todhëri dhe të përshkruara nga pasardhës të tij. Ai e kundërshton tezën se bëhet fjalë për Teodor Kavalliotin, tezë kjo e lëshuar nga Dhimitër Camarda.

Alfabeti nuk ka pushtuar përmasa të gjëra gjeografike, më parë mund të themi se ka qenë mjaft i kufizuar sa i përket lokalitetit. Është njohur vetëm deri në Berat. Madje, Nachtigali në një vend shkruan: *"Prej njerëzve që e kanë njohur ende shkrimin jam njoftuar me një grua të moçme. Mund të thuhet se alfabeti është kultivuar para së gjithash në qarqe familjare.*

[171] ibidem, fusnota 5

Gjithsesi është koha e fundit që të konstatohet ç'mund të konstatohet, sepse njerëzit që kanë ditur çfarëdo rreth kësaj, shumica janë në moshë të thyer, në mes tyre edhe një igumen i plaktë i manastirit"[172].

Fati i keq deshi që, siç na njofton Hahni, dhe e përcjell Nachtigalli, Todhëri vdes nga një sëmundje ngjitëse: *"... bashkatdhetarët, pas një epidemie të rëndë ngjitëse, nga frika e infektimit të ri, i kanë djegur të gjitha shënimet e tij. Duke marrë parasysh vjetërsinë e bashkëkohësve të tij, që ishin gjallë në kohën e Hahnit, ai me siguri ka vdekur diku kah fundi i shekullit të XVIII. Ka studiuar në Moshopol dhjetë orë në lindje nga Berati."*[173]

Pas përshkrimit të thuktë të historikut të paraqitjes së mundshme të alfabetit, autorëve të tij të mundshëm dhe përcaktimit të Nachtigalit për dhaskal Todhërin si përpilues të tij, e siç thotë vet autori: *"Jo i plotë do të ishte diskutimi në këtë Arkiv, sikur të mos e jepja pikërisht këtu një mostër të gjuhës së Todhërit, për ç'gjë, për Todhërin dhe për gjuhën e tij do të duhej të shkruhej edhe më shumë, veçanërisht kur të plotësohen të dhënat nga Elbasani"*[174] dhe pasojnë kopjet e *"mostrave"* të gjuhës së Todhërit, me shpjegime akribike të autorit, sipas të cilave mund ta shohim edhe thellësinë e njohjes së shqipes nga ana e Nachtigalit.

Dhe krejt në fund, autori e jep edhe përshkrimin e 52 shkronjave të alfabetit të Elbasanit, krahasimin e tyre me nevojat e gjuhës shqipe të kohës, krahasimi i tyre me shkronjat e alfabetit grek dhe alfabeteve tjerë që gjejnë përdorim të gjerë në kohën e përpilimit të alfabetit.

Por, është pak për tu çuditur fakti, që njohësi i mirë i jetës dhe veprës së Nachtigalit, Franc Jakopin, në artikullin *"Albanološke študije Rajka Nahtigala" (Studimet albanologjike të Rajko Nachtigalit),* të botuar në Lublanë, më 1977/78, pas përshkrimit të studimit të Nachtigalit *O elbasanskem pismu...* e përfundon artikullin e vet me: *"Pas kësaj Nahtigali*

[172] R.Nachtigal, *O elbasanskem*... në përkthimin tim
[173] ibidem
[174] ibidem

nuk është marrë më me çështjet albanologjike: njohjen e kësaj gjuhe aty-këtu e ka shfrytëzuar në debatet sllavistike." [175]

Në fakt, pas studimit *O elbasanskem pismu...*, po në të njëjtën revistë[176] të Henrik Bariçit, një vit më vonë (më 1924) Nachtigali e boton studimin tjetër po aq të mirë *Luka XV 11-32 në përkthimin e vëllezërve Anastas dhe Spyridon Tsellio (Tsel'o) nga Argyrocastra.*[177]

Sipas të dhënave që i kemi në dispozicion nga vet Kopitari, censori mbretëror i Vjenës, vëllezërit shqiptarë *Anastas dhe Spyridon Tsellio (Tsel'o) nga Argyrocastra* (Anastas dhe Spiridon Çelo nga Gjirokastra), me ndërmjetësimin e M.G. Bojaxhiut, kishin përkthyer për Jernej Kopitarin tregimin mbi djalin e humbur (Luka XV 11-32). Këtë përkthim Kopitari e kishte botuar më vonë në transkriptimin e tij në revistën Jahrbücher der Literatur që botohej në Vjenë, në vitet 1818-1849. Ishin pra vitet kur ndër shqiptarët ende shkruhej me alfabete të ndryshme: greke, latine, arabe e cirilike. Interesimi i Kopitarit për gjuhët ishte shumë i madh, në fakt ai shfaqte interesim për gjuhët sllave, por edhe për gjuhët e fqinjëve të tyre, ku padyshim ishte më interesantja shqipja si oazë gjuhësore pa asnjë pikëtakim me gjuhët tjera.

Përkthimi në fjalë është i ruajtur në katër kopje dorëshkrimore, të cilat, për hir të studimit, Nachtigali i shënon me versioni A, B dhe C, ndërsa versionin e botimit të Kopitarit e shënon me D. Të tri kopjet dorëshkrimore është dashtë të jenë bërë nën mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e drejtpërdrejtë të Kopitarit. Idenë mbi grafikën e Vuk Karaxhiqit, atë shpirtëror i të cilit ishte Kopitari, ai dëshironte t'ua imponontе fqinjëve të sllavëve, pra shqiptarëve dhe rumunëve, për aq më tepër ngase Kopitari nuk ishte i kënaqur me grafikën e misionarëve latinë për gjuhën shqipe. Grafika e Vukut atëbotë ende nuk ishte ngjitur mirë as te sllovenët, te kombi i Kopitarit, që i kishte 4 alfabete në përdorim.

---

[175] Jezik in slovstvo, viti XXIII nr 3-4 Ljubljana, december-januar 1977/78, fq 70.

[176] Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju, Beograd 1924

[177] shih fusnotën 16.

Nachtigali na njofton se në të tri versioneve A, B dhe C të përkthimit, por edhe në atë të botuar, autorët janë të njëjtë, por emri i tyre shënohet me grafikë të ndryshme që është në përdorim në atë kohë: grek, gjerman dhe latin. Duket se versioni A është ai fillestari i drejtpërdrejtë i vëllezërve Çelo, me titullin e shkruar ***Lŭkeit kríje I5 (Luka, kreu XV)***, e pastaj vijon shkrimi me shenja të përziera greke, gjermane dhe latine. Versionet B dhe C janë përshkrime me shkronja cirilike, të pasuruara me shkronjat e Vukut. Kemi një rrjedhje si vijon A→B→C. Duket se versioni B është përshkruar më me ngut dhe me jo aq shumë kujdes, që nuk është rasti me versionin C. Versioni B është përshkrim i saktë tekstualisht nga A, por grafika është tjetër.

Versioni D, ai i botuari, është për autorin tonë më interesanti dhe debaton me të, shpesh duke mos u pajtuar. Gjen gabime edhe materiale në të, gjë të cilën mund ta bëjë vetëm njohësi i mirë i gjuhës shqipe.

"Botimi i Kopitarit (D) mbështetet në përshkrimin C dhe devijon prej tij, në qoftë se e përjashtojmë grafikën krejtësisht të re, vetëm në disa imtësi të rralla, që kanë të bëjnë me anën tingullore të çështjes. Grafika në D mbështetet në alfabetin latin që për hir të shprehjes së tingujve në shqip është e plotësuar me shenja cirilike..."[178]

Edhe pse versioni i botimit të Kopitarit është përshkrim i përpiktë i versioneve B-C, *"nuk mund ta marrim si botim të saktë dhe kritik të përkthimit të tregimit mbi djalin e humbur sipas vëllezërve Tsel'o"*[179] Ky fakt, si dhe pandjeshmëria gjuhësore dhe mosnjohja e detajeve të gjuhës shqipe e versioneve B-C, e bën problematike çështjen e përshkrimit cirilik, shprehet Nachtigali.

Nachtigali mundohet që në çdo mënyrë ta identifikojë dorën që e ka bërë përshkrimin B dhe C dhe pas mjaft argumentimesh del me konstatimin se përshkrimi nuk është vepër e vëllezërve Çelo dhe as e Kopitarit, por sipas të gjitha gjasave e Bojaxhiut.

[178] Luka XV –11, në përkthimin tim
[179] Ibidem

E se nuk kemi të bëjmë me një material të panjohur për shqiptarët na përkujton edhe Nchtigali, kur i shënon të gjitha përkthimet e njohura deri më atëherë të të njëjtit tregim – birit të humbur. G. Meyeri në gramatikën e vet e boton paralelisht përkthimin gegë dhe toskë të Kristoforidhit, e po aty e shton edhe përkthimin në dialektin e Kalabrisë. Weigandi jep përkthimin në elbasanishte, por jo të Kristoforishit, Kopitari i përmend edhe dy versione tjera, ndërsa më 1829 Kopitari na njofton për botimin e plotë të librit të ri të shenjtë në Korfuz.[180]

Përmbyllje

Bindja ime e fituar kohë më parë se ndër ne nuk është i njohur, e me këtë as i vlerësuar sa duhet kontributi i gjuhëtarëve sllovenë, u përforcua edhe më shumë me rastin e përkthimit të dy studimeve të prof. dr. Rajko Nachtigalit për nevoja të dy akademive të shkencave (të Kosovës dhe të Sllovenisë). Për fatin e mirë timin, me këto informata isha njoftuar para më se tri dekadash, kur isha student në Universitetin e Lublanës. Atëbotë edhe i bëra publike disa shkrime të mijat lidhur me angazhimin e gjuhëtarëve sllovenë dhe kontributin e tyre në lëmin e albanologjisë. Një tekst i botuar në revistën e kohës *Naši razgledi* me titullin *"Nachtigal je vedel, Miklošič tudi, pa mi?"* (Nachtigali e dinte, Miklloshiçi gjithashtu, e ne? –gjuhën shqipe, kuptohet!!!) bëri bujë mjaft të madhe ndër intelektualët sllovenë, sa që redaksia e Enciklopedisë sllovene kërkoi autorizimin e tekstit për botim. Tekstin e rishqyrtova dhe ai u botua në Enciklopedija Slovenije, I[181].

Kam bindjen që e tërë puna ime shumë dekadash në lëmin e përkthimeve, para së gjithash letrare, nga gjuha sllovene dhe anasjelltas, është një kthim borxhi dhe një shenjë miradije për ata njerëz të mëdhenj të kombit

---

[180] shih më gjerësisht, Ibidem

[181] N. (*Nikollë)* B. *(Berishaj)* Albansko – slovenski odnosi, në Enciklopedija 1 / A-Ca, Lublanë 1987, fq. 39 - 41

slloven, që ndihmuan vendosjen e themeleve të albanologjisë.[182] I tillë – por jo i vetmi – padyshim është prof. dr. Rajko Nachtigal, që miqësinë e vet me një shqiptar – me prof. dr. Gjergj Pekmezin, diplomatin dhe linguistin shqiptar, kryetarin e parë të Komisisë Letrare të Shkodrës – diti ta valorizojë dhe t'ia vënë në shërbim njohuritë e veta shkencore gjuhës dhe kombit të mikut. Sikur të ishin marrë më shumë parasysh ato njohuri dhe propozime, sot do ta kishim një gjuhë letrare jo si imponim politik, por si rrjedhë e natyrshme e njësimit, siç e kanë shumë gjuhë tjera bashkëkohore.

[182] por edhe për të gjithë intelektualët sllovenë të kohës së re në ish Jugosllavinë, që i kishim krah të djathtë dhe bënë çmos për njophjen e të vërtetës për çështjen e Kosovës në vitet 80-90 të shekullit të kaluar

GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU, BREZI KONVERTUES DHE MATEMATIKA

dr. Martin BERISHAJ,

Evidencën e debatit rreth trillimeve qe shpalohen ne përditshmërinë "shkencore" nder shqiptarë se Gjergj Kastrioti Skënderbeu kishte vrarë shqiptare te besimit islam do e përmbledhsha ne diskursin jo konvencional dhe do e filloj me "futjen në gërhanë" të familjes tradicionale shqiptare.

Familja tradicionale shqiptare bazohej ne rriten e saj brenda strukturës individuale. Si rregull, djali ne familje martohej ne moshën 17 deri 19 vjeçare e qe reflektonte brezin brenda familjes. Prandaj, nëse e bëjmë një parallogaritje shume te thjeshte do të shohim se, i porsamartuari kishte moshë 17-19 vjeçare, fëmija i pare lindte pas një ose dy vitesh. Pra, kur i ati i mbushte 20 vjet. Për hirë të tolerancës shkencore kësaj moshe do ja shtojmë edhe pesë vite duke e rritur pragun në moshën 25 vjeçar si brez ne familje!

Po që se e shpalojmë familjen tradicionale nder shqiptare do vërejmë se çdo familje shqiptare e "prekë" brezin konvertues ne fenë islame diku ne mes brezit te dhjetë apo dymbëdhjetë (10-12). Por, për hir te tolerancës do e shtojmë në brezin e pesëmbëdhjetë (15). Si rrjedhojë, nëse e shumëzojmë brezin familjarë (pra shqiptarin qe është bere për herë të parë babë 25X15= del se janë 375 vjet deri ne pike palosjen konvertuese islame nder ne.

Dhe nëse vazhdojmë me para llogaritjen e radhës (sot është viti 2018) pra, prej vitit 2018 zbresim 375 vite (pra vitin e pikë palosjes konvertuese del se ajo ka ndodhe ne vitin 1643. Viti 1643 pra është vit i fillimit kolektiv te konvertimit nder shqiptare! Tani do vazhdojmë me logjiken matematikore si vijon:

Gjergj Kastrioti Skënderbeu ka vdekur ne vitin 1468 ! pastaj nga ky vit zbresim 1643-1468 = 175 vjet

175 vite pas vdekjes se Gjergj Kastriotit Skënderbeut ka ndodhe fenomeni i islamizimit nder ne si shoqëri. Nga kjo del se trillimet rreth "kundër

islamizmit shqiptare" është fundë e krye i pa bazë dhe si rrjedhojë Gjergj Kastrioti Skenderbeu ishte e pamundur te vriste shqiptare te besimit islam!

Është më se e qartë se për njeriun e sotëm me mentalitet të laicizuar sintagma e përmendur vështirë mund të kuptohet. Madje edhe për shumicën është edhe e papranueshme. Mirëpo, për papët e asaj kohe një Gjergj Kastrioti ishte person në të cilin pa kurrë far hamendje kanë mundur të mbështeten. Për këtë ka qenë i vetëdijshëm edhe vetë Skënderbeu siç mund të kuptohet nga letra e tij, dërguar më 31.10.1460 Gjon Anton Orsinit, në të cilën shprehimisht thotë: "sikur të isha shkelur unë me siguri se këtë do ta kishte ndier e para Italia". S'do mend se një shprehje e tillë e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut nuk ishte vetëm një gjest diplomatik i diktuar nga vija e parë luftarake - ballë për ballë me armikun. Kjo ishte, në të vërtetë, shprehje e besimit të thellë dhe të sinçertë. Për këtë besim e kushtoi edhe tërë jetën e vet, shkathtësinë ushtarake dhe atë diplomatike. Kjo shihet edhe nga fakti se për relacione dhe komunikime diplomatike me pushtet mbajtësit evropian të kohës i zgjedh njerëzit nga strukturat e larta kishtare, siç ishin prifti dhe humanisti Gjon Gazulli, abati dhe protonotari apostolik Gjergj Pelinji, Pal Engjëll-Dushi arqipeshkëv i Krujës, Pal Engjëlli, arqipeshkëv i Durrësit. Tek e fundit edhe vetë papët ishin të vetëdijshëm për bindshmërinë e tij të thellë ndaj kristianitetit europian dhe ndaj besimit të krishterë. Për këtë gjë flasin qartë dokumentet e papëve të Romës, që kanë të bëjnë me Skënderbeun. Atë papët e quajnë Athleta Christi (ushtar i krishtit), defensor fidei (mbrojtës i fesë) etj.. Pikërisht këto emërtime, qartë dëshmojnë se bindja e tij kristiane nuk ishte e karakterit formal. Si të kuptohen ndryshe fjalët e papës Kalistit III kur thotë: "Nuk është e nevojshme të ma rekomandoni sepse unë me të jam ngushtë i lidhur shpirtërisht". Skënderbeu, në të vërtetë, në momentin më kritik për kristianitetin europian bëhet dhe mbetet i vetmi aleat i papëve të cilët me mish e me shpirt kanë vepruar për shpëtimin e kësaj Europë. Për këtë na dëshmojnë dokumentet e papëve që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Skënderbeut. Nga ato qartë shihet se Skënderbeun nuk e kanë quajtur kot me titujt e përmendur, por edhe e kanë ndihmuar, përveç financiarisht edhe në mënyra të ndryshme. Kështu papa Kalisti III përveç ndihmës financiare e dërgon Giovani Navaron, njërin prej

këshilltarëve të vetë më të njohur ushtarak me qëllim të përpilimit të planeve strategjike ushtarake për luftë kundër turqve. Më vonë e dërgon edhe nipin e vetë, Michele Borgian me një flotilë e cila, për fat të keq, nuk arriti në cak. Ky papë ishte i vetëdijshëm për meritat e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, për gjithçka që bëri në ruajtjen e krishtenitetit europian përkundër premtimeve boshe të sovranëve të tjerë laikë. Këtë e vërteton edhe me fjalët : "Meritat e tij janë më të mëdha se të të gjithë princërve të tjerë të krishterë".

Pasardhësi i Kalistit III, i njohuri Enio Silvio Picolomini, i njohur si papa Piu II (14641473), diplomat i njohur, ishte i tëri i përshkuar me shpirtin e zjarrit të kryqatorëve. Me këtë qëllim e organizoi një kongres paneuropian. Por, përveç fjalëve boshe, në këtë kongres nuk është marrë asnjë vendim i prerë. Pasi morri vesh se Bosnja kishte ra nën pushtetin turk më 1463 vendosi të ndërmerr edhe një akcion luftarak duke besuar se edhe pushtetmbajtësit laikë do ta ndjekin pas. Përveç venedikasve të cilët ia dërguan një flotilë, papa Piu II në muajin qershor të vitit 1464 niset për në Shqipëri me qëllim që ta kurorzojë mbret Skënderbeun. Sepse për të Skënderbeu ishte: "Christi propugnator acerrimus" (Mbrojtësi më i ashpër i Krishtit). Mirëpo, në udhëtim e sipër, në Anconë , më 15 gusht të vitit 1464, papritmas vdes.

Nga e gjithë kjo që u tha më sipër shihet qartë se, Europa si e tillë, duke iu falënderuar përçarjeve, intrigave të ndërsjellta të sundimtarëve, pastaj ambicieve personale, nuk ishte në gjendje që në mënyrë serioze dhe efektive të mbrohet nga rreziku osmano-turk. E vetmja fuqi kohezive që ka mundur ta bashkojë Europën ishte Kisha katolike dhe papati. Dhe jo vetëm kaq. Papët ishin organizatorë kryesorë të koalicionit antiturk në mbrojtjen e kristianitetit të Europës së përçarë. Prandaj për osmano-turqtë, të krishterët katolikë ishin armiq të shenjuar. Sepse i takonin papatit.

Venediku dhe Napoli për dallim nga papët, ndihmën ia kushtëzonin Skënderbeut. Ndërkaq edhe kjo ndihmë ishte më tepër në fjalë se në vepra. Megjithatë, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu plot 25 vjet qëndroi në ballë të betejës kundër osmano-turqve dhe siç thotë Fan Noli " e shpëtoi Romën dhe Europën nga katastrofa e tmerrshme që u kanosej nga invadimi turk, që do të kishte qenë rrënimi i plotë i jetës ekonomike dhe qytetërimit europian. Pjesa që i takon Skenderbeut në këtë shërbim jashtëzakonisht të rëndësishëm

është zor të çmohet më tepër nga ç'duhet". Kështu e përfundon Noli veprën e tij mbi Skënderbeun. Dhe me vdekjen e Skënderbeut, më 17 janar të vitit 1468 Europa do të humbë mbrojtësin e vetë më të rëndësishëm.

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu mbrojtës i qytetërimit evropian

Milan Sufflay-i, albanologu i shquar kroat dhe njëherë edhe themeluesi i historiografisë mesjetare shqiptare, duke vlerësuar lart personalitetin e Gjergj Kastriotit- Skënderbeut, ndër të tjera thotë: "Nën udhëheqjen e Skënderbeut e tërë bujaria shqiptare u bashkua tok në luftë kundër turqve. U krijua shteti i parë shqiptar, pas rënies së Konstantinopolit, Serbisë dhe Bosnjes, shteti i fundit i madh kristian në Ballkan". Ndërsa, historiani më i madh kroat i gjysmës së parë të shekullit XX, Ferdo Šišić, në një punim që ka mbetur në dorëshkrim dhe i cili ruhet në Arkivin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve në Zagreb, me titull "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe koha e tij", shkruan që në fillim: "Ç'është në mesin e poetëve Shekspiri, ç'është në mesin e oratorëve Çarls Xhejms Foksi (1749-1806), burrë shteti dhe orator britanik, ç'është në mesin e udhëheqësve ushtarak Napoleoni, Skënderbeu në mesin e trimave është trim i vërtetë"- dhe vazhdon "përderisa kalorësit europian frigoheshin nga fytyrat e mërdhezura jeniçere, Skënderbeu me dorën e djathtë të vetën ka pre deri dymijë turq dhe derisa mbretërit dhe perandorët që sulmoheshin nga sulltanët, të dëshpëruar dhe të frikësuar kërkonin ndihmë nëpër tërë botën kristiane, Skënderbeu trim me një grusht shqiptar trima luftoi kundër ushtrisë tejet të madhe të armikut dhe korri fitore".

Për ta shpjeguar deri ne kuptueshmëri dua te vazhdoj me mendime dhe konstatime të dy shkencëtarëve të mëdhenj kroatë jo për tjetër, por se vetëm të tregoj dhe dëshmoj se madhëria e Skënderbeut nuk qëndron vetëm në atë se ka qenë burim frymëzues dhe shembëlltyrë e burrërisë së popullit shqiptar, por edhe i gjithë atyre popujve që lëngonin nën zgjedhën osmano-turke të cilët luftonin për çlirimin shpirtëroro-kombëtar nga nënshtrimi aziatik. Skënderbeu në të vërtetë, jo vetëm në kohën e tij, por edhe pas vdekjes ka qenë krenaria e popujve të lirë dhe ua ka zgjatur jetën të gjithë atyre të cilët në rrugët e gjata historike i drejtoheshin trashëgimisë së gjeniut të tij. Pikërisht në dritën e këtij fakti duhet kuptuar dhe mund të kuptohet

krijimi i panumërt i veprave shkencore historike, të studimeve, romaneve, dramave, operave dhe epikës popullore.
Ndonëse nuk kam ndërmend që të ndalem në paraqitjen e fitoreve të tija të shkëlqyeshme të cilat i korri në luftë kundër ushtrive osmano-turke, megjithatë mendoj se nuk është e tepërt po qe se theksohet roli i tij i pakontestueshëm dhe i paharruar në mbrojtjen e qytetërimit europian të kohës së tij, konkretisht të shekullit XV.
Për ta kuptuar më mirë këtë rol dhe për ta shiquar sa më saktë, është më se e nevojshme që personaliteti i Skënderbeut të trajtohet në kuadër të kohës kur ka vepruar, të ambientit shpirtëroro- kulturor të Shqipërisë së asaj kohe dhe të rregullimit shpirtëroro-politik të Europës së kohës së tij.

çfarë ishte ambienti shpirtëroro-kulturor e politik i Shqipërisë në kohën e Skënderbeut?

Shqipëria, atdheu i Gjergj Kastriotit- Skënderbeut në shekullin XV ka qenë trashëgimtare e fuqive të ndryshme kulturoro-shpirtërore siç janë: latine e bizantine, kurse politikisht nën patronatin e Republikës së Venedikut. Shqipëria e asaj kohe për nga mënyra e jetës së dinastive-
apo shtëpive të mëdha vendase-, madje dhe të qyteteve me statutet e tyre që ishin imitim i atyre italiane, por edhe të qyteteve tjera të Europës Perëndimore, aspak nuk dalloheshin prej atyre europiane. Qytetet bregdetare të Shqipërisë, përveç Vlorës, i takonin kulturës dhe qytetërimit latin.
Mirëpo, në ndërkohë, përkundrejt mbështetjes venedikase, për dallim nga strukturat e qyteteve, dinastitë e moçme në sferën politike ishin në rënie e sipër. Arsyen për këtë duhet kërkuar në faktin se këto dinasti, e posaçërisht ato me origjinë bizantine, ishin të luhatshme në konfliktin në mes Romës dhe Stambollit. Një luhatje e tillë u shpreh edhe në paaftësinë e tyre që t'u kundërvihen sulmeve ushtarake osmano-turke; kurse Europa dridhej nga frika dhe rreziku që po i kanosej. Kjo frikë u bë edhe më e madhe kur Stambolli-Konstantinopoli-Roma e dytë dhe qendra e Perandorisë lindore romake, por edhe e krishtenizmit të ritit oriental, të premten më 29.05.1453, ra në duart e osmanlinjëve. Kjo katastrofë jehoi tmerrshëm në tërë botën e atëherëshme kristiane dhe shkaktoi përçarje në mesin e tyre.

Bizantinët i akuzuan latinët sepse më tepër merreshin me problemin e dy kishave simotra - asaj Romake dhe Ortodokse, kurse latinët i akuzonin bizantinët për shkak të dyftyrësisë së tyre ndaj perëndimorëve sepse më parë ishin të gatshëm t'i nënshtroheshin turbanit sulltan se sa të pranonin bashkimin e kishave dhe primatin e papës.

Që të jem më i qartë, duhet të ndalem pak në këtë problem.Këtu kemi të bëjmë me Koncilin Kishtar që mbahej në Firencë që nga viti 1438 deri më 1442. Në këtë koncil morrën pjesë si prelatët e lartë të Kishës së Lindjes apo ortodokse, ashtu edhe ata të Kishës së Romës. Njëra prej konkluzave të këtij koncili ishte edhe bashkimi kishtar, gjegjësisht uniatizmi. Lidhur me këtë klauzulë u vendos që të organizohet ndihma Bizantit që të ndalen sulmet e ushtrisë osmano-turke. Mirëpo, duke iu falënderuar popullit, klerit të ulët e sidomos të murgjve të Malit Atos, vendimet e sjellura në këtë Koncil mbetën vetëm shkronja mbi letër. Tek e fundit, edhe vetë patriku i Konstantinopojës, Genadiu, në mënyrë të hapur ishte në lidhje të ngushtë me udhëheqësit e rrezistencës kundër bashkimit me Kishën e Romës. Njëri prej udhëheqësve të rrezistencës me të cilin ishte ngusht i lidhur edhe patriku Genadiu, ishte duka i madh Lukë Notari, admiral i njohur i flotës bizantine dhe kryekomandant i ushtrisë bizantine. Është interesant se pikërisht ky komandant në vigjilen e rënies së Konstantinopojës i i pat thënë fjalët e njohura: më mirë vlen turbani i sullatnit se tiara e papës. Dëshira e tij u realizua: Haia Sofia-Kisha e Madhe në Stamboll u shndërrua në Xhami dhe nga maja e kupolës së madhe u hoq kryqi dhe u vendos gjysmëhëna.

Shqipëria e asaj kohe në pjesën veriore i takonte arealit kulturoro-shpirtëror latin, kurse në jug, atij greko-bizantin. Mirëpo, për nga aspekti kishtar e tëra i takonte Romës. Fundja duhet theksuar se Kisha e krishterë ndër shqiptarë, si ajo e ritit latin ashtu edhe ajo e ritit greko-bizantin, përherë është mbajtur anash konflikteve që zhvilloheshin në mes Romës dhe Konstantinopojës. Përkundrejt disa luhatjeve të përkohshme, i tërë kleri i të dy riteve i ka mbetur besnik Kishës së Romës.

Njësoj është situata edhe me dinastitë dhe strukturat tjera laike shqiptare. Sadoqë disa dinasti, e sidomos ato që i takonin ritit greko-bizantin, ishin në luhatje e sipër në mes Konstantinopojës dhe Romës, me siguri mund të thuhet se në kohën e Skënderbeut të gjithë ishin në anën e Romës. Ky

konstatim vlen, sidomos, për shtëpinë e Kastriotëve, domeni i së cilës shtrihej që nga Mati e deri në Prizren. Në të vërtetë, kjo shtëpi, me gjenerata të tëra ka qenë e lidhur me ipeshkvijtë latin, gjegjësisht, të ritit romak dhe atë jo vetëm në shek. XIV dhe XV, por edhe më parë. Por, nga ana tjetër, duhet theksuar se në Shqipërinë e shekullit XV, pra në kohën e Skënderbeut, asnjëri nuk është ndier as grek e as latin, por kristian perëndimor. Këtë më së miri e ka shprehur Fan Noli në librin e tij mbi Skënderbeun, i cili është edhe doktorati i tij, kur thotë: "Katholikizma nga njëra anë - i jipte Shqipërisë bashkimin që i mungonte si shtet, edhe nga ana tjetër, e lidhte me botën e krishterë europiane", gjegjësisht, "Katholikizma", vazhdon Noli, "në Shqipëri ishte "si një protestë kundër zotërimit bizantin dhe serp". Ja, pra, në këtë rrezatim shpirtëror e kulturor madje edhe politik, lindi Gjergj Kastrioti- Skënderbeu.

Data e saktë se kur është lindur ende nuk është dëshmuar. Mendohet sa ka lindur më 1405. I ati i tij, Gjoni, i mundur nga turqit qe i detyruar që birin e tij Gjergjin, së bashku me vëllezërit e tjerë t'ia jep peng sulltan Muratit II. Falë natyrës së zgjuar Gjergji shpejt përparon dhe bën një karierë magjepëse ushtarake. Mbi rininë e tij deri në kthimin e tij në Shqipëri shumë pak dihet. Dihet vetëm se në nëntor të vitit 1443, pas fitores mbi Turqit në betejën e Nishit, me dinakëri kthehet në Krujë ku e shpallë pavarësinë e vet nga sullatni dhe publikisht deklarohet si i krishterë. Më 1444, në Lezhë e konvokon Kuvendin në të cilin marrin pjesë të gjithë krerët e Shqipërisë, dhe e themelon Lidhjen e parë Shqiptare, të njohur si Lidhja e Lezhës, qëllimi i së cilës ishte lufta e përbashkët kundër turqve. Në këtë Kuvend Skënderbeu njëzërit zgjedhet për kryekomandant të ushtrisë shqipatre që përbëhej nga njësi të ndryshme të dinastëve shqiptarë. Që nga viti 1444 e deri më 17 janar 1468, kur vdes në Lezhë nga ethet, pasi kungohet, dhe varroset në kishën e Shën Kollit në Lezhë, të cilën turqit e kthejnë në xhami, kurse, siç thotë Marin Barleti, prej eshtrave të tij turqit bëjnë hajmali për ushtarët e tyre, Skënderbeu i zhvillon 22 beteja ngadhënjyese. Ka luftuar kundër dy sulltanëve më të fuqishëm të asaj kohe- kundër sulltan Muratit II dhe sulltan Mehmet- pushtuesit.

Pas la djalin e vogël Gjonin dhe bashkëshorten Donikën. Nënë e djalë u strehuan në Napol te Ferdinandi Aragonas, i biri i Alfonsit. Me ta së bashku,

për shak të terrorit që e bënin turqit dhe për ta ruajtur etnoidentitetin e vet kulturor e fetar, fillon egzodi apo braktisja e vendlindjes së shqiptarëve, të cilët u strehuan në Jug të Italisë dhe në Sicili si dhe në vendet tjera evropiane kristiane.

Papa Kalisti III (1455-1458), me origjinë spanjolle, në letrën dërguar Skënderbeut më 11 shator 1457 ndër të tjera shkruan: "Nuk ka njeri që i ka të njohura veprat e tua e që nuk i ngritë në qiell me lavdatat më të larta dhe të mos flet për trimërinë tënde si për një ushtar të vërtetë, për një mbrojtës të emrit të krishterë". I njëjti papë në një letër tjetër të vitit 1458, ndër të tjera thotë:" Me të vërtetë shohim se ai është pothuajse i vetmi i cili i është kundërvyer invadimit të egër turk, e nuk ka lejuar afrimin e tyre (Europës)".

Nga këto konstatime shihet qartë se si njihet dhe dëshmohet roli i Gjergj Kastriotit në mbrojtjen e qytetërimit europian kristian.

Kuptohet se për ata të cilët, duke iu falënderuar ligështisë së paraardhësve të tyre, e braktisin fenë e krishterë dhe me këtë kuptohet edhe identitetin shpirtëror kristian, një konstatim i lartëpërmendur vështirë kuptohet, madje edhe vështirë pranohet. Për ata Skënderbeu edhe në kohën e botës shpirtërore bipolare kur popujt luftonin në emër të krishtenizmit dhe islamizmit, është hero kombëtar. Megjithatë duhet thënë të vërtetën. Skënderbeu në atë kohë ka luftuar në emër të kristianizmit dhe për krishtenizëm, në mbrojtjen e qytetërimit kristian europian i cili rrezikohej gjithnjë e më tepër nga sulmet aziatike, osmano-turke. Se është kështu e thotë edhe vetë Skënderbeu me rastin e drejtimit të tij pushtetmbajtësve perëndimor për ndihmë.

Hero kombëtar Skënderbeu do të bëhet në kohën e Rilindjes kombëtare, në shekullin e XIX. Por lidhur me këtë çështje do të flas pak më vonë.

Për ta kuptuar më mirë rolin e tij në mbrojtjen e kristianitetit europian duhet pasur parasysh ç' është kuptuar me nocionin Europë në shekullin XV. Shikuar politikisht, Europa e shek. XV është dhe nuk është Europë. Para shek. XV emri Europë ka qenë vetëm një nocion gjeografik. Ndërkaq në antikë, kur ajo paraqiste vetëm një krahinë të vogël në pjesën "europiane" të ngushticës së detit të Stambollit, idea e tërësisë së saj kontinentale, politikisht paraqitej në suazat e Perandorisë Romake, kurse në aspektin kulturor, në traditën greko-romake. Kurse në mesjetë kjo tërësi kuptohej dhe

shprehej si kristianitet - latinisht christianitas, gjegjësisht bashkësia politike kristiane. Mirëpo, me shfaqjen e humanizmit si drejtim letraro-filozofik, fillon ringjallja e gjuhëve kombëtare dhe me këtë edhe theksimi i veçantive kombëtare me kërkesë të të drejtave vetanake. Me një fjalë Europa e shek. XIV dhe XV politikisht ishte e përçarë me lëvizje populliste, të përshkuara me mësime fetare sektashe dhe heretike siç ishin galikanizmi në Francë, germanizmi antiromak në Gjermani, pastaj huzitizmi në Çeki. Kurse në planin politik kjo Europë ishte e ngarkuar me kundërthënie në mes shteteve dhe luftës civile. Kuptohet se një Europë e tillë, e përçarë, nuk ishte në gjendje t'i kundërvihej fuqisë aziatike e cila tashmë ishte, si të thuash, para dyerve të Europës. Uniteti politik i Europës ishte vetëm ideal apo më mirë të thuhet, ishte vetëm një ëndërr. Së këndejmi në gjirin e Kishës perëndimore apo latine shpërtheu plasaritja dhe përçarja. Kuptohet, Kisha katolike ishte e vetmja fuqi e cila ishte në gjendje të merrte rolin udhëheqës në organizimin e mbrojtjes së qytetërimit kristian kundër furisë destruktive bartëse e së cilës ishte ushtria osmanoturke. Pikërisht në këtë kontekst dhe në këtë frymë duhet kuptuar sintagmën "Perëndimi kristian" gjegjësisht "Europa kristiane".

Me rënien e Shkodrës më 1479 dhe me dorëzimin e Durrësit nga ana e Venedikasve turqve, me një marrëveshje paqësore të 25 prillit të vitit 1479, Shqipëria praktikisht, ekonomikisht dhe shpirtërisht bëhet pjesë përbërëse e Perandorisë Osmane. Që nga kjo kohë në dokumentet historike quhet Albania Turcica (Shqipëria Turke). Me kalimin në islamizëm, pa marrë parasysh me vullnet apo me dhunë, jo vetëm të strukturave të pasura nëpër qendrat urbane, por edhe të atyre fshatare, fillon për fat të keq, shndërrimi i identitetit shpirtëror të shqiptarëve në dëm të atij europian. Pastaj "me islamizimin masiv", siç thotë profesor Aleks Buda, "që përfshinë pothuaj dy të tretat e popullit shqiptar, u krijua një faktor ndryshueshmërie, që pati pasoja fatkeqe për Ballkanin dhe veçanërisht për Shqipërinë, sepse krijoi një varg elementesh grindjeje në gjirin e familjes së popujve ballkanikë dhe në gjirin e popullit shqiptar". Me qëllim të ruajtjes së identitetit etnokulturor dhe shpirtëror, por edhe nga dhuna e paskrupullt turke mbi popullatën e krishterë, fillon egzodusi apo largimi i popullatës shqiptare të krishterë nga Shqipëria. Kuptohet se kjo popullatë, përveç dokeve e zakoneve, me vete e

merr edhe kujtesën mbi Gjergj Kastriotin- Skënderbeun. Duke e shfrytëzuar emrin e Skënderbeut, Jeronim de Rada (1814-1903), poeti i madh italo-arbëresh, e vën në pah çështjen e popullit shqiptar para pushtetmbajtësve europian, duke kërkuar prej kësaj Europe, për lirinë e së cilës pat luftuar Skënderbeu, që ta heqë velin e heshtjes dhe të ndërmerr në mënyrë konkrete akcione për kauzën shqiptare dhe për çlirimin e popullit shqiptar nga zgjedha turke. Emri i Gjergj Kastriotit- Skënderbeut në kohën e Rilindjes kombëtare, për shqiptarët u bë fuqi mobilizuese në luftë kundër turqve. Përveç Jeronim de Radës në nxitjen e ndërgjegjes kombëtare lidhur me emrin e Skënderbeut, rol të rëndësishëm ka luajtur edhe Naim Frashëri (1846-1900), që i takonte rendit të bektashinjëve. Ky shkruan veprën "Istori e Skenderbeut". Për ta kuptuar këtë sa më mirë duhet të kuptojmë rrethanat e shek. XIX. Ishte ky shekull i romantizmit, por edhe i lëvizjeve çlirimtare të popujve të Ballkanit. Të krishterët e Ballkanit në luftë kundër turqve, për çlirimin kombëtar, shkonin me klithjen : "Për kryqin e ndershëm dhe lirinë e artë". Ismail Kadareja : "Turqizimi i qindra mijëra shqiptarëve, greqizimi i një pjese tjetër, ngatërrrimi i përkatësisë shqiptare me atë fetare, dëshmonte se ndjenja patriotike e një pjese të shqiptarëve ka qenë jo aq e fortë siç paraqitej". Prandaj rilindasit për ta zgjuar ndjenjën kombëtare ndër gjithë shqiptarët, pra edhe të atyre të besimit musliman, mbështeteshin në personalitetin e Gjergj Kastriotit- Skënderbeut, duke krijuar prej tij një shembëlltyrë mitike. Duhet cekur se në krijimin e këtij miti kombëtar në luftë kundër turqve ka kontribuar Naim Frashëri i cili konsideronte se bektashizmi duhet të jetë besimi i përbashkët i të gjithë shqiptarëve, pasiqë ai bazohet si në Bibël ashtu edhe në Kuran. Në këtë frymë duhet kuptuar edhe nocioni "hero kombëtar" lidhur me Skënderbeun.

Recensione

RECENSION, "Undo the ethnic border", Toena 2017

Prof. dr. Ernest PETRIČ

... In most contemporary Europe the problematique of state borders has lost its relevance after Helsinki Final Act (1975) and after The Fall of Berlin Wall. But definitely not so in the Balkans. In this South Eastern part of Europe persist several disputed "open" border problems among new states established after break-up of Yugoslavia in 1991 and after following "secessions" (Montenegro and Kosovo). These border problems are acute and even a potential threat to security in this "barrel of powder" (Balkan). There are also several other border problems as a consequence of imposed border lines in this region in particular after the Balkan wars (1912, 1913) and World War I. The fact that large parts of Albanians were left outside their national (ethnic) state Albania, namely in Greece and in Kingdom of Serbs, Croats and Slovenes, now in Serbia, Kosovo, Macedonia and in Montenegro, makes the problem of Albanian borders and the study and research of it particularly acute.

The state borders and "border problems" are nowadays far from being perceived and consequently studied only as problems of delimitations of state sovereignty and territorial claims. The borders and border problems have historical, international legal, sociological and even psychological and cultural dimensions and connotations. They often are a historical myth more than a claim based on solid real grounds. While in most of Europe the borders have lost their divisive character and are disappearing as divisive lines in the Balkans the concept of borders still possesses its divisive dimension and preserving its disruptive character for peace.

By what has been said it seems there should be no doubt that the study of the problems of the state borders is still acute and useful, in the Balkans in particular. Study of border problems as it has been proven many times in the past, may contribute to resolution of border problems and consequently to the peace. But it can also lead to escalation of a certain border problem. However, this is definitely not the case of the book of Dr. Martin Berishaj "Undo the ethnic border". His modern multidisciplinary approach and his

understanding of the state borders in the European context which is pursued in his study and which in fact means the endeavor to eliminate, "to undo" the borders also in the consciousness of people concerned is a significant scientific contribution to the prospects of peace among peoples in the Balkans. Dr. Berishaj's book in its broad concept encompasses several relevant dimensions, both while discussing the topic of borders on the general level and while discussing the problem of "Albanian" borders. History, ethnic aspects, political science and international relations, culturology, international legal aspects including the right to self-determination of peoples, problems of nationalism and its misuses are dealt with in a competent and balanced way. Although the focus is somehow on the borders of Albania and of the "national problem (question) of Albanians", a divided nation, the book is in no way written as a "claim" but as an objective study of contemporary border problematique, in particularly in the case of Albanian borders. This, the objectivity and scientific neutrality is besides the broad and multidisciplinary approach, the book's main quality. It is a significant contribution for understanding of the problems of state borders in general and of understanding of the "Albanian problem" in particular.

Recensioni i 2. për librin e autorit Prof. dr. Martin Berishaj

Prof. Dr. Frashër DEMAJ
Anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës
Rektor i kolegjit FAMA në Prishtinë

Studimi i fenomeneve të ndryshme shoqërore, politike, diplomatike, gjeopolitike, gjeostrategjike nga perspektiva shumë dimensionale janë sa të rëndësishme po aq edhe bashkëkohore. Qasja multiperspektive e studimeve shoqërore dhe humane hyn në kuadrin e studimeve të gjithmbarshme në të cilat gjejmë informacione nga më të ndryshmet nga fusha të rëndësishme të shkencave të cilat kanë korelacion ndërmjet tyre. Ato pasurojnë dhe plotësojnë njëra tjetrën në strukturim, fenomene, përmbajtje, qasje e metoda si: historike, kualitative, empirike, logjike, krahasuese, statistikore etj., duke bërë tërësinë e një studimi të gjithmbarshëm e kuptimplotë. Të gjitha së bashku ia ka arritur ti trajtoj në thellësi dhe gjerësi deri në detaje politologu Prof. dr. Martin Berishaj në studimin e tij "Zhbërja e kufirit etnik".

Libri ka 343 fq të ndara në tetë kapituj, faksimile të dokumenteve dhe në fund indeksin e emrave dhe literaturen.

Autori Berishaj në nisje të studimit fokusohet në trajtimin e kufijve nga këndveshtrimi historik duke u bërë ndër të rrallët studiues që hap shtigje të reja në studimet kufitare shqiptare duke e pasuruar edhe me dimensione të reja dhe duke bërë krahasime të natyrave të ndryshme. Ai jep shembuj konkret edhe për vendosjen e kufijve siq është kufiri që ndan territoret shqiptare në zonen e Malësisë së Madhe, për të vazhduar më tej çështjen e vendosjes së kufijëve në periudha të ndryshme historike përfshirë këtu vendosjen e kufijve pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore bazuar në vendimet e marrura në konferencat e paqes.

Sipas profesor Berishaj, kufiri nuk është kategori statike, por është jashtë mase fluid, terren rrëshqitës, kategori e ndryshueshmërisë mbi të cilin dhe për të cilin parreshtur negociohet siç e definojnë diskurset shtetformuese. Proceset e shënimit dhe konstruktimit të kufijve janë ato që

prodhojnë ndjenjat nacionale, identitetin, dallimin në mes tyre e që njikohësisht u japin frymë proceseve. Sipas autorit të studimit "Zhbërja e kufirit etnik", në hapsirën etnike shqiptare janë tri grupe diskursesh që kanë rol të rëndësishëm:

a) Historik
b) Institucional politik
c) Tekstual

Secilën prej tyre, profesor Berishaj e detajizon, madje duke i krahasuar me teza të studiuesve eminent botëror që merren me studimin e "bërjeve dhe zhbërjeve" të kufijve etnik e shtetëror.

Në kapitullin e parë dhe të dytë në fillim të analizës dhe vlerësimit të argumentit shkencor autori e përkufizon diskursin mbi kufijtë dhe rëndësinë e tyre, perdorimin e termeve që përdorin gjeografët politikë: frontier, boundary, border dhe border landscape për të sqaruar pastaj kuptimësinë e secilit prej termave të përdorur.

Ai në vazhdim vëmendje të posaçme i kushton edhe kufirit nacional dhe kundërthënieve shoqërore për të dalur tek etniciteti dhe nacionalizmi si koncept teorik dhe praktik që ndikon fuqishëm në bërjën dhe zhbërjen e kufijve sidomos në zonat e trazuara siç është Gadishulli Ballkanik.

Në kapitullin e tretë ky studim përfshinë: Kufirin si proces komunikues, nacionalizmin si diskurs, përplasjet e diskursit nacional rreth çështjeve kufitare, gurin kufitar si "prajis" i çobanëve, proceset e subjektivizmit nacional, praktikat komunikuese... duke mbyllur këtë kapitull me dilemën Si ta hulumtojmë kufirin në përditshmëri?

Prof. Dr. Martin Berishaj në kapitullin e katërt, vëmendje të veçantë i kushton Krijimit të kufijve Nacional duke nisur që nga "ideja e tokës së shenjtë" për të vazhduar me kufijtë nga tradita hebraike, përcaktimi i normave biblike, pronat dhe kufijtë e bashkësive fetare dhe tendencat e Kishës Ortodokse Serbe për ta copëzuar Kosovën në emër të kufijëve ndarës të eksterritorialitetit

Në kapitullin e pestë trajtohen fenomene të rëndësishme brenda konceptit të territorit dhe territorializmit si përceptim hapsinor. Autori në mënyrë metaforike sqaron "vijën e rërës" dhe kufirin si arrnim-qepje të cilin na e jep edhe në mënyrë figurative në ballinën e këtij studimi.

Në kapitullin e gjashtë autori Berishaj trajton në hollësi konceptin e pushtetit modern dhe sovranitetin e shtetit duke sqaruar se sistemi i sotëm ndërkombëtar mbeshtetet në themelet autoritare të qeverisjes në shtete ekskluzivisht territoriale të ndara në kufij diskretë dhe që pretendojnë pushtet absolut brenda këtyre kufijve. Kuptimi postmodern i kufirit bazohet në vlerësimin e proceseve globalizuese të cilat çojnë në dobësimin e kuptimit të kufirit por jo edhe në shlyerjen e tij. Sovraniteti, sipas profesor Berishaj në shumicën e rasteve e përkufizon shtetin modern qoftë në rrethanat e brendëshme (autoriteti, demokracia, pushteti etj) qoftë në marrëdhëniet e jashtme (pavarësia, shtetësia, vetvendosja etj) dhe si pasojë shtrohet në qender të vemendjes së transformimeve postmoderne. Në këtë kapitull zë vend të rëndësishëm edhe pikëpyetja si mund të sqarohen tendencat diametralisht të kundërta të konceptit të sovranitetit bazuar në teorinë e marrëdhënieve nderkombëtare.

Kapitulli i shtatë fillon me vijëzimin dhe demarkacionin e kufirit për të cilin është hapur debat i gjërë në përmasa nderkombëtare jo vetëm në qarqet politike e shtetërore por edhe tek studiuesit e fushave të ndryshme dhe shoqëria civile. Autori konstaton se demarkacioni i kufirit në terren është çështje ekzakte e kushtëzuar shkencërisht në rend të parë sipas logjikës matematike, gjeografike, që kanë të bëjnë me faktet fizike të terrenit. Përkufizimi fizik në formë juridike i territorit, shpreh faktorë të rëndësishëm për shtetin dhe ekzistencën e tij. Zgjerimi territorial historikisht ka lëvizur nga brezat kufitar e deri te konstruktimi linear i kufirit. Detyra parësore e demarkacionit është që të trensferoj në terren, sa më saktë qe të jetë e mundur, vijen e kufirit ashtu siç është definuar në dokumentin e delimitimit. Delimitimi sipas profesor Berishaj ofron definimin e vijave ndarëse mes sovraniteteve të vendeve fqinjë përmes përshkrimit verbal dhe grafik të vend ndodhjes së kufirit, nganjëherë duke qenë i shoqëruar me ndonjë hartë ose skicë. Ky përcaktim verbal i sanksionuar me marrëveshje apo me ndonjë vendim gjyqësor, arbitrazhi, duhet të zbatohet në terren përmes procesit të demarkacionit.

Për të sqaruar këto fenomene deri në detaje autori merr në trajtim shembuj të ndryshëm duke filluar nga referimi i aktgjykimit të Gjykates Nderkombëtare në Nigeri-Kamerun (2002), rastin e Bashkimit Sovjetik,

raste të ndryshme gjatë procesit të dekolonizimeve në Ameriken Latine, ish Jugosllavisë etj.

Çështje tjetër e rëndësishme që zë vend në këtë studim është edhe çështja e vendosjes së kufijve detar që sipas autorit bëhët sipas metodave të ndryshme të përcaktuara si efektive që bazohen në të drejtën nderkombëtare.

Profesor Berishaj analizon edhe kuptimin e kufijve "natyrorë" dhe "artificialë". Kufiri natyror mbeshtetet në formen natyrore të tokës, siç janë lumenjtë apo vargmalet. Adoptimi i kufirit natyror në praktikë shpesh sjell mospajtueshmëri. Në rast se kufiri natyror nuk është i shënuar në terren, mund të jetë shkak i konflikteve në të ardhmen. Mosmarrëveshje të shumta ndershtetërore të këtij lloji janë zgjidhur në një hark kohor shumë vite pas miratimit të kufirit me verdikt të gjykatës së arbitrazhit. Autori konstaton se është tepër e rëndësishme që në mënyrë precize të përcaktohet vija kufitare me marrëveshje kur dy shtete ndahen me vargmale. Ajo vijë kufitare lidh majat e bjeshkëve apo ndjek kreshtat. Kufiri terhiqet në atë mënyrë që ndan natyrshëm ujrat që derdhen në dy lumenjë të mëdhenj apo në dy dete. Ky lloj kufiri më shumë iu sherben nevojave të banorëve lokal në hapsirën kufitare që ndjek majat dhe kreshtat.

Kufijtë artificialë janë vijëzuar që nga periudha e kolonializmit e këndej. Ky kufi është linjë imagjinare e drejtë gjeometrike që ndjek një meridian apo paralele gjeografike. Pastaj ajo vijë detyrimisht duhet shënuar në terren, veçanërisht nese ajo hapësirë kufitare më vonë popullohet dhe për pasojë krijohen vendbanimet. Të tillë kufijë autori Berishaj permend në Kanada, SHBA, Afrikë etj.

Kapitullin e tetë të titulluar Kufiri Shqipëri-Mbretëria SKS, autori e fillon me punën e Komisionit Nderkombëtar të dalë nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër për të vazhduar me problemin e shënimit të vijës kufitare të Shqipërisë pas Luftës së Parë Botërore. Konferenca e Parisit kishte njohur tërësinë e kufijve të Shqipërisë të përcaktuar nga Konferenca e Ambasadorëve më 1913 dhe kishte formuar një komision nderkombëtar në të cilin bënin pjesë përfaqësues të Shqipërisë, Greqisë dhe Mbretërisë SKS. Ky komision kishte përfunduar punën në janar 1925 dhe me 27 janar të po këtij viti u nënshkrua Protokolli i Firencës. Çështja e kufirit verior vazhdoi, për tu nënshkruar me 26 korrik 1926 po në Firencë. Profesor Berishaj jep

detaje për caktimin e kufijve të Shqipërisë me Mbretërinë SKS duke përfshirë protokollet, marrëveshjet, aneks marrëveshjet dhe të dhëna tjera relevante për përcaktimin e kufirit në mes këtyre dy shteteve.

Në fund autori i studimit "Zhbërja e kufirit etnik", Prof dr. Martin Berishaj na ofron dokumente të ruajtura nga National Archives-Foreign Office në të cilat përfshihen nota, rezoluta, komunikata, protokolle, deklarata, projekte, regjistra, skica, faksimile dhe materiale të tjera që kapin periudhën e viteve 1925-26 ku përfshihen aspekte të ndryshme të detajuara që nderlidhen me procesin e caktimit të kufijve të Shqipërisë bazuar në vendimet e komisionit nderkombëtar të sanksionuar me Protokollin e Firencës.

Pra studimi "Zhbërja e kufirit etnik" mbështetet në burime arkivore të përzgjedhura me kujdes dhe sipas rëndësisë që kanë në trajtimin e një tematike të tillë. Krahas burimeve primare të studimit, autori ka marrë në trajtim edhe literaturën relevante nga autorë të ndryshëm kryesishtë nderkombëtarë.

Brenda këtij studimi gjejmë pasionin për tu thelluar në zbërthimin dhe demistifikimin e konstrukteve politike, shoqërore, ekonomike, diplomatike, gjeopolitike, kufitare si dhe aftësinë për ti trajtuar faktet dhe faktorët e shumtë që kanë pasur ndikim në rrjedhën e ngjarjeve përgjatë gjithë historisë.

Studimi "Zhbërja e kufirit etnik" i autori Prof. Dr. Martin Berishaj i dedikohet një kominiteti të gjerë shoqëror përfshirë këtu studentë, studiues, profesorë, publicistë, intelektualë e posaqërisht politikanë e diplomatë shqiptarë që përfaqësojnë interesat kombëtare e shtetërore të shqiptarëve në vendet e ndryshme të botës.

Profesor Berishaj meriton vëmendjen dhe respektin në rend të parë për kurajon e një studiuesi koshient për vështirësitë e natyrave të ndryshme që shfaqën në trajtimin e çështjeve të ndjeshme dhe shumë të debatuara siq është çështja e kufijve etnik.

Në fund të kësaj fjale dua të shpreh mirënjohjen time të thellë për personalitetin shkencor, akademik, qytetar dhe patriotik të profesorit të respektuar të përmasave nderkombëtare Prof. Dr. Martin Berishaj.

Recensioni i 3. për librin "(Zh)bërja e kufirit etnik", Toena, Tiranë 2017

Prof.dr. Romeo GURAKUQI

Monografia e prof Martin Berishaj, Zhbërja e kufirit etnik, botuar nga shtëpia botuese Toena, Tiranë, këtë vit, është një studim krejt i veçantë në llojin e vet, që synon të depërtojë jo vetëm në historinë e ndarjes së kufirit në mes komunitetit mbarëshqiptar në Gadishullin Ballkanik, por para së gjithash ky studim merret me vlerësimin e fenomeneve politike, kulturore, antropologjike, sociologjike, juridike dhe të ndërgjegjës komunitare, të prejardhur prej këtij procesi të dhimshëm dhe të imponuar historik nga faktorë madhorë, dhe i kryer me dy vijëzime në hartë dhe në terren, më 1913-1914 dhe më 1921-1925.

Kemi të bëjmë me një studim të impostuar qartazi në pikëpamje metodologjike të shkrimit shkencor ndërdisiplinor, dhe mbi të gjitha, impostimi më i rëndësishëm është ai analitik, që vjen për shkak të bazamentit solid të përgatitjes së autorit me filozofinë e historisë, njohjen e thellë të shkencave politike dhe të se drejtës ndërkombëtare. Studimi është i vendosur, sipas meje, mbi një kontrukt teorik, të cilin nuk mund ta bëjë lehtësisht çdo studiues, pa një përgatitje ndërdisiplinore, filozofike, të shkencave politike, historike, juridike, kulturologjike, dhe sociologjike, së paku, të cilën profesori ynë i nderuar, falë përvojës së gjatë akademike dhe të studimeve sistematike, e zotëron në perfeksion.

Monografia e profesor Martin Berishajt është edhe një kritikë e heshtur, në formën e një pasqyre ku mund të ballafaqohen autorët e studimeve pararendëse mbi kufirin, inkluziv edhe autori i këtyre radhëve. Është një model se si mund të shkruhen studime me fokuse të tilla në bashkëkohorë, për të qenë të pranueshëm dhe konkurrencialë në ballafaqimin shkencor ndërkombëtar. Në fakt, në dijeninë time, nga studiuesit pararendës shqiptarë mungon një studim i konceptuar në një formë dhe përmbajtje të tillë. Mbi të gjitha askush deri më sot nuk është marrë me analizën e pasojave të ndarjes kufitare ndër shqiptare, në aspektin formativ, të vetëdijes, të vlerësimit të realiteteve gjegjëse, brenda dhe jashtë kufirit, ndikimit të politikave drejtuese të vendeve ku u detyruan shqiptarët të jetojnë të ndarë, përfshirë edhe

regjimet nën të cilat jetuan shqiptaret e shtetit amë, ose Shqipërisë së Vjetër, le ta quajmë me një term të kohës kur Shqipëria e 1913 dhe ajo e Tokave të Lirueme u bashkuan në një më 1941.

Kufiri kësisoj në këndvështrimin e autorit, bashkëjeton përditë me kombin e ndarë dhe ndërgjegjen e tij, e cila vjen e përshtatet në konstruktin politik, social të vendit ku është atashuar, dikur ish Jugosllavi, sot fatmirësisht në Republikën e Kosovës, Republikën e Malit të Zi, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë etj. Autori ka arritur kështu të kryejë një studim mbi kufirin në disa dimensione, si hartë mendore që mbizotëron në vetëdijen e shqiptarëve varësisht vendit ku kampionet e studiuara ndodhen.

Autori dallon dy linja argumentuese, që kanë formësuar dhe ndërtuar dy monada të ndryshme që interpretojnë të njëjtin realitet, duke përjashtuar njëri tjetrin, ndonëse ruajnë thelbin e përbashkët, gjuhësor, kulturor, letrar, territorial, të ideologjisë dominuese kombëtare etj. Thënë ndryshe, pjesa që ka jetuar brenda Shqipërisë së Vjetër, dhe ajo që ka jetuar në shtetet fqinje, dhe madje edhe vetë brenda shtetet fqinje, varësisht pozicionit gjeografik.

Janë këto, sipas autorit, efektet anësore të skicimit të kufirit në një komb të ndarë. Dhe ai, sipas meje, ka të drejtë. Vetë Hoti, është shembulli konkret i ekzistencës së dy formacioneve të përkohshme konceptuale, që e mendojnë, analizojnë e përshkruajnë, Hotin dhe Malësinë, në forma të ndryshme, këndej kufirit ku gjendemi ne sot dhe matanë kufirit, le të themi në Kushë të Hotit, apo në Rrapshë. Pavarësisht se kemi të bëjmë me konstrukte të përkohshme, të imponuara politikisht nga faktorë jashtëshqiptarë, ata kanë lanë gjurmë ndarëse dhe përjetuese në nën-ndërgjegjen e anëve tona përbërëse. Dhe ky përfundim që ka arritur autori është në fakt produkt i një rezultati që mund ta arrijë vetëm një studiues i vëmendshëm, metodologjikisht i impostuar, me përgatitjen teorike të nevojshme. Studimi, kësisoj, është i çliruar nga komplekset dhe shabllonet amorfe të nacionalizmit primitiv, dhe mund të përshihet në studimet serioze bashkëkohore. Autori ka rritur të kryejë analizën dhe mikrostudimin e konstruktit të identitetit nacional shqiptar në brezin kufitar, duke hyrë siç thotë vetë, në thellësi të indit nacional, si me thikë të mprehtë: në hapësirat e jetësore të popullsisë së njëjtë me kufi të ndarë.

Autori ka arritur, që përmes analizës në rrafshin individual, të zbulojë vetë dhe të na bëjë të njohur ne lexuesve, ligjshmëritë e përgjithshme; me analizën e mikroniveleve dhe mikropraktikave nacionale në hapësirën kulturore dhe historike shqiptare, të na shpalosë diskursin mbizotërues nacional, konceptuar në planin e studimit kulturor dhe historik të shoqërisë shqiptare përtej kufijve të Shqipërisë së Vjetër. Autori nuk mjaftohet me këtë, por arrin të bëjë edhe shpjegimet e dallimeve nacionale, si produkt dhe rrjedhojë të ndarjes së kufirit ndërshqiptar në hapësirën gjeografike ku ata historikisht prej shekujsh jetojnë.

Në fund autori nuk e le me kaq punimin dhe fokusohet në analizën e gjendjes së respektimit të të drejtave të njeriut, gjendjes së ndryshimit të sovranitetit, shkallën e plotësimit të të drejtës së vetëvendosjes, ligjin mbi ndarjen administrative, respektimin e titullit juridik të pronësisë, si bazament ligjor të brendshëm, të kërkuar nga ajo që unë do ta quaja, qeverisja demokratike botërore (dhe këtu kam parasysh monitorimin e standardeve ndërkombëtare të respektimit të të drejtave të minoriteteve), si faktorë që ndihmojnë në zhdukjen e dallimeve kufitare që historia e vuajtur i ka lëne barrë brezit të tretë, shkruan autori, d.m.th. brezit tonë, mbasi dy breza para nesh përjetuan ndarjen, dhunën, privimet nga më të rëndat, vendosjet si popullsi e klasifikuar e dorës së dytë, etj.

Punimi i profesor Martin Berishajt është i përbërë nga Hyrja e zgjeruar dhe impostuese, në pikëpamje metodologjike dhe filozofike, recensioni i profesor Ernest Petriçit, tetë kapituj dhe dokumentacioni i National Archives in London, fondi i dokumentave të Komisionit të Caktimit të Kufirit në terren, pas luftës së Parë Botërore.

Punimi përbën një arritje serioze, e kryer nga një akademik serioz, që jeton dhe punon me ritmet e shkollave më të përparuara botërore të analizës politike, por edhe me vetëdijshmërinë e përkatësisë së një populli që ndodhet ende para sfidave të kompaktësimit të brendshëm dhe para nevojës për t'u pranuar si popull mirëfilli i evropianizuar.

POEZI

nga Mentor Tahiri

TI M'KE MËSU

Menon dikush se varfnia s'ka lumtuni
Se me vujtjen e ti' i varfuni s'mundet me gëzu njeri

Jo !
Ti m'ke mësu t'kundërten

Hala i kam n'kry
Leximet nga ti dhe shpirti jot pa hile
Dashuninë për me mësu e mos me u nal'
Etjen tande për dije

As ngazllimin tem prej femije se kam harru
Kam n'men' qeset me sheqerka që m'ke dhuru
Edhe at' erë t'kandshme t'samunit pjekun nga furrtari i vjetër
Që ma ke sjellun veq me m'ba t'lumtun

Ti m'ke mesu ma shumë se çdokush
Se pasunia e vërtetë asht' mrena shpirti

HEROIT TEM

Si dikund malësive t'thella ajrit lagështi
Nër tinguj lahute a gajde thirun me t'fun'it frymë
Legjendave ke ecun plagë kulluem
Ti hero i vogël i padëgjuem
E vërtetë e shkelun historie

Por herojtë s'janë për famë a po ?
As për leckat e rrejshme, as për kolltuqet
Se t'ishin për to nuk kishin me kenë për t'shenjtin
Atdhe shpirti për t'cilin ia vlen me vdekun
Me u ba lule gjaku viteve përjetë

Edhe ti s'kishe me kenë si k'ta t'sotmit a po ?
Qe gjakun ta kanë ba monedhë
Qe n'bamat e tu' shkelin sa herë dojnë fukaraja t'u përkulet
Ti hero i vogël i heshtun
E vërtetë e pashkruem historie

SERVANTESI IKU PREJ ULQINIT

Trazuem jam zgju atyne mëngjeseve
N'kllapi t'mendimeve t'u pa vetvetën
T'lidhun n'sheshin e skllavëve n'kala sipër deti
Pa zingjirë, pa litarë
Ma pak se skllav, ma shumë hyzmeqarë
Ndeshun me diellin e djersën faqeve
Brenda pazarit neveritës plot zhurmë
Ku çdo pjesë jete varet prej hileve t'peshores

N'luftën e përditshme gjallë me mbetun
Mes zjarresh e gjakut, kokave të prena
Panënshtruem si kalë i pabindun
I ashpër ai atdhe plisëbardhësh të moçëm
Poeti atje s'vleka paratë
Shpëtim dhe mallkim nën flamuj piratësh
Përzënë nga ato mure ku lashë zemrën
S'di a ma i trazuem me u zgju sot!

Dashni e zanun n'grackën e t'përjeshtmes
Andërr Dulcineje si fatamorganë ikë topitet
Nuk di njeri se çfarë asht' liri
Kur e kaluemja si tingjuj dairesh troket mendjes
Thu asht' valë fort e përplasun shkambit
As butë, as vrullshëm
Ashtu vakët si shpejtësi e kohës t'u ikun
Tinëzishëm për mos me u kthy ma

Shkruar mbi motivet e legjendës e cila flet për vitet e Servantesit në Ulqin. I zënë rrob në Lepanto, Servantes është sjellur nga anijet osmane në portin e Ulqinit. Në kështjellën e vjetër dikur mbaheshin skllevërit. Ata me vite të tërra kanë pritur aty që të blihen nga dikush, qoftë nga një pronar i ri, qoftë nga dikush që i blinte për t'i liruar. Legjenda thotë që Servantesi në Ulqin ishte dashuruar në vajzën e Mehmet Begut, të cilën ai e quante Dulcineja. Pas pesë viteve qëndrim, Servantes largohet nga Ulqini.

LIRIA DHE MAKINA E KOHËS

Me makinën e kohës kam udhëtue sot
T'kaluemes i rrash fluturimthi
Trokita pa turpshëm me goditje t'randa
Theva derën e qiellit që mban vitet n'arkiv
Nëpër labirintet mister me shkue

Kur makina u ndal, zbarkova si një UFO
N'mes t'sheshit u ndodha mes turmës
Si një profet që din çfarë ka me ndodhë
Po nuk shita mend, s'bana hile
Kush jam unë me ndryshue t'kaluemen thash

Dhe pashë se si ....
Njerëzit rrëzuan bustet
Rrënuan muret, i çanë përtej
Këpusnin zingjirët e robënisë
Lirinë kërkonin

U ktheva n'makinën teme
U ndala me një kohë tjetër
E ardhmja kish' ndodhun tani
Sërish njerëzit, tjerë veç me rroba ndryshe
Po luftonin me buste, mure, zingjirë

N'kohën që ende nuk ka ardhun
Njerëzit edhe një herë
Flamuj ngrisnin, lirinë kërkonin
Ca të tjerë po ua merrnin
T'njëjtit!

POEZI PA EMËN

Shpirtna t'zbrazët defilojnë zhurmshëm trotuareve falso
Paradave e parodive pa pikë stili humbun n'kohë
Librashitës mërdhinun vështrojnë fletë t'pa shfletueme nga kalimtari
Rropllimë a tallava a si quhet t'shkul e t'nënçmon n'sfond
Lirisë t'zbehun n'gjendje t'dehun dhe zhveshun
I qeshemi dhe e qajmë fshehtazi

K'tu poeti nuk ngritët n'bronz e as artisti
Veç trim me ken t'ban punë, nderë madje
Trimënia gjithfare qoftë e rrejshme ka me t'shërbye
Dimën zemrash mbretënon edhe n'pikun e verës
N'acarin e stërgjatun përdhosës promovues antikulture
Veç i mençur s'ban me ken se bahesh Prokë a Kukum

E vërteta ka humbun moti diku nën tapetë
Gozhduem thellë damarëve t'gjakut fshehun nga vetvetja
Sodisim pa fuqi e përkulemi para pakurrizorëve
Jetojmë gënjeshtrën e trishtë t'mbretënve lakuriq
Dhe diku n'skajet e shpirtit ndërgjegjja asht' tu pyet
Quo Vadis atdheu i andrrave ?

"Për të shkruar këtë poezi, më kishte motivuar pamja e një librashitësi të mbërdhirë në sheshin Nëna Tereze. Ishte një ditë dimri. Tek ai nuk afrohej askush, pak më tutje një person po shiste muzikë tallava, s'mund t'i dilte në ballë turmës. Nuk dija si ta titulloj dhe e lashë "Poezi pa emën". Një mik i imi e quajti "In memoriam shoqërore".

ALTERNATIVA

NARODNA IN UNIVERZITETNA KNJIŽNICA
GS
403 668 2018
920184250,7
COBISS